



RAPORTI VJETOR I VEPRIMTARISË SË AKEP

2015

www.akep.al

Përmbajtja

I. Të përgjithshme	7
1. Shkurtime	7
2. Përmbledhje ekzekutive	8
2.1 Zhvillimi i tregut të komunikimeve elektronike:	9
2.2 Zhvillimi i tregut të shërbimeve postare	17
3. Baza ligjore	19
3.1 Legjislacioni material i fushës:	20
3.2 Kuadri ligjor që rregullon veprimtarinë si organ administrativ	21
3.3 Kuadri nënligjor rregullato	21
3.4 Përmirësim i bazës ligjore në periudhën raportuese (viti 2015)	23
3.5 Sfidat e së ardhmes	24
4. Përshkrim i Institucionit	25
4.1 Statusi dhe Këshilli Drejtues i AKEP	25
4.2 Juridiksioni territorial:	25
4.3 Misioni	25
4.4 Vlerat thelbësore të AKEP janë	25
4.5 Struktura	25
4.6 Kompetencat e AKEP	26
5. Organizimi institucional	29
5.1 Parimet e Organizimit dhe Funkcionet e Administratës	29
5.2 Struktura organizative e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare	29
5.3 Këshilli Drejtues	30
6. Kërkesat e Kuvendit nga AKEP për vitin 2015	33
7. Përshkrim i fushave që mbulon institucioni	35
7.1 Tregu i Komunikimeve Elektronike	35
7.1.1 Zhvillimi i tregut të komunikimeve elektronike	35
7.1.2 Tregues Financiarë të sektorit	35
7.1.2.1 Të Ardhurat	35
7.1.3 Shërbime të rrjeteve Celulare	37
7.1.3.1 Numri i përdoruesve celularë	38

7.1.3.2	Shërbimet 3G/4G:	39
7.1.3.3	Trafiku telefonik dhe SMS	40
7.1.3.5	Pjesët e tregut	42
7.1.3.6	Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare:	43
7.1.3.7	Tarifat celulare	44
7.1.4	Shërbimet nga rrjetet fikse	46
7.1.4.1	Telefonia fikse	46
7.1.4.2	Aksesi broadband nga rrjete fikse	48
7.1.4.3	Përdorimi i përbashkët i infrastrukturës aktive dhe pasive në rrjetet fikse	51
7.2	Tregu i Shërbimeve Postare	52
7.2.1	Informacion mbi ecurinë dhe tendencat e tregut të shërbimeve postare	52
7.2.1.1	Volumi i objekteve postare.	53
7.2.1.2	Tregues të rrjetit postar	55
7.2.1.3	Të punësuarit	56
7.2.1.4	Ankesat e përdoruesve (Reklamacionet)	56
	II Puna gjatë vitit paraprak (2015)	58
8.	Mbikqyrja e tregut të komunikimeve elektronike	58
8.1	Mbikqyrja dhe rregullimi ekonomik i tregut	58
8.1.1	Rregullimi ekonomik i tregut të komunikimeve elektronike	58
8.1.2	Masat rregulluese specifike për problematiken on-net/off-net:	59
8.1.2.1	Efektet në planet tarifore	60
8.1.2.2	Efektet në thirrjet celulare	61
8.1.3	Analiza e tregut të telefonisë fikse	63
8.2	Administrimi i burimeve të fundme, autorizimet dhe facilitetet	68
8.2.1	Autorizimi për të ofruar rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike sipas regjimit të autorizimit të përgjithshëm	69
8.2.1.1	Regjistrimi i Njoftimit:	69
8.2.1.2	Procedura e ç'regjistrimit	72
8.2.2	Administrimi i spektrit të frekuencave dhe numeracionit	73
8.2.2.1	Lëshimi i autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave	73
8.2.3	Bashkërendimi i punës me administratat e vendeve fqinje dhe të vendeve të tjera për caktimin dhe përdorimin e radio-frekuencave, për pjesën e spektrit që administron	78

8.2.4	Hartimi, miratimi dhe administrimi i Planit Kombëtar të Numeracionit për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë	78
8.2.5	Caktimi i numrit dhe serive numerike të sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike:	79
8.2.6	Sigurimi i disponueshmërisë së bazës qendrore të të dhënave për portabilitetin e numrit:	80
8.3	Mbikëqyrja e Faciliteteve	80
8.4	Përmirësimi dhe zgjerimi i shërbimit Broadband	81
8.5	Monitorimi i spektrit të frekuencave, cilesisë dhe inspektimit	82
8.5.1	Inspektimi	82
8.5.2	Ndjekja e arkëtimeve të pagesave nga debitorët e AKEP	83
8.5.2	Marrjen e masave organizative dhe operative për detyrimin e sipërmarrësve lidhur me zbatimin e rregullave teknike për rrjetet.	84
8.5.3	Monitorimi i spektrit të frekuencave	85
8.5.3.1	Monitorimi i radiolidhjeve fikse në pikat transmetuese të vendit	85
8.5.3.2	Subjektet që ofrojnë Shërbim Audiovizual	86
8.5.3.3	Subjekte që ofrojnë shërbimet internet dhe data	86
8.5.3.4	Subjekte të cilat ofrojnë internet nëpërmjet sistemeve që operojnë në brezin e frekuencave 2.4 dhe 5.8 GHz	86
8.6	Interferenca që shfaqin rrezikshmëri	87
8.7	Interferenca që dëmtojnë cilësinë e shërbimit	88
8.8	Bashkëpunimi	89
8.9	Monitorimi i cilësisë së shërbimit	89
8.10	Verifikimi i marrëveshjes së koordinimit ndërkufitar	90
8.11	Zhvillimi i projektit “Sistemi Kombëtar Monitorimi të Spektrit të Frekuencave për Shqipërinë”	90
8.12	Ushtrimi i funksioneve rregullatore në teknologjinë e informacionit dhe zhvillimit të broadband	91
8.12.1	Administrim i sistemeve cctld .al	91
8.13	Portabiliteti i Numrit	94
8.14	Mbyllja e faqeve të internetit me përmbajtje të paligjshme	94
8.15	Mbështetja e zbatimit të strategjisë për broadband	94
8.16	Mbi Masat Teknike dhe Organizative për të Garantuar Sigurinë dhe Integritetin e Rrjeteve dhe/ose Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike.	96
8.17	Dhoma e Server-ave pranë Qendrës Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave (QKMF)	97

8.17.1.	Ngritja e sistemit reserve (Backup) në Qendrën Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave	97
8.18	Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe mbrojtja e konsumatorit	98
8.19	Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe administrimi i brendshëm.	99
8.19.1	Në drejtim të menaxhimit të burimeve njerëzore është realizuar	99
8.19.2	Në drejtim të marrëdhënieve me publikun:	101
8.19.3	Aktivitete / Konferenca / Seminare/Trajnime	101
8.19.4	Në drejtim të administrimit të brendshëm janë kryer	104
9.	Mbikqyrja e tregut të shërbimeve postare	106
9.1	Veprimtaria e AKEP për shërbimin postar - 2015	106
9.2	Paketa rregullatore e hartuar dhe miratuar nga AKEP në zbatim të Ligjit 46/2015	106
9.3	Regjimi i ri i autorizimeve	109
9.4	Autorizim Individual për Postën Shqiptare	109
9.5	Transpozimi i Liçencave në Autorizim të Përgjithshëm	109
	III Statusi i Shërbimit Universal	111
10.	Statusi i shërbimit universal për shërbimet publike të komunikimeve elektronike	111
11.	Statusi i ofrimit të shërbimit postar	113
11.1	Përcaktimet ligjore dhe nënligjore për ofrimin e shërbimit universal postar	113
11.2	Tregues të volumit dhe cilësisë së shërbimit universal postar	114
11.2.1	Shërbimi universal postar / postë brenda vendit	114
11.2.2	Shërbimi universal postar / postë ndërkombëtare – Viti 2015	115
11.3	Dendësia e pikave të aksesit të Shërbimit Universal Postar	116
11.4	Standardet e cilësisë së shërbimit universal postar	116
11.5	Tarifat e shërbimit universal postar	117
11.5.1	Përmbledhje e krahasimit të tarifave të Posta Shqiptare me tarifën benchmark në vendet e BE	118
11.6	Problematika për ofrimin e shërbimit (universal) postar	120
	IV Programi vjetor i punës për vitin në vazhdim	122
12.	Programi vjetor i punës për vitin në vazhdim 2016	122
12.1	Në drejtim të mbikëqyrjes dhe rregullimit ekonomik	122
12.2	Në drejtim të administrimit të burimeve të fundme, autorizimeve dhe faciliteteve	123
12.3	Në drejtim të monitorimit të spektrit të frekuencave, cilësisë dhe inspektimit	123
12.4	Në drejtim të ushtrimit të funksioneve rregullatore në teknologjinë e informacionit dhe zhvillimit të broadband	124

12.5	Në drejtim të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe mbrojtjes së konsumatorit	124
12.6	Në drejtim të mbikëqyrjes së tregut të shërbimeve postare	125
12.7	Në drejtim të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe administrimit të brendshëm	126
12.8	Në drejtim të menaxhimit financiar dhe pagesave	126
	V Raporti Financiar	127
13.	Raporti për realizimin e treguesve financiar vjetor të AKEP	127
13.1	Të ardhurat dhe shpenzimet	127
13.2	Realizimi i arkëtimeve	127
13.3	Realizimi i shpenzimeve.	128
13.3.1	Shpenzimet administrative	128
13.3.2	Shpenzime për paga dhe shtesa	128
13.3.3	Shpenzime për sigurime shoqërore	129
13.3.4	Shpenzime për material	129
13.3.5	Shpenzimet për shërbime.	129
13.3.6	Shpenzimet për Investimet	130
13.4	Mbi tepricën e të ardhurave	131
13.5	Mbi taksën e radiokomunikacionit	131
13.6	Rritja e performancës dhe efektiviteti i realizimit të treguesve financiarë të AKEP	132
14.	Programi i treguesve financiarë të AKEP për vitin 2016	132
	Figurat	133
	Tabelat	134

I. Të përgjithshme

1. Shkurtime

AKEP – Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

MIAP – Ministri i Inovacionit dhe Administratës Publike

BEREC – Body of European Regulators of Electronik Communications

ERGP – The European Regulators Group for Postal Services

ITU – International Telecommunication Union

UPU – Universal Postal Union

KE – Këshilli i Evropës

AEK – Autoriteti rregullator i Maqedonisë

EKIP – Autoriteti rregullator i Malit të Zi

HAKOM – Autoriteti rregullator i Kroacisë

RATEL – Autoriteti rregullator i Serbisë

RTR – Autoriteti rregullator i Gjermanisë

AKOS – Autoriteti rregullator i Sllovenisë

BTK - Autoriteti rregullator i Turqisë

ARKEP – Autoriteti rregullator i Kosovës

AK – Autoriteti i Konkurrencës

AMA – Autoriteti Mediave Audiovizive

KKRT – Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

DAP – Departamenti i Administratës Publike

ASPA – Shkolla Shqiptare e Administratës Publike

FNT – Fuqi të Ndjeshme në Treg

PKF – Plani Kombëtar i Frekuencave

PKN – Plani Kombëtar i Numeracionit

SHU – Shërbim Universal

OA – Operatorë Alternativë

NGN - Next Generation Netëorks

CEPT - Centre for Environmental Planning and Technology

LLU - Local Loop Unbundling

ARPU - Average Revenue Per Users

ARPM - Average Revenue Per Minute

2. Përmbledhje ekzekutive

AKEP për punën e tij është përgjegjës përpara Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe ky raport i paraqitet Kuvendit prej tij në zbatim të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 9 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 8 të ligjit nr. 46/2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” mbi veprimtarinë e vitit pararendës, si organ rregullator i fushës së komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare.

Raporti është hartuar i ndarë në pesë kapituj kryesorë:

- Të përgjithshme,
- Puna gjatë vitit paraprak,
- Statusi i Shërbimit Universal,
- Programi vjetor i punës për vitin në vazhdim,
- Raporti Financiar.

Veprimtaria rregullatore e AKEP gjatë vitit 2015 është karakterizuar nga pesë parime bazë:

- Mbrojtja e interesave të përdoruesve,
- Nxitja e konkurrencës,
- Sigurimi i integritetit social,
- Mirëadministrimi i burimeve të fundme,
- Garantimi i sigurisë së rrjeteve.

dhe vlerat e mishëruara janë:

- Profesionalizmi,
- Zhdërvjelltësia,
- Pavarësia,
- Transparenca.

Puna e AKEP gjatë vitit paraprak është udhëhequr nga angazhimi maksimal për zbatimin dhe përmbushjen e:

- Detyrimeve dhe objektivave rregullatore të përcaktuar në legjislacionin material,
- Politikat e zhvillimit sektorial të Këshillit të Ministrave,
- Rekomandimeve të Kuvendit,
- Direktivave të fushës të Komisionit dhe Parlamentit European,
- Akteve të BEREC, ERGP dhe ITU,
- Rekomandimeve sektoriale të Progres Raportit të KE për Shqipërinë,
- Programit vjetor të punës për vitin në vazhdim të paraqitur në Raportin vjetor të veprimtarisë së AKEP për vitin 2014.

Këshilli Drejtues gjatë vitit 2015 ka zhvilluar 25 mbledhje dhe ka nxjerrë 126 akte vendim-marrëse, nga të cilat:

- 45 akte të karakterit rregullator,
- 8 akte të karakterit të brendshëm administrative,
- 16 akte për miratim dhënie Autorizime Individuale,
- 42 akte për revokime dhe ç'regjistrim sipërmarrësish nga *data base*,
- 15 akte për shqyrtimin e ankimeve administrative dhe zgjidhje mosmarrëveshje.

Raporti përmban të dhëna të detajuara mbi zhvillimin gjatë vitit 2015 të tregut të:

- Ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike,
- Ofrimit të shërbimeve postare,

2.1 Zhvillimi i tregut të komunikimeve elektronike:

Tendencat kryesore të tregut të komunikimeve elektronike në vitin 2015 ishin:

- Ndryshime të ndjeshme të paketave tarifore të thirrjeve në rrjetet celulare dhe strukturës së thirrjeve celulare (rritje e ndjeshme e sasisë së thirrjeve off-net dhe reduktim i sasisë së thirrjeve on-net),
- Rritje e ndjeshme e përdorimit të shërbimeve të aksesit broadband nga rrjete rrjete celulare 3G/4G sidomos me fillimin e ofrimit të shërbimeve në rrjetet 4G (Tremujori i III 2015),
- Rënie e përdorimit të shërbimeve të telefonisë fikse (pajtimtarë dhe thirrje),
- Rritje e ndjeshme e numrit të pajtimtarëve me akses broadband nga rrjete fikse,
- Rritje e përdorimit të përbashkët të infrastrukturës aktive (bitstream) dhe pasive (tubacione) të rrjetit fiks të operatorit incumbent Albtelecom.

Numri i përdoruesve celularë aktivë në fund të vitit 2015 ishte 3.40 milion, që përbën një rritje të vogël me 1% në krahasim me vitin 2014. Përsa i përket numrit të përdoruesve sipas kartave SIM në fund të 2015 ishin rreth 4.7 milion përdorues që përbën një reduktim me 3% në krahasim me vitin 2014. Norma e penetrimit (përdorues për 100 banorë) në fund të 2015 ishte 120% sipas përdoruesve aktivë dhe 167% sipas kartave SIM.

Numri i përdoruesve aktivë (përdorim 3 muajt e fundit) të shërbimeve me akses broadband nga rrjetet celulare (3G/4G nga aparateve celulare dhe me karta USB/modem) në vitin 2015 ishte rreth 1.3 milion apo 43% më shumë se në vitin 2014. Rritja e ndjeshme e përdorimit të aksesit broadband nga rrjetet 3G/4G është vënë re sidomos në tremujorin e tretë 2015, që përkon me fillimin e ofrimit të shërbimeve në rrjetet 4G. Rritja e përdorimit të aksesit broadband nga rrjetet celulare 3G/4G në vitet e fundit vihet re dhe në rritjen e volumit të të dhënave të transmetuara në rrjetet celulare. Në vitin 2014 rritja vjetore e trafikut të të dhënave në rrjetet celulare ishte 148%, dhe kjo tendencë vazhdoi edhe në vitin 2015.

Sasia totale e thirrjeve telefonike të gjeneruara nga përdoruesit celularë gjatë vitit 2015 nuk pati ndryshim të ndjeshëm në krahasim me vitin 2014 (ritje me 1.5%), ndërkohë numri i mesazheve SMS të dërguara nga përdoruesit celularë u reduktua me 12%. Kjo tendencë është e kundërt me rritjet e ndjeshme vjetore në 2013 dhe 2014. Rënia e përdorimit të mesazheve SMS dhe rënia e ndjeshme e normës së rritjes së thirrjeve telefonike në rrjetet celulare gjyko-het se kanë ardhur për shkak të rritjes së ndjeshme të përdorimit të aksesit në Internet në rrjetet celulare dhe efektit të zëvendësimit të mesazheve SMS dhe thirrjeve me mesazhe/thirrje nga aplikacionet OTT (Over The Top) në Internetin në aparat celular.

Gjatë vitit 2015, një përdorues celular aktiv (që ka kryer komunikim në 3 muajt e fundit) ka kryer mesatarisht 183 minuta thirrje dalëse dhe ka dërguar 39 mesazhe SMS në muaj.

AKEP me Vendimet nr.2542-2546, datë 13.03.2015 shqyrtoi ankimet administrative të operatorvë celularë për Vendimet nr.2522-2526, datë 6.11.2014, dhe kreu disa disa shtesa dhe ndryshime në këto vendime në lidhje me afatin e fillimit të zbatimit të detyrimit të mos-diskriminimit në tarifën on-net/off-net (1.07.2015 dhe 1.01.2016) dhe përcaktimin e një reduktimi të përshkallëzuar të tarifës së terminimit në rrjetin Plus Communication, për eliminim të asimetrisë më 1.01.2016.

Më 1 Korrik 2015 hyri në fuqi detyrimi i operatorëve celularë për mos-diskriminim në tarifën e thirrjeve brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare. Zbatimi i këtyre detyrimeve çoi në ndryshime të ndjeshme të planeve tarifore dhe strukturës së thirrjeve të përdoruesve celularë. Këto ndryshime nga të katër operatorët celularë kanë çuar në rritje të përfitimeve të përdoruesve fundorë, pasi sasia e minutave të përfshira në pagesat fikse është e mjaftueshme dhe duke filluar nga pagesa shumë të ulëta fikse. Efektet e këtyre ndryshimeve janë vënë re në sasinë e thirrjeve dhe strukturën e thirrjeve të përdoruesve të katër operatorëve celularë.

Në vitin 2015 thirrjet brenda rrjetit u reduktuan me 16% ndërsa thirrjet drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare (off-net) u rritën me 2.4 herë në krahasim me vitin 2014. Pesha e thirrjeve brenda rrjetit ndaj totalit të thirrjeve dalëse nga 84% në vitin 2014 u ul në 69% në vitin 2015.

Sasia e thirrjeve drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare pati rritjen më të madhe në 2015 dhe pesha e tyre në totalin e thirrjeve dalëse celulare në 2015 arriti në 18% krahasur me 8% në 2014. Ndryshimet më të ndjeshme të strukturës së thirrjeve janë vënë re në korrik 2015 e në vijim, që përkon me afatin e fillimit të aplikimit të detyrimit të mos-diskriminimit në rrjetet e katër operatorëve celularë. Në periudhën korrik-dhjetor 2015 trafiku off-net është rritur me 65%, ndërsa trafiku on-net është reduktuar me 21%.

Rritja e ndjeshme e sasisë së trafikut off-net dhe reduktimet e tarifave të terminimit kanë çuar dhe në ndryshime të ndjeshme të të ardhurave/pagesave neto midis operatorëve celularë për trafikun e terminuar në rrjetet e tyre, të cilat kanë rritur aftësitë konkurruese të dy operatorëve më të vegjël dhe të rinj në treg, Plus dhe Albtelecom (EM).

Pjesët e tregut të operatoreëve celularë nuk patën ndryshime të ndjeshme gjatë vitit 2015. Vodafone Albania vazhdon të jetë operator lider me pjesë tregu respektivisht 43 dhe 49% për treguesit kryesorë të numrit të përdoruesve, të ardhura dhe thirrje dalëse. Altelecom dhe Plus patën luajtje të vogla me rritje ose reduktim deri në 2 pikë përqindje të pjesëve të tregut për treguesit kryesorë.

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse ka patur tendencë reduktimi duke filluar nga viti 2012 dhe në vitin 2014 rënia vjetore ishte 16%. Kjo tendencë rënie ka vazhduar edhe në vitin 2015, megjithëse me normë më të ulët rënie me rreth 4%.¹ Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2015 ishte rreth 227 mijë dhe norma e penetrimit për telefoninë fikse (numër pajtimtarësh për 100 banorë) arriti në 8%, që është shumë më e ulët se në vendet e BE apo edhe të rajonit. Rënia e përdorimit të shërbimeve të telefonisë fikse vihet re edhe në reduktimin e sasisë totale të thirrjeve të gjeneruara nga rrjetet fikse dhe sasinë mesatare mujore të thirrjeve telefonike nga një përdorues, të cilat u reduktuan me 17 dhe 19% në krahasim me vitin 2014. Reduktimi i ndjeshëm i tarifave celulare në vitet e fundit ka rritur në masë të madhe efektin zëvendësues të thirrjeve nga rrjete fikse me thirrje nga rrjete celulare. Kjo vihet re në konvergjencën e nivelit të tarifave nga rrjetet celulare dhe nga rrjetet fikse, konvergjencën e kohëzgjatjes mestare të thirrjeve nga rrjetet celulare dhe fikse, si dhe në ecurinë e thirrjeve nga rrjetet fikse dhe celulare, në vitin 2014 thirrjet nga rrjetet fikse përbënin vetëm 3% të totalit të thirrjeve telefonike të origjinuara nga rrjetet celulare dhe fikse së bashku.

Megjithëse shërbimet e telefonisë nga rrjetet fikse kanë pasur reduktim të ndjeshëm në vitet e fundit, **shërbimet e aksesit broadband nga rrjete fikse** kanë vazhduar të kenë rritje të qëndrueshme në 5 vitet e fundit. Numri i pajtimtarëve me akses broadband fikse në fund të vitit 2015 arriti në rreth 243 mijë, që përbën një rritje me rreth 17% në krahasim me vitin 2014. Norma e penetrimit për popullsi dhe për familje e pajtimtarëve me akses broadband fikse në fund të vitit 2015 ishte 9 % dhe 33% përkatësisht. Altelecom dhe tre operatorët kryesorë alternativë patën rritje të numrit të pajtimtarëve me 5-18%. Për sa i përket pjesëve të tregut gjatë vitit 2015 nuk pati ndryshime të ndjeshme dhe Altelecom vazhdon të zotërojë vetëm 40% pjesë tregu të numrit të pajtimtarëve me akses broadband.

Gjatë vitit 2015, **numri i pajtimtarëve me shërbime të integruara në shporta triple play** (Telefoni, Internet dhe TV), u rrit rreth tre herë në krahasim me vitin 2014. Altelecom pati rritjen më të madhe të këtyre pajtimtarëve (me rreth 4 herë). Në fund të vitit 2015, 63% e pajtimtarëve me akses broadband të Altelecom ishin pajtimtarë të shportave trefishe (Telefoni, Internet dhe IPTV).

Teknologjia kryesore në ofrimin e aksesit broadband vazhdon të jetë DSL. Rrjetet NGA janë në nivel të kënaqshëm, pasi shumica e lidhjeve DSL janë me FTTN/C (kombinim fibër optike dhe kabëll bakri).

¹ Të dhënat e vitit 2014 të raportuara me parë janë rishikuar për shkak të ndryshimit të numrit të raportuar nga një operator alternativ+++

Me qëllim promovimin e përdorimit të përbashkët të infrastrukturës pasive të rrjeteve fikse (dhe celulare) në vitin 2015 **AKEP miratoi “Rregulloren për përdorimin e përbashkët të faciliteteve”**. Disa prej masave rregulluese për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës aktive (bitstream, linja me qira) dhe pasive (tubacione) të rrjeteve fikse kanë filluar të japin efekt në vitin 2015, gjatë të cilit u vu re një rritje e përdorimit të përbashkët të infrastrukturës të operatorit Altelecom. Gjatë vitit 2015 Altelecom ka lidhur marrëveshje për aksesin bitstream me 4 operatorë dhe 2 marrëveshje për aksesin në tubacione, duke çuar në 5 numrin total të marrëveshjeve për këtë shërbim.²

AKEP gjatë vitit 2015 **kreu procedurat e analizës së tregut të telefonisë fikse** dhe në përfundim të procesit të Këshillimit Publik me Vendimet nr.2617-2620, datë 8.10.2015 miratoi dokumentin përfundimtar të analizës së tregut të telefonisë fikse dhe Vendimet për FNT dhe masat rregulluese për terminimin dhe tranzitimin e thirrjeve në rrjetin fiks të Altelecom dhe për terminimin e thirrjeve në rrjetet individuale fikse të 80 sipërmarrësve (operatorë alternativë) dhe Telekom Albania (për terminimin e thirrjeve drejt numrave gjeografikë fiks të TA).

AKEP në vijim të heqjes së masës së rregullimit të tarifave me pakicë të Altelecom për telefoninë fikse (vendimi i Analizës së tregut në vitin 2013), me Vendimin nr.2619, datë 8.10.2015 hoqi statusin me FNT të Altelecom në tregjet me pakicë të telefonisë fikse. Në lidhje me tarifat e terminimit në rrjetin Altelecom, 80 OA dhe Telekom Albania, AKEP vendosi reduktimin e tyre me 41-62% në mënyrë të përshkallëzuar në periudhën 1.01.2016-1.01.2018. Gjithashtu duke filluar nga data 1.01.2016 u vendos të reduktohet numri i segmenteve të tarifimit të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse nga 2 në 1, si dhe të hiqet asimetria e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse të operatorëve alternativë me tarifat e terminimit në rrjetin Altelecom.

AKEP gjatë vitit 2015 realizoi një proces konsultimi me tre operatorët më të mëdhenj celularë për mbulimin me sinjal rrjeti GSM/UMTS të disa zonave të largëta si dhe për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar me rrjet UMTS në disa zona me densitet të ulët të popullsisë. Secili operator ra dakort për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në zonat e evidentuara individuale dhe të tre operatorët nënshkruan një marrëveshje kuadër bashkëpunimi më datë 5.11.2015 me tabelat përkatëse për investime të përbashkëta në 7 zona të largëta të territorit të Shqipërisë gjatë vitit 2016. Angazhimet individuale të tre operatorëve celularë dhe plani i investimeve të përbashkëta për zonat me densitet të ulët popullsie u miratuan nga AKEP me Vendimet nr. 2646, 2547 dhe 2548, date 03.12.2015.

Niveli i tarifave të thirrjeve telefonike (nga rrjete fikse dhe celulare) në Shqipëri vazhdon të jetë i përballueshëm dhe mbulimi me rrjete fikse dhe celulare në këto vite të fundit është përmirësuar si për shërbime tradicionale telefonike edhe për akses broadband nga rrjete fikse dhe celulare (3G/4G).

² Më shumë informacion për këtë pikë dhe të dhëna shtesë për tregun do të jepet pas marrjes së të dhënave vjetore nga operatorët më 10.04.2016.

Në drejtim të **administrimit me efikasitet të spektrit të frekuencave** dhe në funksion të zhvillimit të tregut AKEP ka zbatuar një proces dhënie të drejtash përdorimi të frekuencave objektiv dhe transparent në përfitim të konsumatorëve shqiptarë dhe ekonomisë së vendit.

Kështu, në vlerësim të një pjesë të spektrit të lirë (disa kanale) të brezit GSM 900 AKEP, duke marrë parasysh se nuk kishte mundësi teknike për të mundësuar futjen e një operator të ri, me qëllim rritjen e efektivitetit të shfrytëzimit të gjithë brezit të frekuencave, përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar, si dhe interesin e shprehur nga sipërmarrësit e autorizuar për përdorimin e këtij spektri planifikoi që kanalet e lira radio, të jepen për përdorim.

Në përfundim të tenderit publik me procedurë të hapur, me objekt “Dhënia në përdorim e frekuencave në brezin 900 MHz për sistemet GSM”, AKEP i dha të drejtën e përdorimit për 9 kanale (2x200 kHz) sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a., i shpallur fitues i kësaj procedure.

Sa i përket shfrytëzimit të brezit GSM1800 MHz, situata ishte më e ndryshme. Për shkak të alokimit jo në vazhdimësi të spektrit për operatorët e licensuar më herët, kishte një *gap* prej 12.6 MHz në mes të brezit të alokuar dhe rreth 25 MHz të pa alokuar në fund të spektrit, pa llogaritur disa kanale sigurie midis brezave.

AKEP me vendimin Nr.2413, datë 27.01.2014 nisi një proces Këshillimi Publik “Mbi përdorimin e brezave të frekuencave GSM 900/1800”. Qëllimi kryesor i këtij këshillimi ishte nxitja e sipërmarrësve për të investuar në ofrimin e shërbimit të ri 4G (IMT e avancuar) në tregun e komunikimeve elektronike.

Pas përfundimit të Këshillimit Publik për brezat 900/1800 MHz, AKEP pas miratimit nga ministri të numrit të të drejtave, kriterëve të vlerësimit dhe çmimit minimal, në nëntor 2014 miratoi dokumentin e tenderit me vendimin nr.2527, datë 12.11.2014. Me datë 03.03.2015 u hapen ofertat e pjesëmarrësve në garë.

Në përfundim të vlerësimit u shpallën fitues, Telekom Albania, Vodafone dhe Albtelecom të cilët kanë marrë nga 2 të drejta përdorimi, 2x6 MHz, në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/ËiMAX ndërsa Vodafone fitoi të drejtën edhe për 2.4 MHz shtesë.

Me anë të VKM nr.300, datë 08.04.2015, për “Disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 468, datë 30.05.2013, të Këshillit të Ministrave, për “Miratimin e planit kombëtar për zhvillimin e Broadband-it”, autorizohej heqja e kufizimeve teknologjike dhe ndryshimi i autorizimeve individuale përkatëse pa pagesë shtesë nga ana e mbajtësit të autorizimeve, dhe kryerjen nga AKEP të procesit të riorganizimit të spektrit në këto breza.

Kështu, me Vendimet Nr.2564, 2565, 2566 dhe 2567, datë 11.05.2015 AKEP miratoi dhënien e Autorizimeve Individuale sipërmarrësve Albtelecom, AMC (Telekom Albania), Vodafone Albania dhe Plus Communication, për përdorimin e frekuencave të brezit 900 dhe 1800 MHz pa kufizim teknologjik.

Për të garantuar barazinë dhe që shërbimet 4G të ofruara në këto breza të ishin në përmbushje të treguesve të cilësisë së shërbimit të ofruar dhe zona e ofrimit të këtyre shërbimeve të ishte sa më e gjerë, AKEP vendosi që data e fillimit të ofrimit të këtyre shërbimeve, pra 4G, të ishte 1 shtatori.

Për një shfytëzim sa më efektiv të spektrit AKEP, me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr.2662, datë 28.12.2015 bëri miratimin e dokumentit të Tenderit Publik me Procedurë të Hapur me objekt: *“Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1970 – 1980 MHz çiftuar me 2160- 2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915 – 1920 MHz”* dhe Njoftimin për Tender Publik. Hapja e ofertave u bë në datën 15.02.2016.

Përsa i përket përdorimit të brezit të frekuencave 2500–2600 MHz , në përfundim të Këshillimit Publik dhe miratimit nga Ministri të numrit të të drejtave, kritereve të vlerësimit dhe çmimit minimal, AKEP në shkurt 2015 miratoi me Vendimin nr.2538, datë 19.02.2015 dokumentin e tenderit.

Në 9 Prill 2015 u hapen ofertat dhe u vijua me vlerësimin dhe dhënien e të drejtave të përdorimit. Në përfundim të procesit Vodafone Albania fitoi të drejtën e përdorimit të 20 MHz spektër të çiftuar dhe 20 MHz spektër të paçiftuar dhe Telekom Albania fitoi të drejtën e përdorimit për 20 MHz spektër të çiftuar.

Me qëllim nxitjen e një konkurrence sa më efiçente në tregun e komunikimeve elektronike dhe përdorimin sa më të frytshëm të frekuencave në rastet e kufizimit të tyre AKEP me anë të Vendimit të Këshillit Drejtues Nr.2663, datë 28.12.2015 miratoi dokumentin e Tenderit Publik me Procedurë të Hapur me objekt: *“Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz”*. Hapja e ofertave u bë në datën 10.03.2016.

Brezi i frekuencave 3400-3600 MHz, 3600-3800 MHz është i pashfrytëzuar. AKEP ka kryer një këshillim publik lidhur me kushtet e përdorimit të këtij brezi duke propozuar ndarjen e brezit për dhënien në përdorim.

Në mënyrë të vazhdueshme AKEP ka ndjekur funksionimin e sistemit të portabilitetit të numrit CRDB.

Sipas të dhënave të CRDB (bazës së të dhënave të këtij sistemi) rezulton:

Shërbimi Telefonik	I lëvizshëm		Fiks	
	2014	2015	2014	2015
Numra të bartur	102796	95782	5336	2661

Në kuadër të administrimit të proceseve që lidhen me mbikëqyrjen e ndërtimit të rrjeteve dhe shërbimeve shoqëruese (faciliteteve) është realizuar menaxhimi dhe integrimi në sistemin ATLAS si pjesë e sistemit Eeb-Gis i informacioneve hapsinore dhe jo hapsinore të rrjeteve

publike të komunikimeve elektronike për sistemeve të transmetimit të radio frekuencave dhe sistemeve për infrastrukturën e komunikimeve elektronike kabllore dhe kanalizime.

Bazuar në të dhënat e administruara nga ky sistem rezulton rreth 5,000,000 metra kabëll fibër optike e shtrirë në të gjithë territorin e vendit.

Monitorimi i spektrit të frekuencave është kryer minimumi një herë në vit për pikat kryesore të trasmetimit.

Për vitin 2015 **janë kryer 28 inspektive** tek sipërmarrësit e komunikimeve elektronike të regjistruar në regjistrin e sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm.

Gjatë këtyre inspektiveve u konstatua se 9 sipërmarrës që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike në përputhje me kushtet e Autorizimit të Përgjithshëm (disa prej të cilëve iu lanë disa detyra dhe rekomandime) dhe 19 sipërmarrës nuk kishin zbatuar rregulloret e miratura nga AKEP dhe për këto shkelje u vendosën masa administrative me gjobë sipas ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

U vendosën 11 gjoba me vlerë 2,050,000 lekë nga të cilat u arkëtuan 1,350,000 lekë dhe janë në proces gjyqësor me AKEP për tu arkëtuar dhe 700,000 lekë.

Gjatë vitit 2015 AKEP ka kryer **monitorimin e cilësisë së shërbimit** të qyteteve dhe akseve rrugore për teknologjitë GSM/UMTS/LTE

Zhvillimi i projektit “Sistemi Kombëtar Monitorimi të Spektrit të Frekuencave për Shqipërinë”:

Gjatë vitit 2015 ka vijuar zbatimi i projektit të përbashkët AKEP- ITU për ngritjen e një Sistemi Kombëtar Monitorimi të spektrit të frekuencave për Shqipërinë”.

Me përfundimin e ndërtimit të Stacionit Fiks të Monitorimit në Pinet, mbyllet faza e parë e “Projektit për ngritjen e Sistemit Kombëtar të Monitorimit të spektrit të frekuencave”, duke bërë të mundur, së bashku me Stacionin Fiks të Monitorimit në Krujë, monitorimin 24 orë të brezit të frekuencave 20-3000 MHz, në një zonë 70 km rreth Tiranës dhe Durrësit, duke përfshirë dhe aeroportin ndërkombëtar në Rinas. Këto stacione do të kontrollohen në distancë nga Qendra Kryesore e Kontrollit (MCC), pjesë e Qendrës Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave, në Tiranë.

Në muajin maj u bë i mundur një upgrade i plotë i QKLM. Përditësimi i programit të monitorimit të cilësisë së shërbimit TEMS Investigation dhe raportimit TEMS Discovery në versionin e tyre më të fundit mundëson një monitorim sa më të saktë për operatorët e telefonisë së lëvizshme.

Në muajin nëntor në kuadër të implementimit të projektit për ngritjen e Sistemit Kombëtar të Monitorimit të spektrit të frekuencave, u përfundua rikostruimi i godinës të AKEP e cila do të plotësojë të gjitha nevojat aktuale dhe të perspektivës me ambiente pune për një Qendër Kombëtare Monitorimi të spektrit të frekuencave (Qendër Kontrolli Kryesore - MCC).

Me qëllim detyrimin e sipërmarrësve të cilët ndërtojnë ose përdorin rrjete të komunikimeve elektronike dhe ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike, që të zbatojnë kushtet e parashikuara në ligjin Nr. 9918 datë 29.05.2008 “Për komunikimet elektronike në RSH” i ndryshuar dhe Rregulloren Nr. 22, datë 24.06.2011 “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërurbane të komunikimeve elektronike” për të mos rrezikuar jetën dhe shëndetin e qytetarëve, AKEP gjatë vitit 2015 në bashkëpunim me OSHEE dhe sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike kreu dhe mbikëqyri punën për largimin dhe sistemimin e kabllave nga shtyllat e OSHEE dhe shtyllat e ndriçimit të Bashkive, përfshirë trasversime të ulëta, në 23 qytete të Shqipërisë.

Gjatë vitit 2015 u arrit të bëhet një përmirësim rrënjësor i këtyre rrjeteve në qytetet kryesore të vendit, ku u shmangën rrjetet e komunikimeve elektronike nga rrjetet e energjisë dhe në shumicën e rrugëve kryesore dhe qendra tashmë kanë përfunduar ose është drejt përfundimit. Kjo është një arritje e rëndësishme për garancinë e rrjeteve në uljen e rrezikshmërisë të këtyre instalimeve të rrezikshme për jetën e personelit të sipërmarrësve, përmirësimi i mirëmbajtjes si të rrjeteve të komunikimeve elektronike, por dhe të energjisë dhe ndriçimit.

Numri i domain-eve të regjistruar për vitin 2014 është 5,466 dhe kemi një numër total prej 15,975 domain-e. Në total verifikohet një rritje mbi 15% të domain-eve krahasur me vitin 2014. Është evidentuar një rritje e konsiderueshme e domain-eve tek regjistrarët e akredituar duke kaluar AKEP nga regjistrari dominues në vendin e tretë.

Me vendim të KD, Nr. 2632 datë 29.10.2015 AKEP ka miratuar Rregullore nr. 37 datë 29.10.2015 “Mbi Masat Teknike dhe Organizative për të Garantuar Sigurinë dhe Integritetin e Rrjeteve dhe/ose Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”. Kjo rregullore është miratuar në një kohë ku vëmendje po i kushtohet këto vitet e fundit Strategjisë Kombëtare të Sigurisë, kapitulli mbi sigurinë e komunikimeve elektronike, si dhe bazuar në udhëzimet e ENISA (European Union Agency for Network and Information Security) e cila gjatë vitit 2014 ka publikuar disa dokumenta orientues kryesisht për autoritetet rregullatore në lidhje me sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Bazuar në analizën e kryer nga raportimet e marra, është arritur në konkluzionin se nga 182 sipërmarrës vetëm 45 sipërmarrës kanë përbushur plotësisht detyrimet ligjore dhe ato rregullatore. Procesi është në vazhdim.

Gjithashtu, bazuar në kërkesat e ardhura nga institucione si Autoritetit të Mediave Audiovizive në zbatim të detyrimeve ligjore të ligjit nr.9918 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 15, i ka kërkuar ofruesve të shërbimit të Internetit (ISP) mbylljen e

faqeve të internetit të cilat kryejnë transmetimin e evenimenteve sportive shqiptare apo të huaja në dispozicion të publikut, në mënyrë të kundraligjshme.

Gjatë vitit 2015:

- janë hartuar dhe nxjerrë nga AKEP, 11 (njëmbëdhjetë) akte administrative të karakterit normativ (Rregullore),
- është përfaqësuar AKEP dhe janë ndjekur çështjet gjyqësore ku AKEP është palë në: 22 (njëzet e dy) çështje në shqyrtim në Gjykatën kompetente të Shkallës së parë, 7 (shtatë) çështje në shqyrtim në Gjykatën kompetente të Apelit, 7 (shtatë) çështje në shqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- janë shqyrtuar dhe është marrë vendim (ose janë në proces) për zgjidhjen e 5 (pesë) mosarrëveshjeve ndërmjet sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike,
- janë shqyrtuar dhe dhënë rekomandime (ose janë në proces) për zgjidhjen e 11 (njëmbëdhjetë) mosarrëveshjeve ndërmjet pajtimtarëve dhe sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike,
- janë shqyrtuar dhe është marrë vendim (ose janë në proces) për 15 (pesëmbëdhjetë) ankime administrative të palëve ankimuese kundra akteve të nxjerra nga AKEP.

Me Vendim të Kuvendit të Shqipërisë nr.88/2015 të Kuvendit të Shqipërisë “Për miratimin e struktures, organikes dhe kategorizimit të pozicioneve të punes të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)” është miratuar struktura organizative dhe organika e AKEP, e përbërë nga 73 punonjës.

Gjatë vitin 2015, AKEP përmbushi detyrimet ligjore që burojnë nga legjislacionin në fuqi për marrdhënieve të punës të nëpunësve civil dhe për punonjësit mbështetës, si për përmbushjen e detyrave funksionale, ashtu dhe për rritjen e performances.

2.2 Zhvillimi i tregut të shërbimeve postare

Kuvendi i Shqipërisë më datë 7.05.2015 miratoi Ligjin Nr. 46/2015, “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj zëvendësoi Ligjin nr. 8530, datë 23.9.1999, “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Në bazë të përcaktimeve të ligjit 46/2015, AKEP u fokusua në përgatitjen e akteve nën-ligjore dhe pas proceseve të Këshillimit Publik AKEP miratoi aktet e mëposhtëme nën-ligjore:

- Rregullore nr. 36, datë 29.10.2015 “Për Ofrimin e Shërbimit Universal Postar”,
- Rregullore nr.38, datë 19.11.2015 “Për dhënien e Autorizimit të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare”,
- Rregullore nr.39, datë 17.12.2015 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit postar dhe mosmarrëveshjeve ndërmjet ofruesve të shërbimit postar”,

- Rregullore nr.40, datë 17.12.2015 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi të dhënat e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”,
- Rregullore nr.20, datë 28.12.2015 “Për procedurën edhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare”,
- Rregullore nr.41, datë 3.03.2016 “Për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostove të shërbimit universal postar”,
- Rregullore nr.42, datë 3.03.2016 “Për llogaritjen e kostove neto të shërbimit universal postar

Hyrja në fuqi e Ligjit 46/2015, solli ndryshim në sistemin e licensave/autorizimeve të ofruesve të shërbimit postar. AKEP me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr.2581, datë 22.06.2015, pajisi subjektin Posta Shqiptare sh.a., me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar, me afat 5 vjeçar. Gjithashtu në dhjetor 2015 përfundoi procesi i transpozimit të licensave të përgjithshme për ofrimin e shërbimeve postare në çertifikata konfirmimi njoftimi sipas sistemit të autorizimit të përgjithshëm për 11 subjekte ofrues të shërbimeve postare, duke përdorur modulën on-line të AKEP për këtë qëllim.

Zhvillimet e mëdha në komunikimet elektronike paraqesin sfida të mëdha për ofruesit e shërbimeve postare për shkak të rritjes së ndjeshme të mundësive të zëvendësimit të shërbimeve postare me shërbimet e rrjeteve elektronike të cilat kanë çuar në reduktime të ndjeshme të numrit total të objekteve postare kudo në botë. Megjithatë zhvillimet në komunikim elektronik dhe tregtinë elektronike kanë rritur kërkesën për paket/paketat postare ndërkombëtare. Me zhvillimet në vitet e fundit të aksesit broadband dhe tregtisë elektronike në Shqipëri, këto tendenca botërore të shërbimeve postare kanë filluar të shfaqen edhe në Shqipëri.

Numri total i objekteve postare të pranuar gjatë vitit 2015 nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare gjatë vitit 2015 ishte rreth 20 milion, që përbën një reduktim me rreth 6 % në krahasim me vitin 2014. Posta Shqiptare sh.a vazhdon të ruajë pozicionin e saj dominues në tregun e shërbimeve postare, duke zënë rreth 90% të tregut të shërbimit postar kundrejt 10% që zënë ofruesit e tjerë të shërbimeve postare.

Reduktimi në totalin e objekteve postare vjen kryesisht nga reduktimi i kategorisë letra, ndërsa ndërsa paketat e vogla hyrëse dhe dalëse ndërkombëtare janë rritur ndjeshëm. Ecuria e “Paketave të vogla” hyrëse ndërkombëtare të Posta Shqiptare në periudhën 2010-2014 tregon se:

- Paketat e vogla hyrëse ndërkombëtare janë rritur me 346-887%, me rritjen me të madhe vjetore në 2014 me 75%,
- Peshat e paketave të vogla në totalin e objekteve hyrëse ndërkombëtare është rritur nga 12% në 2010 në 51% në 2014.

Në fund të vitit 2015, Posta Shqiptare kishte 552 zyra postare të hapura për publikun për SHU apo një zyrë postare mesatarisht në një sipërfaqe prej 52 km²/ një zyrë shërbimi mesatarisht 5,228 banorëve.

Për sa i përket tarifave të shërbimit postar në Shqipëri nga analizat e AKEP rezulton se tarifat e shërbimit universal postar të ofruar nga Posta Shqiptare janë shumë të lira dhe nuk kanë probleme përballueshmërie. Tarifat e Posta Shqiptare nuk kanë ndryshuar që prej vitit 2002, dhe ato janë deri në 13 herë më të lira se në vendet e BE/rajonit. Megjithatë struktura e tarifave të objekteve postare të Posta Shqiptare ka diferenca të mëdha me ato të vendeve të BE dhe tarifat shumë të ulëta të disa objekteve postare dhe mos-rishikimi i tarifave për një periudhë shumë të gjatë kohore krijojnë probleme për stimujt për ofrim efikas të shërbimit universal postar.

Përdorimi mesatar për banor i shërbimeve postare në Shqipëri është shumë i ulët krahasuar me vendet e BE dhe rajonit. Megjithatë shërbimet postare në vendet e tjera kanë shënuar rënie të ndjeshme në sasi totale të objekteve postare (sidomos letra), numri i objekteve postare për frymë në vendet e BE dhe rajonit është shumë më i lartë (50-252 letra/banorë) se në Shqipëri me rreth 7 objekte postare për banorë në vit.

Një ndër problemet me të mëdha që ndikojnë në përdorimin e ulët të shërbimeve postare në Shqipëri, nga konsumatorët dhe bizneset janë mungesa e adresave të sakta postare dhe kutive postare për dorëzimin e objekteve postare (letra, paketa të vogla) në adresën e marrësit (familjare).

Mungesa e adresave të sakta çon në probleme të shpërndarjes së objekteve postare duke krijuar besueshmëri të ulët të publikut të gjërë dhe bizneseve për cilësinë e shërbimit postar dhe kjo rezulton në përdorim shumë të ulët të shërbimeve postare në Shqipëri (numri i objekteve postare për banorë shumë herë më i ulët se vendet në rajon dhe BE). Një sistem i saktë dhe integruar i adresave, së bashku dhe me vendosjen e kutive postare në pallate, do të çonte jo vetëm në rritje të cilësisë së shërbimit postar por edhe në rritje të përdorimit/volumit të shërbimeve postare dhe në kushte të ofrimit efikas të SHU dhe në reduktim të kostove për njësi të elementëve të këtij shërbimi në Shqipëri.

3. Baza ligjore

Funksionimi dhe veprimtaria e AKEP si organ administrativ dhe rregullator i fushës së komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare mbështetet kryesisht në bazën ligjore (ligje, akte nënligjore, akte të brendshme) si më poshtë vijon:

3.1 Legjislacioni material i fushës:

1. Ligj nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 9918),
2. Ligj nr. 46/2015 datë 7.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”,
3. Plani Kombëtar i Frekuencave (PKF) miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 466, datë 27.2.2013,
4. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 468, datë 30.05.2013 “Për miratimin e planit kombëtar për zhvillimin e Broadband-it”, i ndryshuar,
5. Vendim nr. 468, datë 30.5.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin e Broadband-it” i ndryshuar. (Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 300, datë 8.4.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 468, datë 30.5.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e planit kombëtar për zhvillimin e Broadband-it”,
6. Vendim i Këshillit të Ministrave, nr.1252 datë 10.9.2008, “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar,
7. Vendim i Këshillit të Ministrave nr.635 datë 15.07.2015 “Për disa shtesa në Vendimin nr. 1252, datë 10.9.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, të ndryshuar,
8. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 599, datë 23.07.2010, “ Mbi miratimin e pagesave që kryhen në AKEP për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike” i ndryshuar;
9. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 25, datë 14.01.2014 për “Disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 599, datë 23.07.2010, i ndryshuar, “Mbi miratimin e pagesave që kryhen në AKEP, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike”,
10. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 546, datë 13.6.2013 “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacioneve dhe njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre”,
11. Udhëzim i Ministrisë së Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 4038, datë 4.9.2015 “Për përcaktimin e shërbimeve universale postare, që ofrohen pa pagesë, për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër”,
12. Udhëzim nr. 30, datë 23.12.2014 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e radio-komunikacionit" i ndryshuar, (Udhëzim nr. 28, datë 12.1.2015 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 30, datë 23.12.2014 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e radio-komunikacionit"),
13. Urdhër i Ministrisë së Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 6174, datë 16.12.2015 “Për përcaktimin e dendësisë së pikave të aksesit për ofrimin e shërbimit universal postar”; etj.

3.2 Kuadri ligjor që rregullon veprimtarinë si organ administrativ

1. Ligj nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” (ligji nr. 8480),
2. Ligj nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (ligji nr. 8485),
3. Ligj nr.152/2013, datë 30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij (ligji nr.152),
4. Ligj nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj” i ndryshuar (ligji nr. 9584),
5. Ligj nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar (ligji nr. 7961),
6. Ligj nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (ligji nr. 10 296),
7. Ligj nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar,
8. Ligj nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar (ligji nr. 9367),
9. Ligj nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar me ligjin nr. 9800, datë 10.09.2007, ligjin nr. 9855, datë 26.12.2007, ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009, ligjin nr. 10309, datë 22.07.2010, ligjin nr. 22/2012, ligjin nr. 131/2012, dhe ligjin nr. 182/2014 "Për prokurimin publik",
10. Vendim i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr.88/2015 datë 15.10.2015 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP),
11. Vendim i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2016, për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare”,
12. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 545, datë 11.8.2011, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në Kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, të ndryshuar”,
13. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,
14. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 918 datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”; etj.

3.3 Kuadri nënligjor rregullato

Rregullore:

1. Për llogaritjen e kostove neto të shërbimit universal postar,

2. Për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostove për ofrimin e shërbimit universal postar,
3. Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve postare,
4. Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit postar dhe mosmarrëveshjeve ndërmjet ofruesve të shërbimit postar,
5. Për autorizimin e përgjithshëm për ofrimin e shërbimive postare,
6. Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike,
7. Për ofrimin e shërbimit universal postar,
8. Për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës passive,
9. Për inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative,
10. Për administrimin e interferencave,
11. Për kushtet e përdorimit të frekuencave dhe kërkesat për pajisjet radio që përdoren pa autorizim individual,
12. Mbi termat e përgjithshme të kontratës së pajtimit,
13. Për dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave,
14. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet pajtimtarëve dhe sipërmarrësve të komunikimeve elektronike,
15. Mbi publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike,
16. Për përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrimit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë,
17. Rregullore për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacioneve dhe njohjen e konformitetit të tyre,
18. Për zgjedhjen dhe parazgjedhjen e bartësit,
19. Për kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kablore urbane dhe infrastrukturës;
20. Për procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare,
21. Për Autorizimin e Përgjithshëm,
22. Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve,
23. Për aksesin dhe interkoneksionin,
24. Për treguesit e cilësisë së shërbimit dhe tabelat e matjeve,
25. Për dhënien e licencës “Autoritet i llogarive detare” dhe Kodin AAIC”,
26. Për portabilitetin e numrit,
27. Për shërbimet radioamatore në Republikën e Shqipërisë,
28. Për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike,
29. Për analizën e tregut,
30. Për regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën.AL dhe nën domainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al,
31. Për dhënien e licensës për stacionet radio të avionit,
32. Për dhënien e licensës për stacionet radio të anijes,

33. Për dhënien e certifikatës operatorit radiodetar,
34. Për dhënien e autorizimit për stacionet radio bregdetare,
35. Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrsve të rrjeteve dhe ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Rregulla:

1. dhe udhëzime për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostos për sipërmarrësit me FNT,
2. Për administrimin e kodeve të pikave të sinjalizimit kombëtar (NSPC) dhe ndërkombetar (ISPC) për interkoneksionin e rrjeteve.

Në aspektin e rregullave të funksionimit të brendshëm:

1. AKEP me Vendim të Këshillit Drejtues Nr.2506, datë 30.10.2014 ka miratuar Rregulloren e Brendshme, me qëllim krijimin e kuadrit të nevojshëm normativ për garantimin e funksionimit sa më efektiv, të drejtë, transparent, të bazuar ligjërisht dhe të balancuar të veprimtarisë vendimmarrëse të Këshillit Drejtues (KD) dhe asaj ekzekutive, të administratës së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).

3.4 Përmirësim i bazës ligjore në periudhën raportuese (viti 2015)

Me miratimin e Ligjit nr. 46/2015 datë 7.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”³, vëmendje e veçantë nga AKEP i është kushtuar rregullimit të aspekteve ekonomike të tregut postar, sigurimin e konkurrencës së ndershme dhe efektive sidomos në kushtet e liberalizimit të mëtejshëm të tregut postar, garantimin e përfitimeve maksimale për konsumatorët, ofrimit të shërbimeve postare eficiente, të besueshme dhe me cilësi të mirë, të disponueshme për të gjithë qytetarët, sigurimit të shërbimit postar universal, për ofrimin e një minimumi shërbimesh me çmime të përballueshme, përfitimin nga të gjithë përdoruesit pavarësisht vendndodhjes së tyre gjeografike.

AKEP ka zbatuar detyrimin ligjor për hartimin dhe miratimin e akteve rregullatore në zbatim të Ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë, duke synuar liberalizimin gradual të tregut, rritjen e konkurrencës për të mbrojtur veçanërisht interesat e përdoruesve nëpërmjet kushteve të caktuara detyruese ndaj ofruesve të shërbimeve postare.

³ Ky ligj është përafëruar plotësisht me Direktivën 97/67/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 15 dhjetor 1997, “Për rregullat e përbashkëta për zhvillimin e tregut të brendshëm të shërbimit postar të Komunitetit dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit”, Numri CELEX: 31997 L0067, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 15, datë 21.1.1998, faqe 14, e ndryshuar me Direktivën 2002/39/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 10 qershor 2002, Rregulloren (KE) 1882/2003 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 29 shtator 2003 dhe Direktivën 2008/6/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 20 shkurt 2008.

Për këtë qëllim AKEP ka miratuar Rregulloret si më poshtë vijon:

1. Rregullore për autorizimin e përgjithshëm për ofrimin e shërbimive postare miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 2643, datë 19.11.2015.
Këto ndryshime kanë hequr konceptin e zonës së rezervuar dhe orientojnë në hapjen e plotë të tregut postar (liberalizimi). Njëkohësisht e drejta për ofrimin e shërbimit universal nuk është më mbi baza ekskluzive. Heqja e zonës së rezervuar dhe krijimi i hapësirave ligjore për ofrimin e shërbimit universal jo me të drejta ekskluzive janë ndryshimet kryesore, të miratuara me direktivën 2008/6/EC të BE-së).
2. Rregullore për ofrimin e shërbimit universal postar, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.2627, datë 29.10. 2015,
3. Rregullore për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve postare miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.2653, datë 17.12.2015,
4. Rregullore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit postar si dhe ndërmjet ofruesve të shërbimit postar” miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 2652, datë 17.12.2015,
5. Rregullore për “Procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.2658, datë 28.12.2015.

Rishikimi i Legjislacionit sekondar synon në:

- Zbatimin e Direktivave të BE mbi liberalizimin e tregut postar;
- Forcimin e kërkesave për zhvillimet teknologjike bashkëkohore;
- Zbatimin e procedurave lehtësuese për subjektet që kërkojnë të ofrojnë shërbime postare;
- Forcimin e kontrollit dhe monitorimit të tregut.

3.5 Sfidat e së ardhmes

Përmirësim i vazhdueshëm i akteve rregullatore dhe përshtatja me ndryshimet ligjore përkatëse (legjislacionin), përqasja me kuadrin rregullator të BE në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare.⁴

⁴ Bazuar në nenin 70 të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, sipas të cilit Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me legjislacionin evropian por njëkohësisht duhet të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet si duhet.

4. Përshkrim i Institucionit

4.1 Statusi dhe Këshilli Drejtues i AKEP

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare është organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar, i cili mbikqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ligji për komunikimet elektronike, nga ligji për shërbimin postar dhe nga politikat e zhvillimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave. Roli, funksionet dhe kompetencat institucionale si organ rregullator i fushës së komunikimeve elektronike dhe shërbimit postar përcaktohen në legjislacionin material për komunikimet elektronike dhe shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë.

4.2 Juridiksioni territorial:

AKEP është organ person juridik, publik, jobuxhetor, i krijuar me ligj të veçantë nr. 9918 dhe ka juridiksion territorial në tërë territorin e Republikës së Shqipërisë. Selia qendërore e AKEP është vendosur në Tiranë dhe me “Vendimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr.88/2015 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)”, ka katër sektorë Rajonale monitorimit dhe inspektimit: Krujë, Shkodër, Korë dhe Vlorë.

4.3 Misioni

AKEP është një rregullator i pavarur dhe pararendës për tregjet e telekomunikacioneve dhe postare duke kërkuar të arrijë një kuadër rregullator që nxit një mjedis të favorshëm për investitorët dhe ofron zgjidhje, çmim dhe cilësi më të mirë për të gjithë përdoruesit e shërbimeve të telekomunikacioneve dhe postare në Shqipëri.

4.4 Vlerat thelbësore të AKEP janë

- Integriteti,
- Paanësia,
- Transparenca,
- Profesionalizmi,
- Efikasiteti.

4.5 Struktura

Për kryerjen e veprimtarisë dhe për realizimin e funksioneve të tij, AKEP-i funksionon sipas strukturës organizative të miratuar me “Vendimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr.88/2015 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)”:

- Këshilli Drejtues,
- Kabineti i Kryetarit,

- Sekretar i KD,
- Drejtoria e Administrimit të Burimeve të Fundme Autorizimeve dhe Faciliteteve,
- Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe e Zhvillimit të Broadband,
- Drejtoria e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit,
- Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Pagesave,
- Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe e Administrimit të Brendshëm;
- Drejtoria e Rregullimit Ekonomik dhe e Statistikave,
- Drejtoria e Shërbimeve Postare dhe Integritimit,
- Drejtoria e Monitorimit të Frekuencave, Cilësisë dhe Inspektimit.

4.6 Kompetencat e AKEP

- Ligji nr.9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (neni 8) përcakton këto kompetenca për AKEP:
 1. Mbikëqyr, kontrollon dhe monitoron veprimtaritë e sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, në përputhje me Ligjin nr.9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet e tjera në zbatim të tij,
 2. Rregullon aksesin dhe interkoneksionin midis rrjeteve të komunikimeve elektronike, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe siguron që sipërmarrësit të mos diskriminohen dhe të kenë mundësi të barabarta, kushte transparente, objektive dhe të ndershme,
 3. Miraton ofertën e referencës për aksesin dhe/ose interkoneksionin, si dhe ofertën e referencës për akses të hapur në rrjetin lokal të sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg, të cilat duhet të jenë në përputhje me kërkesat e Ligjit 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me aktet nënligjore, si dhe tarifa të orientuara në kosto,
 4. Përcakton sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg,
 5. Kryen regjistrimin e sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike në përfundim të procesit të njoftimit,
 6. Ndërmerr dhe përcakton masat mbrojtëse ndaj sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, për të mos lejuar praktika antikonkurruese,
 7. Bashkëpunon me Ministrin për hartimin e Planit Kombëtar të Frekuencave,
 8. Përgatit Planin e Përdorimit të Frekuencave dhe administron brezat e frekuencave të caktuara,
 9. Për qëllime civile, për përdorim publik ose privat, me përjashtim të brezit të frekuencave, të caktuara për transmetime radio e televizione, të cilat administrohen nga KKRT-ja,
 10. Monitoron përdorimin e spektrit të frekuencave, në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave dhe Planin e Përdorimit të Frekuencave,

11. Lëshon Autorizimet Individuale për përdorimin e frekuencave,
12. Kryen procedurat e përcaktuara, sipas Ligjit nr.9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, pas miratimit përkatës,
13. Bashkërendon punën me administratat e vendeve fqinje dhe të vendeve të tjera për caktimin dhe përdorimin e radiofrekuncave, për pjesën e spektrit që administron,
14. Harton, miraton dhe administron Planin Kombëtar të Numeracionit për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë,
15. Cakton numrat dhe seritë numerike të sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike,
16. Administron domain cc.TLD.al, nëndomanet e tij , si edhe ENUM,
17. Merr masat administrative, në përputhje me Ligjin nr.9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar në rast të shkeljeve të këtij ligji dhe të akteve të nxjerra në zbatim të tij,
18. Mbikëqyr respektimin e kërkesave të ligjit për tarifën e shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun dhe merr masat e nevojshme rregullatore në zbatim të këtij ligji,
19. Menaxhon dhe administron fondin e shërbimit universal,
20. Zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike si dhe mosmarrëveshjet ndërmjet pajtimtarëve dhe sipërmarrësve, sipas parashikimeve të Ligjit nr.9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,
21. Krijon, mirëmban dhe përditëson bazën e të dhënave elektronike për sektorin e komunikimeve elektronike dhe siguron që këto të dhëna, në formë informacioni, t’i bëhen të vlefshme publikut, në përputhje me rregullat për informimin publik dhe të ruajtjes së konfidencialitetit,
22. Mbledh të dhëna dhe informacion nga sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike,
23. Nxjerr rregulloret në zbatim të Ligjit nr.9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar , akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi, të cilat janë të detyrueshme për t’u zbatuar,
24. Kryen njohjen e konformitetit për pajisjet “radio” dhe pajisjet fundore të telekomunikacioneve,
25. Merr masat, që sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike të zbatojnë detyrimet, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesave të vendit, të sigurisë publike edhe në rast lufte apo gjendje të jashtëzakonshme,
26. Bashkëpunon me organizatat, kombëtare dhe ndërkombëtare, në fushën e komunikimeve elektronike,
27. Kryen procedurat për përcaktimin e sipërmarrësit të shërbimit universal, sipas kërkesave të përcaktuara në kreun V të këtij ligji,
28. Përcakton rregullat për funksionimin e shërbimit të radiondërlidhjes bregdetare;

29. Përcakton rregullat dhe kërkesat teknike për funksionimin e shërbimeve radioamatore në Republikën e Shqipërisë,
 30. Siguron disponueshmërinë e një baze qendrore të dhënash për portabilitetin e numrit,
 31. Përcakton masa për rregullimin e tarifave, si dhe çmimet maksimale që mund të aplikohen në një seri të caktuar të numrave të përdorur për shërbimet me vlerë të shtuar, premium, me qëllim mbrojtjen e konsumatorëve.
- Ligji nr. 46 /2015 datë 7.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë, (neni 9) për rregullimin postar përcakton këto kompetenca për AKEP:
 1. Jep Autorizimet, në bazë të përcaktimeve të Ligjit nr. 46 /2015 datë 7.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë dhe rregullave të miratuara në zbatim të tij,
 2. Mbikëqyr, kontrollon dhe monitoron veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve postare, në përputhje me Ligjin nr. 46 /2015 datë 7.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet e tjera në zbatim të tij dhe merr masa administrative, në rast të shkeljeve të këtij ligji dhe të akteve të nxjerra në zbatim të tij,
 3. Mbikëqyr respektimin e kërkesave të Ligjit nr. 46 /2015 datë 7.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” për tarifat e shërbimeve postare dhe merr masat e nevojshme rregullatore në zbatim të tij,
 4. Harton dhe miraton rregulloret në zbatim të Ligjit nr. 46 /2015 datë 7.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë të cilat janë të detyrueshme për t’u zbatuar,
 5. Bashkëpunon me organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e rregullimit të shërbimeve postare,
 6. Përcakton ofruesin e shërbimit universal postar, sipas kërkesave të përcaktuara në Ligjin nr. 46 /2015 datë 7.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë dhe mbikëqyr përmbushjen e detyrimeve të shërbimit universal postar,
 7. Kontrollon respektimin e kërkesave thelbësore nga ofruesit e shërbimeve postare,
 8. Harton dhe miraton standardet dhe kushtet teknike për ofrimin e shërbimit postar, në përputhje me rekomandimet e organizatave ndërkombëtare, përfshirë standardet për ofrimin e shërbimit universal postar,
 9. Nxit konkurrencën e lirë dhe efçente, ndërmjet ofruesve të shërbimeve postare, për të garantuar transparencën, mosdiskriminimin dhe ndershmërinë,
 10. Mbledh dhe përpunon të dhëna statistikore dhe financiare nga ofruesit e shërbimeve postare, në përmbushje të detyrave rregullatore në zbatim të Ligjit nr. 46 /2015 datë 7.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë, duke garantuar ruajtjen e sekretit për informacionin e dhënë,
 11. Miraton kushtet dhe termat e përgjithshëm të ofrimit të shërbimit universal postar,
 12. Rregullon tarifat e shërbimit universal postar dhe shërbimeve të tjera specifike, të përcaktuara nga Ligji nr. 46 /2015 datë 7.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë,

13. Zgjidh mosmarrëveshjet midis ofruesve të shërbimit postar,
14. Mbron të drejtat e përdoruesve të shërbimeve postare dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet përdoruesve dhe ofruesve të shërbimeve postare,
15. Bashkëpunon me Autoritetin e Konkurrencës dhe Autoritetin për Mbrojtjen e Konsumatorit në çështjet me interes të përbashkët,
16. Përfaqëson Republikën e Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare rregullatore të shërbimeve postar.

5. Organizimi institucional

5.1 Parimet e Organizimit dhe Funkcionet e Administratës

Administrata e AKEP-it organizohet mbështetur në parimin e shkallëzimit, sipas të cilit vartësit, në çdo nivel, duhet të ndjekin zinxhirin vendimmarrës dhe të komunikojnë me eprorët e tyre nëpërmjet eprorit më të afërt në hierarki, si dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me eprorin direkt (titullarin e institucionit).

Njësitë organizative ngrihen dhe emërtohen sipas funksioneve rregullatore dhe administrative të AKEP-it të përcaktuara në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 i ndryshuar dhe ligjin nr.46/2015 në mënyrë të tillë që të lejojë një ndarje të harmonizuar të funksioneve brenda secilës prej këtyre njësisve organizative dhe të krijojë një mundësi kontrolli dhe mbikëqyrje në mënyrë që asnjë nga njësitë apo zyrtarët të mos ketë kontroll të plotë mbi asnjë proces.

Njësia më e lartë organizative është drejtoria.

Funksionet që kryhen nga administrata e AKEP-it grupohen në tre fusha kryesore:

- a) Funksione rregullatore të fushës,
- b) Funksione të ofrimit të shërbimeve për të tretët sipas legjislacionit,
- c) Funksione të shërbimeve të brendshme mbështetëse.

Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe administrimi i shërbimeve mbështetëse për institucionin Çështjet që lidhen me zhvillimin dhe menaxhimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore si dhe administrimin e shërbimeve mbështetëse për institucionin përbëjnë objektin e veprimtarisë të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Administrimit të Brendshëm të riorganizuar sipas strukturës dhe organikës së re të AKEP-it.

5.2 Struktura organizative e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Të gjendur në kushtet e nevojës së domosdoshme të ushtrimit të veprimtarisë normale me qëllim përmbushjen e objektivave rregullatore në zbatim të ligjit material dhe politikave sektoriale të zhvillimit të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, si dhe në kuadër të përafrimit të plotë të legjislacionit në përputhje me direktivat e Parlamentit dhe Komisionit EU duke

përfshirë edhe organizimin dhe funksionimin e strukturës dhe organikës si organ rregullator me ato të vendeve të Bashkimit Europian, është përcjellë kërkesa e AKEP-it për miratimin nga Kuvendi i Shqipërisë të strukturës dhe organikës duke e përshtatur me kushtet dhe rrethanat aktuale të fushës dhe legjislacionit, si dhe frymës së Qeverisë për reduktimin e shpenzimeve dhe funksionimin me struktura sa më profesionale dhe eficiente.

Në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr.88/2015 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)” është miratuar struktura organizative dhe organika e AKEP, e përbërë nga 73 punonjës.

Përmirësimet në strukturë, kanë qenë në fokusin e politikave të burimeve njerëzore me qëllim rritjen e efikasitetit të veprimtarisë së punës së institucionit, duke forcuar bashkërendimin dhe koordinimin e punëve midis strukturave, përshtatjen e tyre me detyrat e reja që burojnë nga objektivat strategjike të institucionit si dhe arritjen e standardeve evropiane.

Implementimi i strukturës së re, miratuar me Vendim të Kuvendit të Shqipërisë nr.88/2015 të Kuvendit të Shqipërisë “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)” në zbatim të Ligjit Nr.152/2013 “Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi ka mundësuar rritjen e efikasitetit të stafit dhe cilësisë së kapaciteteve të burimeve njerëzore, në përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe rritjes së fleksibilitetit dhe transparencës në ushtrimin e funksioneve, në gjithë veprimtarinë e punës së AKEP.

Nëpërmjet strukturës përkatëse janë mbikëqyrur dhe menaxhuar burimet njerëzore, duke zbatuar ndryshimet në legjislacionin për shërbimin civil, në respektim të parimeve kryesore të tij, për të mundësuar reduktimin e subjektivizmit në procesin e konkurrimit, përzgjedhjes së kandidatëve të kualifikuar profesionalisht, bazuar në merita, transparencë dhe llogaridhënie. E reja e kësaj strukture qëndron te konfigurimi i organigramës sipas zhvillimeve të tregut të komunikimeve elektronike dhe krijimit të një drejtorie të re për rregullimin postar në Shqipëri.

5.3 Këshilli Drejtues

Funksioni i Këshillit Drejtues është drejtimi kolegjial nëpërmjet vendimmarrjes i veprimtarisë së AKEP-it për përmbushjen e përgjegjësisë, detyrave dhe funksioneve të tij, të përcaktuara në ligjin nr. 9918 dhe ligjin nr.46/2015 për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë.

Këshilli Drejtues përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave, për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje jo më shumë se një herë. Kuvendi cakton kryetarin, ndërmjet anëtarëve të Këshillit Drejtues. Kryetari i Këshillit Drejtues është drejtuesi ekzekutiv i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Figure 1 Organigrama e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare




Figure 2 Përbërja strukturore sipas funksioneve në AKEP





Figure 3 Përbërja gjinore dhe arsimore për vitin 2015



Forcimi i kapaciteteve institucionale ka qenë një nga prioritetet e vitit 2015, pasi është konsideruar si një nga faktorët kryesorë për pavarësinë reale të institucionit të AKEP. Burimeve njerëzore janë orientuar në drejtim të rritjes profesionale të stafit dhe të nivelit të ekspertizës, forcimit dhe ruajtjes së një mjedisi pune motivues dhe llogaridhënës për punonjësit, arritjes së qëndrueshmërisë dhe vazhdueshmërisë afatgjate të kapaciteteve administrative si dhe përmirësimit të bazës rregullative dhe strukturës organizative të AKEP.

Risitë e ligjit të nëpunësit civil janë përdorur si instrumenta për të ndërtuar sistemin e matjes së performancës reale të secilit prej nëpunësve të AKEP duke synuar rritjen e motivimit.

6. Kërkesat e Kuvendit nga AKEP për vitin 2015

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në kuadër të vlerësimit të veprimtarisë së AKEP për vitin 2014, me Rezolutë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2014”, për vitin 2015 rekomandonte:

1. Forcimin e rolit të AKEP-it në mbrojtjen e konsumatorit (përdoruesve) në tregun e komunikimeve elektronike dhe postare, për të garantuar mbrojtjen e interesave të përdoruesit në aspektin individual, mbrojtjen e interesave të përdoruesve në tërësi nga sjelljet diskriminuese dhe antikonkurruese të operatorëve në tregun e komunikimeve elektronike, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues të të gjithë përdoruesve, si dhe një monitorim dhe kontroll të shërbimeve që i ofrohen përdoruesve,
2. Të monitorojë në mënyre të vazhdueshme tregun e komunikimeve elektronike me qëllim uljen e tarifave të tregut,
3. Të mbajë në mbikëqyrje të vazhdueshme situatën në tregun komunikimeve elektronike dhe postare, në veçanti atë të telefonisë celulare, duke i kushtuar një rëndësi të veçantë detyrimeve të vendosura pas përfundimit të analizës së tregut të telefonisë celulare, për të garantuar trajtim të barabartë, si dhe konkurrencë të ndershme dhe jodiskriminuese në mbarevajtjen e tij,
4. Të intensifikojë bashkëpunimin me institucionet, veprimtaria e të cilave është e lidhur dhe ndikon në çështje që kanë të bëjnë me tregun e komunikimeve elektronike dhe postare, në mënyrë të veçantë me Autoritetin e Konkurrencës, në kuadër të efektit që kanë në tregun e telefonisë celulare vendimet e marra nga AKEP-i pas rekomandimeve të AK-së dhe përfundimit të analizës së këtij tregu nga AKEP-I,
5. Me miratimin e projektligjit për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë në Kuvend, të marrë masat e nevojshme për përgatitjen e kuadrit rregullator për shërbimin postar, miratimin e akteve nënligjore, rregulloreve e metodikave të nevojshme, të cilat kërkohen në kuadër të zbatimit të tij,
6. Në kuadër të ligjit të ri "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë", të marrë masat e nevojshme për mbikëqyrjen e tregut dhe ndjekjen e përmbushjes së detyrimeve të ofruesve të shërbimit postar të autorizuar si një detyrë e rëndësishme e organit rregullator (AKEP),
7. Në kuadër të detyrave që lindin nga legjislacioni i ri i përmirësuar, të marrë masa për nxitjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në shërbimin postar, përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit, sigurimin e ofrimit të shërbimit universal postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe mbrojtjen e interesave të përdoruesve dhe sigurimin e trajtimit të barabartë të tyre,
8. Të marrë masat e nevojshme për publikimin e numërorit telefonik, si një kërkesë e shërbimit universal, si dhe shërbimet e kërkimit në numëror,
9. Të rrisë përpjekjet për forcimin e profesionalizmit dhe të pavarësisë operacionale të stafit të entit,
10. Të marrë masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e një rregulloreje, e cila, bazuar në ligjin për komunikimet elektronike, të japë disa drejtime dhe orientime për

marrëdhëniet midis sipërmarrësve në rastin e shfrytëzimit të faciliteteve të përbashkëta. Kjo do të jetë një rregullore ku do bazohen palët në rastin e mosmarrëveshjeve për tarifën e infrastrukturës.

11. Të bashkëpunojë me Ministrin për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe aktorët e tjerë, lidhur me situatën e kabllave ajrorë, në mënyrë që nga njëra anë të bëhet e mundur që brenda një afati kohor të arsyeshëm të krijohet infrastruktura e nevojshme për zhvendosjen dhe sistemimin e kabllave dhe nga ana tjetër të mbajë parasysh impaktin të konsumatorit lidhur me shërbimet e telefonisë, internetit dhe shërbime të tjera me rëndësi për qytetarët që ofrohen përmes këtij rrjeti,
12. Të marrë masat e nevojshme për konsolidimin e bashkëpunimit të AKEP-it me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, lidhur me monitorimin e procesit të shkatërrimit të të dhënave personale të shtetësave, nga kompanitë celulare, si një detyrim që kompanive u rrjedh nga ligji i AKEP-it,
13. Të ndjekë dhe të monitorojë procesin e portabilitetit të numrit, në mënyrë që nga operatorët të mos ketë vonesa të pabazuara kur përdoruesit dëshirojnë të bëjnë portimin e numrit të tyre,
14. Të marrë masat e nevojshme për implementimin e projektit për krijimin e Sistemit Kombëtar të Monitorimit të Frekuencave, duke zhvilluar Qendrën Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave,
15. Të marrë masat e nevojshme për ndjekjen e procesit të dhënies së të drejtave të përdorimit për kanalet e lira në brezin 900 MHz dhe 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/ËiMAX,
16. Të marrë masat e nevojshme për kryerjen e analizës së tregut të telefonisë fikse,
17. Të vijojë të angazhohet në zbatimin e politikave nxitëse për një penetrim më të madh të telefonisë fikse dhe të aksesit "broadband", të cilat mbeten në nivele të ulëta,
18. Të vazhdojë të angazhohet në administrimin me efektivitet të spektrit të frekuencave,
19. Me gjithë rritjen e numrit gjatë vitit 2014, të vijojë inspektimin e sipërmarrësve të tregut të komunikimeve elektronike dhe postare për evidentimin e rasteve të shkeljeve dhe marrjen e masave sipas legjislacionit përkatës,
20. Të kontrollojë periodikisht brezat e frekuencave deri në 18GHz dhe të monitorojë brezat e frekuencave 2,6GHz, 2,4GHz, 5,8GHz, si dhe të ndjekë me përgjegjshmëri problematikat që dalin nga ndërhyrjet e dëmshme (interferencat).

7. Përshkrim i fushave që mbulon institucioni

Fushat që mbulon veprimtaria e AKEP si organ rregullator kompetent, bazuar në legjislacionin e përcaktuar në:

Ligj Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe

Ligj Nr. 46/2015 datë 7.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, janë:

- Tregu i ofrimit të rrejeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike,
- Tregu i ofrimit të shërbimeve postare.

7.1 Tregu i Komunikimeve Elektronike

7.1.1 Zhvillimi i tregut të komunikimeve elektronike

Tendencat kryesore të tregut të komunikimeve elektronike në vitin 2015 ishin:

- Ndryshime të ndjeshme të paketave tarifore të thirrjeve në rrjetet celulare dhe strukturës së thirrjeve celulare (rritje e ndjeshme e sasisë së thirrjeve off-net dhe reduktim i sasisë së thirrjeve on-net),
- Rritje e ndjeshme e përdorimit të shërbimeve të aksesit broadband nga rrjete rrjete celulare 3G/4G sidomos me fillimin e ofrimit të shërbimeve në rrjetet 4G (Tremujori i III 2015),
- Rënie e përdorimit të shërbimeve të telefonisë fikse (pajtimtarë dhe thirrje),
- Rritje e ndjeshme e numrit të pajtimtarëve me akses broadband nga rrjete fikse,
- Rritje e përdorimit të përbashkët të infrastrukturës aktive (bitstream) dhe pasive (tubacione) të rrjetit fikse të operatorit incumbent Albtelecom.

7.1.2 Tregues Financiarë të sektorit⁵


7.1.2.1 Të Ardhurat

Të ardhurat totale të sipërmarrësve në tregun e komunikimeve elektronike për vitin 2014 ishin rreth 42.2 miliard lek, krahasuar me 50.2 miliard lek në vitin 2013. Në vitin 2014 të ardhurat patën reduktim me 16% në krahasim me vitin 2013, duke vazhduar tendencën rënëse të të ardhurave që nga viti 2009 (përveç vitit 2012 ku pati rritje). Rënien më të madhe nga

⁵ Të dhënat financiare të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike raportohen në AKEP më datë 10 Prill të çdo viti, dhe në këtë raport të dhënat financiare më të fundit dhe tregues të tjerë të lidhur me to kanë si referencë vitin 2014, përveç rasteve kur shprehet ndryshe.

sipërmarrësit e mëdhenj e pati Albtelecom për shërbimet e rrjetit fiks me 33%, pasuar nga Vodafone me 17%.


Figure 4 Të ardhurat sipërmarrësve të komunikimeve elektronike (2008-2014)



Burimi: Te dhenat e operatoreve të deklaruar në AKEP.

Të ardhurat nga shërbimet celulare përbëjnë rreth 77% të të ardhurave të sektorit, ndërsa të ardhurat nga shërbimet e rrjeteve fikse 23%. Të ardhurat e operatorëve alternativë përbëjnë 8% të të ardhurave të të gjithë sektorit.

Figure 5 Të ardhurat totale të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike (2014)




Burimi: Të dhënat e operatorëve të deklaruar në AKEP

Të ardhurat e operatorëve celularë në 2014 u reduktuan me 13%, nga 37 miliard lekë në 2013 në 32 miliard lekë në 2014. Rënien më të madhe e patën Plus dhe Vodafone respektivisht me 16 dhe 17%, ndërsa Albtelecom dhe AMC patën rënie të vogla me 6 dhe 7%. Pjesa e tregut e Vodafone u reduktua nga 50% në 2013 në 47% në 2014.

Në vitin 2015⁶ të ardhurat totale të operatorëve celularë ishin rreth 33 miliard lek që përbën një rritje me 3% në krahasim me vitin 2014. Vodafone, Telekom Albania dhe Albtelecom patën rritje të vogla respektivisht me 1 dhe 2% të të ardhurave, ndërsa bie në sy rritja e të ardhurave të Plus me 20%, apo rreth 361 milion lek. Të ardhurat e Albtelecom nga shërbimet e rrjetit fiks u reduktuan me 4% në krahasim me vitin 2014.

⁶ Të dhënat për 2015 janë raportuar nga operatorët, por janë ende paraparake objekt saktësimi.

Figure 6 Ecuria e të ardhurave të operatorëve celularë 2008-2015



Burimi: Raportimet e operatorëve.

7.1.3 Shërbime të rrjeteve Celulare

Tabela e mëposhtme paraqet disa tregues kryesorë të volumit të shërbimeve celulare për vitet 2013-2015 dhe normën e ndryshimit vjetor të tyre.

Tabela 1 Tregues kryesorë të volumit të shërbimeve celulare 2013-2015

Treguesi/viti	2013	2014	2015	Ndryshimi vjetor 2015/2014
Numri i përdoruesve aktivë	3,685,983	3,359,654	3,400,955	1%
Numri i përdoruesve sipas kartave SIM	5,282,350	4,881,666	4,736,175	-3%
Numri pajtimtarëve që kanë përdorur akses në Internet broadband UMTS:	1,231,259	907,975 ⁷	1,297,281	43%
Nëpërmjet aparatit celular	1,119,892	787,650	1,175,341	49%
Nëpërmjet USB (jo aparate celulare)	111,367	120,325	121,940	1%
Thirrje telefonike (dalëse) të gjeneruara nga përdoruesit (minuta)	6,769,300,966	7,301,024,035	7,409,377,519	1%
Numri i mesazheve SMS të gjeneruara	1,689,200,882	1,826,346,190	1,599,360,701	-12%

Nga të dhënat e tabelës vihet re se numri i përdoruesve të shërbimeve celulare (GSM) dhe sasia e thirrjeve të gjeneruara nga përdoruesit celularë në vitin 2015 nuk ka pasur ndryshime të ndjeshme në krahasim me vitin 2014 (rritje me 1% ose reduktim me 3%). Përdorimi i

⁷ Ndryshimi i madh në 2014 në krahasim me 2015 dhe 2013 vjen edhe për shkak të ndryshimit të mënyrës së raportimit të këtij treguesi.

mesazheve SMS pati reduktim të ndjeshëm me 12%. Ndërsa përdorimi i shërbimeve tradicionale celulare (thirrje, SMS) ishte me ulje ose i qëndrueshëm në krahasim me vitin 2014, përdorimi i shërbimeve të aksesit broadband UMTS (3G/4G) pati rritje të ndjeshme në vitin 2015, dhe numri i përdoruesve që kanë përdorur aksesin broadband celular është rritur me 43%.

7.1.3.1 Numri i përdoruesve celularë


Numri i përdoruesve celularë matet dhe raportohet në dy mënyra:

- Numri i përdoruesve sipas kartave ‘SIM’ që i referohet numrit të kartave SIM që janë aktive⁸ në rrjet celular në fund të periudhës së raportimit,
- Numri i ‘përdoruesve aktivë’ i referohet numrit të pajtimtarëve celularë që kanë përdorur shërbime celulare në 3 muajt e fundit (nga fundi i periudhës së raportimit).

Numri i përdoruesve celularë aktivë në fund të vitit 2015 ishte 3.40 milion, që përbën një rritje të vogël me 1% në krahasim me vitin 2014 (3.36 milion përdorues aktivë). Altelecom dhe Vodafone patën rritje me 12% dhe 4% respektivisht, ndërsa TA dhe Plus patën reduktim me 3% dhe 16% respektivisht. Përsa i përket numrit të përdoruesve sipas kartave SIM në fund të 2015 ishin rreth 4.7 milion përdorues që përbën një reduktim me 3% në krahasim me vitin 2014. Vodafone, Altelecom dhe Plus patën rritje me 2-16%, ndërsa TA pati reduktim me 19%.


Tendenca në rënie e numrit të kartave SIM në 3 vitet e fundit si dhe qëndrueshmërisë së numrit të përdoruesve aktivë në 2 vitet e fundit gjykohet se kanë ardhur për shkak të reduktimit të zotërimit të disa kartave SIM nga një përdorues.

Figure 7 Ecuria e numrit të përdoruesve aktivë celularë 2010-2015



⁸Secili operator ka politikat e veta se kur një kartë SIM (me parapagim) është aktive (që mund të kryejë komunikim) në varësi të kohës së rimbushjes apo përdorimit të fundit të saj.

Figure 8 Ecuria e numrit të përdoruesve celularë sipas karatve SIM 2000-2015



Proporcioni i përdoruesve aktivë ndaj kartave SIM aktive në 2015 ishte 72% për të katër operatorët së bashku, duke variuar nga 55% për Plus 80% për Vodafone. Norma e penetrimit (përdorues për 100 banorë) në fund të 2015 ishte 120% sipas përdoruesve aktivë dhe 167% sipas kartave SIM.

Ndryshimi më i ndjeshëm në numrin e përdoruesve celularë është vënë re në segmentin e përdoruesve me kontratë, numri i të cilëve u reduktua me 17% në krahasim me vitin 2014. Numri i përdoruesve aktivë me parapagim u rrit me 3%.

Në fund të vitit 2015 përdoruesit me parapagim përbënin 93% të numrit total të përdoruesve aktivë celularë krahasuar me 92% në 2014. Vodafone dhe T-Albania kanë 95% të përdoruesve aktivë me parapagim ndërsa për Altelecom dhe Plus ky proporcion është respektivisht 85% dhe 90% .

7.1.3.2 Shërbimet 3G/4G:

Numri i përdoruesve aktivë (përdorim 3 muajt e fundit) të shërbimeve me akses broadband nga rrjetet celulare (3G/4G nga aparatet celulare dhe me karta USB/modem) në vitin 2015 ishte rreth 1.3 milion apo 43% më shumë se në vitin 2014. Përdorimi i aksesit broadband nga rrjetet 3G/4G është rritur me 49% për aksesin nëpërmjet aparateve celulare dhe me vetëm 1% nëpërmjet aparateve të tjerë me USB/Modem.


Penetrimi për popullsi i përdoruesve aktivë celularë të aksesit broadband nga rrjetet 3G dhe 4G arriti në 46% në fundvitin 2015 krahasuar me 35% në fundvitin 2014. Të tre operatorët me rrjete 3G/4G kanë pasur rritje të numrit të përdoruesve aktivë të shërbimeve akses broadband nëpërmjet aparateve celulare. Vodafone dhe Altelecom kanë pasur reduktim të numrit të përdoruesve me karta USB/modem, ndërsa Telekom Albania ka pësuar rritje të këtij treguesi.

Tabela 2 Ecuria e numrit të përdoruesve aktivë të aksesit broadband nga rrjet celular⁹

	Telekom Albania		Vodafone		Albtelecom(EM)		Total	
	Aparat celular	USB/Modem	Aparat celular	USB/Modem	Aparat celular	USB/Modem	Aparat celular	USB/Modem
2011	46,000	9,000	202,756	25,493			248,756	34,493
2012	222,882	17,833	371,426	37,572			594,308	55,405
2013	279,428	32,138	568,207	66,086	272,257	13,143	1,119,892	111,367
2014	163,797	61,549	503,855	46,341	119,998	12,435	787,650	120,325
2015	278,886	97,087	686,805	20,075	209,650	4,778	1,175,341	121,940
Ndryshimi 2015/2014	70%	58%	36%	-57%	75%	-62%	49%	1%

Të dhënat periodike sipas tremujorëve tregojnë se rritja e ndjeshme e përdoruesve të aksesit broadband në rrjete celulare gjatë vitit 2015 ka ndodhur në Tremujorin e III 2015, kur operatorët celularë filluan ofrimin e shërbimeve me rrjete 4G.

Figure 9 Numri i përdoruesve aktive të aksesit broadband nga rrjete celulare



Rritja e përdorimit të aksesit broadband nga rrjetet celulare 3G/4G në vitet e fundit vihet re dhe në rritjen e volumit të të dhënave të transmetuara në rrjetet celulare. Në vitin 2014 rritja vjetore e trafikut të të dhënave në rrjetet celulare ishte 148%, dhe kjo tendencë vlerësohet se ka vazhduar edhe në vitin 2015.


7.1.3.3 Trafiku telefonik dhe SMS

Trafiku i gjeneruar nga rrjetet celulare gjatë vitit 2015 arriti në rreth 7.4 miliard minuta, e cila përbën një rritje të vogël me rreth 1.5 % në krahasim me vitin 2014. Megjithatë sasia totale e thirrjeve nuk pati ndryshim të madh, llojet e ndryshme të thirrjeve patën ndryshime të ndj-

⁹ Të dhënat për vitet 2011-2013 janë për numrin e përdoruesve që kanë përdorur të paktën 1 herë gjatë vitit aksesin broadband në rrjet celular, ndërsa për vitet 2014-2015 numri i pajtimatrëve me përdorim të paktën 1 herë gjatë 3 muajve të fundit të vitit.

eshme. Në vitin 2015 thirrjet brenda rrjetit u reduktuan me 16% ndërsa thirrjet drejt rrjeteve të tjera celulare (off-net) u rritën me 2.4 herë në krahasim me vitin 2014. Rritje të ndjeshme patën dhe thirrjet drejt rrjeteve fikse dhe thirrjet ndërkombëtare me 37 - 41%. Këto ndryshime kanë sjellë dhe ndryshim të strukturës së trafikut dalës gjatë vitit 2014 siç mund të vëhet re nga grafiku i mëposhtëm.

Figure 10 Ecuria e strukturës së trafikut dalës celular (2003-2015)



Pesha e thirrjeve brenda rrjetit ndaj totalit të thirrjeve dalëse në vitin 2015 u reduktua në 69% krahasuar me 84% në 2014. Pesha e këtyre thirrjeve për Vodafone dhe Telekom Albania në 2015 ishte respektivisht 75 dhe 77% krahasuar me 87 dhe 88% në 2014. Edhe tek Albtelecom dhe Plus është vënë re reduktim i peshës së këtyre thirrjeve nga 58 dhe 67% në 2014 në 40 dhe 41% në 2015. Sasia e thirrjeve drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare pati rritjen më të madhe në 2015 dhe pesha e tyre në totalin e thirrjeve dalëse celulare në 2015 arriti në 18% krahasuar me 8% në 2014.

Thirrjet ndërkombëtare kanë pasur rritje të ndjeshme në 2015 dhe pesha e tyre arriti në 12% krahasuar me 8% në 2014. Sasia e thirrjeve drejt rrjeteve fikse pati rritje të ndjeshme në 2015, por nuk ka ndikuar në peshën e tyre në totalin e thirrjeve dalëse, e cila vazhdon të jetë 1%. Më shumë detaje për ndryshimet në strukturën e trafikut të thirrjeve celulare gjatë vitit 2015 janë dhënë në seksionin e masave rregulluese.

Numri i mesazheve SMS të dërguara nga përdoruesit celularë në 2015 u reduktua me 12% në krahasim me 2014. Kjo tendencë është e kundërt me rritjet e ndjeshme vjetore në 2013 dhe 2014.

Rënia e përdorimit të mesazheve SMS dhe rënia e ndjeshme e normës së rritjes së thirrjeve telefonike në rrjetet celulare gjykohet se kanë ardhur për shkak të rritjes së ndjeshme të përdorimit të aksesit në Internet në rrjetet celulare dhe efektit të zëvendësimit të mesazheve SMS dhe thirrjeve me mesazhe/thirrje nga aplikacionet OTT (Over The Top) në Internetin në aparat celular si ëhatsup, viber etj.

7.1.3.5 Pjesët e tregut

Pjesët e tregut të operatorëve celularë për treguesit kryesorë në periudhën 2010-2015 së bashku me indeksin HHI të përqëndimit janë dhënë në Tabelë. Nga të dhënat vihet re se:

- Për treguesit e numrit të përdoruesve,
 - Vodafone Albania ka pasur rritje me 1-3 pikë përqindje në pjesën e tregut të numrit total të përdoruesve dhe reduktim me 2 pikë përqindje në përdoruesit me kontratë,
 - Telekom Albania ka humbur 1-6 pikë përqindje në pjesën e tregut të numrit total të përdoruesve dhe rritje me 5 pikë përqindje në përdoruesit me kontratë,
 - Albtelecom (EM) dhe Plus kanë fituar ose kanë humbur 1-2 pikë përqindje pjesë tregu të numrit total të përdoruesve dhe përdoruesit me kontratë,
 - Albtelecom (EM) dhe Plus kanë fituar 1-2 pikë përqindje pjesë tregu në thirrjet dalëse ndërsa Vodafone dhe Telekom Albania kanë humbur 1-2 pikë përqindje pjesë tregu për këtë tregues,
 - Pjesa e tregut e Vodafone për SMS vazhdon të jetë e lartë me 66% pa ndryshim nga viti 2014. Telekom Albania dhe Plus kanë humbur pjesë tregu me 1 pikë përqindje secila, ndërsa Albtelecom ka fituar 2 pikë përqindje pjesë tregu.
- Pjesa e tregut në të ardhura të operatorëve celularë nuk kanë ndryshime të ndjeshme në 2015. Plus ka rritur pjesën e tregut me 1 pikë përqindje, ndërsa Vodafone dhe Telekom Albania kanë pasur reduktime të vogla me më pak se 1 pikë përqindje secili. Vodafone rezulton me 47% pjesë tregu të qëndrueshme në dy vitet e fundit.

Tabela 3 Pjesët e tregut celularë për disa tregues kryesorë 2010-2015

	Viti	Telekom Albania	Vodafone	Albtelecom(EM)	Plus	HHI
Përdorues Aktivë	2015	31.9%	47.4%	14.2%	6.5%	3508
	2014	33.2%	46.1%	12.9%	7.8%	3458
	2013	37.5%	45.0%	11.5%	6.0%	3574
	2012	39.8%	42.2%	12.3%	5.7%	3544
	2011	37.0%	43.7%	13.4%	5.9%	3510
Përdorues (Karta SIM)	2015	32.6%	42.5%	16.4%	8.5%	3211
	2014	38.8%	40.3%	13.8%	7.1%	3370
	2013	39.0%	42.4%	12.8%	5.8%	3490
	2012	33.4%	35.9%	25.3%	5.4%	3046
	2011	36.7%	34.6%	21.2%	7.6%	3099
Përdorues me Kontratë	2015	24.7%	34.8%	31.5%	9.0%	2896
	2014	19.5%	36.8%	33.6%	10.0%	2969
	2013	37.4%	22.2%	20.6%	19.8%	2694
	2012	30.5%	18.2%	35.9%	15.3%	2806

	2011	35.0%	24.2%	34.3%	6.5%	3006
	2010	42.9%	30.0%	26.8%	0.4%	3478
	2015	32.0%	49.1%	13.0%	5.9%	3641
	2014	33.6%	50.2%	11.0%	5.2%	3801
Thirrje dalëse	2013	39.0%	51.0%	7.0%	3.0%	4180
	2012	39.0%	50.0%	8.0%	3.0%	4094
	2011	37.0%	51.0%	10.0%	2.0%	4074
	2015	18.1%	65.8%	8.1%	8.0%	4786
	2014	19.4%	66.4%	4.7%	9.5%	4897
SMS dalëse	2013	21.0%	73.0%	5.0%	1.0%	5796
	2012	20.0%	73.0%	6.0%	1.0%	5766
	2011	27.0%	64.0%	8.0%	1.0%	4890
	2015	34.3%	47.0%	12.2%	6.6%	3573
	2014	34.8%	47.4%	12.2%	5.6%	3634
Të ardhura	2013	32.7%	50.1%	11.4%	5.9%	3741
	2012	29.3%	56.0%	10.3%	4.4%	4119
	2011	33.7%	51.9%	12.4%	1.9%	3993

7.1.3.6 Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare:

Në vijim është dhënë një tabelë me të dhëna për përdorimin mesatar mujor të thirrjeve telefonike dhe mesazheve SMS për përdorues celularë në 2010 deri në 2014, sipas dy treguesve të përdoruesve: përdorues aktiv dhe karta SIM. Përdorimi mesatar mujor për përdorues është llogaritur sipas thirrjeve dalëse (thirrje që gjenerohen nga një përdorues) dhe thirrjeve hyrëse (thirrjet e marra nga një përdorues), të matura në minuta.

Tabela 4 Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare 2010-2015¹⁰

	2011	2012	2013	2014	2015	Ndryshimi 2015/2014
Përdorues Aktive						
Thirrje dalëse në muaj	130	152	156	172	183	6%
Thirrje të marra (hyrëse) në muaj	147	168	167	168		
MOU*	277	320	323	341		
SMS (dalëse) në muaj	19	35	39	43	39	-9%
Përdorues Karta SIM						

¹⁰Të dhënat e plota për këtë llogaritjen e këtyre treguesve për vitin 2015 janë të disponueshëm vetëm pas datës 10 Prill 2016.

Thirrje dalëse në muaj	83	93	103	120	128	7%
Thirrje të marra (hyrëse) në muaj	94	103	111	117		
MOU*	177	196	214	237		
SMS (dalëse) në muaj përdorues SIM	12	21	26	30	28	-7%

Gjatë vitit 2015, një përdorues celular aktiv (që ka kryer komunikim në 3 muajt e fundit) ka kryer mesatarisht 183 minuta thirrje dalëse dhe ka marrë dhe ka dërguar 39 mesazhe SMS në muaj. Këto vlera përdorimi janë më të vogla nëse si numër përdoruesish celular i referohemi numrit të kartave SIM aktive, 128 minuta dalëse dhe 28 SMS në muaj. Sasia e thirrjeve në minuta të gjeneruara (dalëse) mesatarisht gjatë një muaji në vitin 2015 është rritur me 6% në krahasim me 2014 nga një përdorues aktiv dhe me 7% nga përdorues të kartave SIM. Përdorimi i mesazheve SMS ka pasur reduktim me 7-9% për përdoruesit e kartave SIM dhe përdoruesit aktive celulare.

7.1.3.7 Tarifat celulare

Tregues të tarifave celulare apo të shpenzimeve të përdoruesve celularë përfshijnë treguesit e ARPU¹¹ dhe ARPM¹², që masin të ardhurën mesatare të operatorëve (shpenzimin mesatar të përdoruesve) për përdorues dhe për minutë. ARPM apo e ardhura mesatare për minutë tregon cmimin që një përdorues celular paguan mesatarisht për një minutë thirrje telefonike, ndërsa ARPU tregon sa lek shpenzon mesatarisht një përdorues celular për shërbime celulare në vit apo në muaj. Vlerat e këtyre treguesve për periudhën 2010-2015 janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

Tabela 5 Ecuria e ARPM dhe ARPU 2010-2014¹³

	ARPM (Lekë/minutë)	ARPU (Lekë/vit)	ARPM Ndryshimi vjetor (%)	ARPU Ndryshimi Vjetor (%)
2010	6.49	8,594		
2011	5.35	8,319	-18%	-3%
2012	3.92	7,132	-27%	-14%
2013	3.13	5,863	-20%	-18%
2014	2.63	5,447	-16%	-7%

Shënim: Vlerat pa TVSH

¹¹ARPU (Average Revenue Per Users-E Ardhura Mesatare Për Përdorues): E ardhura mesatare për përdorues e matur si raporti i të ardhurave në retail të operatorëve me numrin mesatar të përdoruesve (aktivë) gjatë një viti.


¹²ARPM (Average Revenue Per Minute-E Ardhura Mesatare Për Minutë): Treguesi i ARPM llogaritet nga AKEP në bazë të të dhënave që dërgojnë operatorët për të ardhurat dhe thirrjet telefonike. Për shkak të ofertave/shportave që kanë një pagesë fikse dhe përfshijnë përveç thirrjeve edhe SMS dhe kapacitet Internet, vlerat e këtij treguesi mund të mos pasqyrojnë saktë të ardhurën mesatare retail për një minutë thirrje, megjithatë ai është një tregues i përafërt dhe mund të konsiderohet vlera maksimale kur si të ardhura përdoren të ardhurat totale retail

¹³ Të dhënat e plota për këtë llogaritjen e këtyre treguesve për vitin 2015 janë të disponueshem vetëm pas datës 10 Prill 2016

Nga tabela vihet re se ARPM dhe ARPU kanë tendencë rënëse dhe për vitin 2014 vlerat e tyre janë reduktuar me 16% dhe 7% respektivisht. Në vitin 2014 një përdorues celular ka paguar mesatarisht 3.16 lekë/minutë (me TVSH) për thirrjet telefonike dhe ka shpenzuar mesatarisht 545 lekë/muaj (me TVSH) për shërbime celulare.

Niveli i këtyre treguesve në Shqipëri është shumë më i ulët se niveli mesatar në vendet e BE dhe ndër më të ulët në rajon. ARPM për Shqipërinë ishte në nivelin 1.9 eurocent në 2014. Nga krahasimi duket se Shqipëria ka ARPM të njëjtë me vlerat më të ulëta të ARPM në vendet e BE në 2011, Lituania me 1.9 eurocent dhe Rumania me 2.2 eurocent. Ndërkohë mesatarja e BE në 2011 ishte 9.1 eurocent, apo rreth 5 herë më e lartë se ARPM e Shqipërisë në 2014.


Figure 11 ARPM në vendet e BE dhe Shqiperi (2011/2014)



Burimi: KE, Digital Agenda Scoreboard dhe AKEP

ARPU tregon tendencë të ngjashme me ARPM, të vendeve të BE me njëra-tjetrën dhe të Shqipërisë në krahasim me vendet e BE. ARPU në vitin 2014 në Shqipëri ishte 39 euro/vit, që është 17% më e ulët se Latvia me nivelin më të ulët në BE me 47 euro. Niveli mesatar i ARPU në BE në 2013 ishte 168 euro apo rreth 4.3 herë më e lartë se ARPU e Shqipërisë në 2014.

Figure 12 ARPU në vendet e BE dhe Shqipëri (2013/2014)



Burimi: KE, Digital Agenda Scoreboard dhe AKEP

7.1.4 Shërbimet nga rrjetet fikse

7.1.4.1 Telefonia fikse

Shërbimet e telefonisë fikse në Shqipëri ofrohen nga rreth 80 sipërmarrës, të cilët zotërojnë rrjetet/infrastrukturën e tyre, përfshirë rrjetin e aksesit apo të lidhjes direkte me përdoruesit fundorë. Siç vihet re edhe nga Figura 1.11 numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse ka patur një rënie të vazhdueshme në katër vitet e fundit duke filluar nga viti 2012. Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2015 ishte rreth 227 mijë, që përbën një rënie me rreth 2% në krahasim me vitin 2014.¹⁴ Rënien e theksuar në 2014 erdhi edhe për shkak të ndryshimit të mënyrës së raportimit të këtij treguesi që në dy vitet e fundit i referohet numrit të përdoruesve aktive (me përdorin në 3 muajt e fundit të telefonisë fikse për përdoruesit me parapagim). Numri i pajtimtarëve të Albetelecom në 2015 pati një reduktim të vogël me 1% në krahasim me 2014. Norma e penetrimit për telefoninë fikse (numër pajtimtarësh për 100 banorë) arriti në 8%, që është shumë më e ulët se në vendet e BE apo edhe të rajonit.

¹⁴ Të dhënat e vitit 2014 të raportuara më parë janë rishikuar për shkak të ndryshimit të numrit të raportuar nga ASC dhe Nisatel.

Figure 13 Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2000-2015





Tabela e mëposhtëme paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse të operatorëve kryesorë në periudhën 2010-2015. Nga të dhënat vihet re se numri i pajtimtarëve të operatorëve alternativë ka luajtje të mëdha ndër vite dhe kjo vjen për shkak të ndryshimit të përkufizimit të treguesve të raportimit, ku tashmë i vihet theksi përdoruesve aktivë. Megjithë efektin e ndryshimit të përkufizimit apo raportimit të këtij treguesi, tendenca në rënie është e dukshme për disa vite rradhazi tashmë.

Tabela 6 Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse 2010-2015

	Albtelecom	Abcom	ASC	Nisatel	T-Albania Fiks	OA të tjere	Total
2010	277,763	19,975	7,408	5,900	NA	20,456	331,502
2011	258,943	27,167	10,129	4,950	7,565	30,090	338,844
2012	230,397	33,000	7,649	5,500	6,119	28,996	311,661
2013	210,382	13,680	15,047	7,166	6,950	27,975	281,200
2014	182,591	15,531	3,379	4,226	2,550	22,115	230,392
2015	180,735	12,316	4,649	4,828	2,674	21,516	226,718
Ndryshimi 2015/2014	-1%	-21%	38%	14%	5%	-3%	-2%

Figura e mëposhtëme paraqet pjesët e tregut të operatorëve kryesorë të telefonisë fikse, ku vihet re Albtelecom ka 80% pjesë tregu në 2015, ndërsa Abcom si operatori më i madh alternativ ka vetëm 5% pjesë tregu.

Figure 14 Pjesët e tregut të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2010-2015



Të dhënat për numrin e pajtimtarëve sipas qarqeve tregojnë se rreth 46% e të gjithë pajtimtarëve të telefonisë fikse janë në qarkun Tiranë. Qarqet me penetrim më të madh të telefonisë fikse janë Tirana, Vlora, Gjirokastra dhe Korça me 9-13.4%, ndërsa qarqet me penetrim më të ulët janë Kukësi dhe Dibra me më pak se 3%.

Rënia e përdorimit të shërbimeve të telefonisë fikse vihet re edhe në reduktimin e sasisë totale të thirrjeve të gjeneruara nga rrjetet fikse. Sasia e thirrjeve telefonike të gjeneruara nga pajtimtarët e rrjetit fiks të Albtelcom në Tremujorin IV 2015 u reduktua me 19% në krahasim me Tremujorin IV 2014, ndërsa gjatë vitit 2015 një përdorues i rrjetit fiks të Albtelcom gjeneroi mesatarisht 67 minuta thirrje në muaj, një reduktim me 17% në krahasim me vitin 2014.

7.1.4.2 Aksesi broadband nga rrjete fikse

Numri pajtimtarëve

Megjithëse shërbimet e telefonisë nga rrjetet fikse kanë pasur reduktim të ndjeshëm në vitet e fundit, shërbimet e aksesit Broadband nga rrjete fikse kanë vazhduar të kenë rritje të qëndrueshme në 5 vitet e fundit. Numri pajtimtarëve me akses broadband fiks në fundvitin 2015 arriti në rreth 243 mijë, që përbën një rritje me rreth 17% në krahasim me fundvitin 2014. Norma e penetrimit për popullsi dhe për familje e pajtimtarëve me akses broadband fiks në fund të vitit 2015 ishte 9% dhe 33% përkatësisht. Albtelcom dhe 3 operatorët kryesorë alternativë patën rritje të numrit të pajtimtarëve me 5 dhe 18%. Pjesët e tregut të këtyre operatorëve kanë qenë të qëndrueshme dhe Albtelcom zotëron 40% të tregut.

Figure 15 Ecuria e numrit të pajtimtarëve me akses broadband fiks





Tabela 7 Ecuria e numrit të pajtimtarëve me akses broadband nga rrjete fikse

	Albtelcom	Abcom	Abissnet	ASC	Other OA	Total Broadband Fix
2010	70,597	13,575	7,000	5,666	23,162	120,000
2011	60,055	29,321	15,321	10,129	24,871	139,697
2012	66,757	35,870	17,719	11,777	27,965	160,088
2013	73,242	43,430	20,562	15,432	29,890	182,556
2014	82,747	47,480	23,259	28,489	25,956	207,931
2015	97,597	51,093	24,497	31,357	38,326	242,870
Ndryshimi 2013/2014	18%	8%	5%	10%	48%	17%

Për sa i përket pjesëve të tregut gjatë vitit 2015 nuk pati ndryshime të ndjeshme dhe Albtelcom vazhdon të zotërojë vetëm 40% pjesë tregu të numrit të pajtimtarëve me akses broadband. Operatori i dytë më i madh, ABCOM zotëron 21% pjesë tregu që përbën një reduktim me 2 pikë përqindje në krahasim me 2014. Megjithëse numri i ofruesve të shërbimit të aksesit në Internet është i madh (rreth 80 operatorë aktivë), katër operatorët më të mëdhenj zotërojnë 84% të këtij tregu.

Figure 16 Ecuria e pjesëve të tregut të aksesit Broadband nga rrjete fikse (2010-2015)



Norma e penetrimit (numri i pajtimtarëve për 100 banorë) të aksesit Broadband nga rrjete fikse në fund të vitit 2015 ishte 8.58% krahasur me 7.31% në 2014. Figurat e mëposhtme paraqesin numrin e pajtimtarëve me akses broadband nga rrjete fikse dhe normën e penetrimit për 100 banorë sipas qarqeve në fund të vitit 2015. Tirana është qarku që ka numrin më të madh të pajtimtarëve me akses Broadband nga rrjete fikse (49% e totalit të pajtimtarëve në Shqipëri) dhe normën më të lartë e penetrimit me rreth 15%, ndërsa Dibra dhe Kukësi janë qarqet me normën më të ulët nën 3%.

Figure 17 Numri i pajtimtarëve me akses Broadband nga rrjete fikse sipas qarqeve (20





Figure 18 Penetrimi i aksesit Broadband nga rrjete fikse sipas qarqeve (2015)




Gjatë vitit 2015, numri i pajtimtarëve me shërbime të integruara në shporta triple play (Telefoni, Internet dhe TV), u rrit rreth 3 herë në krahasim me vitin 2014. Altelecom pati rritjen më të madhe të këtyre pajtimtarëve (me rreth 4 herë). Tabela e mëposhtme paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve të Altelecom me akses broadband dhe shërbime të integruara. 63% e pajtimtarëve me akses broadband të Altelecom në fund të vitit 2015 ishin pajtimtarë të shportave trefishe (Telefoni, Internet dhe IPTV).

Tabela 8 Numri i pajtimatrëve me shërbime të integruara të Albtelecom

	2013	2014	2015	Ndryshimi 2015/14
Numri total i pajtimtarëve me akses broadband	73,242	82,747	97,597	18%
Numri i pajtimtareve që kanë akses në shërbime të integruara (TV, Internet, telefoni)	70,961	76,230	93,873	23%
Telefoni fikse dhe Internet	70,961	60,939	32,293	-47%
Telefoni fikse, Internet dhe IPTV		15,291	61,580	303%

Të dhënat për përdoruesit e aksesit broadband sipas shpejtesisë tregojnë se shumica e përdoruesve (60%) kanë akses me shpejtësi 4-10Mbps. Teknologjia kryesore në ofrimin e aksesit broadband vazhdon të jetë DSL. Në 2014 62% e lidhjeve broadband ishin me DSL dhe 24% me rrjet kabllor (koaksial). Rrjetet NGA janë në nivel të kënaqshëm, pasi siç mund të vihet re shumica e lidhjeve DSL janë me FTTN/C. Lidhjet me fibër optike (deri në kabinet ose deri në shtëpi/ndërtesë) përbëjnë 63% të lidhjeve broadband.

Figure 19 Numri i pajtimatrëve broadband sipas teknologjisë



7.1.4.3 Përdorimi i përbashkët i infrastrukturës aktive dhe pasive në rrjetet fikse

Siç është theksuar në këtë dokument dhe më parë nga AKEP në Shqipëri janë rreth 80 operatorë që zotërojnë infrastrukturën e vet të rrjeteve fikse. Me qëllim promovimin e përdorimit të përbashkët të infrastrukturës aktive dhe pasive të rrjeteve fikse AKEP ka miratuar një sërë dokumentesh si analizat e tregut të LLU, aksesit broadband me shumicë (bitstream) dhe linjave me qira në vitin 2014 dhe rregulloren për përdorimin e përbashkët të faciliteteve në vitin 2015.

Disa prej këtyre masave rreguluese kanë filluar të japin efekt në vitin 2015, gjatë të cilit u vu re një rritje e përdorimit të përbashkët të infrastrukturës aktive dhe pasive të operatorit

Albtelecom. Gjatë vitit 2015 Albtelecom ka lidhur marrvëshje për aksesin bitstream me 4 operatorë dhe 2 marrvëshje për aksesin në tubacione, duke çuar në 5 numrin total të marrvëshjeve për këtë shërbim.¹⁵

7.2 Tregu i Shërbimeve Postare

Kuvendi i Shqipërisë më datë 7.05.2015 miratoi Ligjin Nr. 46/2015, “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj zëvendësoi Ligjin nr. 8530, datë 23.9.1999, “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ligji i ri paraqet një ndryshim të madh sa i përket liberalizimit të tregut të shërbimeve postare (Ligji 46/2015 është hartuar në përputhje të plotë me kuadrin ligjor të BE për sektorin postar), duke mundësuar në këtë mënyrë përshtatjen graduale të tregut me zhvillimet dhe dinamikën e ndryshimeve në fushën e teknologjisë së informacionit. Në bazë të përcaktimeve të ligjit 46/2015, AKEP paraqet në Kuvend raportin vjetor të veprimtarisë lidhur me shërbimin postar, i cili duhet të përmbajë:

- Informacion mbi ecurinë dhe tendencat e tregut të shërbimeve postare
- Veprimtarinë e AKEP-it për fushën e shërbimit postar
- Statusin e ofrimit të shërbimit postar.

7.2.1 Informacion mbi ecurinë dhe tendencat e tregut të shërbimeve postare

Subjektet e pajisur nga AKEP me “Licencë të Përgjithshme për ofrimin e shërbimeve postare” të regjistruar në rregjistrin e AKEP deri në datën 31.12.2015 janë:

- Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare sh.a.
- Ofruesit e shërbimeve postare (10 subjekte):
 1. Albanian Cargo Service sh.p.k (A.C.S)
 2. Albanian Courier sh.p.k (A.C)
 3. Albanian Delivery Express sh.p.k (ADEx)
 4. DHL International (Albania) sh.p.k
 5. RAD MAIL sh.p.k
 6. Sky Net Logistic sh.p.k
 7. TNT Express Albania sh.p.k
 8. Ulysses Enterprises sh.p.k (Fedex)
 9. United Transport sh.p.k (Uni Trans)
 10. Youth Albania Professional Services (YAPS)

¹⁵ Më shumë informacion për këtë pikë dhe të dhëna shtesë për tregun do të jepet pas marrjes së të dhënave vjetore nga operatorët me 10.04.2016.

7.2.1.1 Volumi i objekteve postare.

Numri total i objekteve postare të pranuar gjatë vitit 2015 nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare gjatë vitit 2015 ishte rreth 20 milion, që përbën një reduktim me rreth 6 % në krahasim me vitin 2014. Numri i objekteve të pranuar nga Posta Shqiptare gjatë vitit 2015 ka rënë me rreth 7 % ndërsa numri i objekteve të pranuar nga ofruesit e tjerë të shërbimeve postare është rritur me 4 % krahasuar me vitin 2014. Posta Shqiptare sh.a vazhdon të ruajë pozicionin e saj dominues në tregun e shërbimeve postare, duke zënë rreth 90% të tregut të shërbimit postar kundrejt 10% që zënë ofruesit e tjerë të shërbimeve postare.

Figure 20 Ecuria e objekteve postare 2012-2015




Tabela e mëposhtme paraqet numrin e objekteve postare, sipas kategorive kryesore, të pranuar nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare gjatë vitit 2015.

Tabela 9 Të dhëna mbi kategorite kryesore të objekteve postare (2015)


Nr	Shërbime postare të ofruara	Objekte postare
	Posta Shqiptare	
1	Shërbimi Universal Postar	
1.1	Postë Brenda vendit	16,822,701
1.2	Postë ndërkombëtare	491,016
1.3	Totali (1.1 + 1.2)	17,313,717
2	Objekte ekspres	
2.1	Postë brenda vendit	673,186
2.2	Postë ndërkombëtare	13,494
2.3	Totali (2.1 + 2.2)	686,680
2.4	Totali (1.3 + 2.3)	18,000,397
	Ofrues të shërbimeve postare	
3	Objekte ekspres/jo universale	
3.1	Postë brenda vendit	1,924,140
3.2	Postë ndërkombëtare	80,583
3.3	Totali (3.1 + 3.2)	2,004,723
4	Gjithsej (Totali 1.3 + 2.3 + 3.3)	20,005,120

Sipas të dhënave të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare për vitin 2015, disa nga treguesit kryesorë të shërbimeve postare, për ofrimin e shërbimeve postare në raport me popullsinë dhe sipërfaqen e Republikës së Shqipërisë rezultojnë të jenë:

- Objekte postare gjithsej **20,005,120** në raport me popullsinë (banorë rezident) 2.886.026 janë: **6.93 objekte / banorë**. (Tabela 1.1),
- Numri i zyrave postare të hapura për publikun 995 në raport me popullsinë 2.886.026 janë: 2,900 banorë / zyrë. (Tabela 5.1),
- Numri i zyrave postare të hapura për publikun 995 në raport me sipërfaqen 28,748 Km² janë: 28.89 Km² / zyrë. (Tabela 5.1)

Përdorimi mesatar për banor i shërbimeve postare në Shqipëri (7 objekte/banorë) është më i ulët në krahasim me vëndet e BE dhe të rajonit dhe pse shërbimet postare në këto vënde vazhdon të shënojë rënie të ndjeshme në sasi totale të objekteve postare (50-252 letra/banorë).

Figure 21 Objekte postare për banorë në vëndet e BE



Burimi: ËIK Consult, Studim për Komisionin Evropian (2013)

Në vijim jepen në formë tabelare dhe grafike të dhënat statistikore për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për shërbimet ekspres dhe të dhëna të tjera, me qëllim vlerësimin dhe krahasimin e tyre.

Tabela 10 Numri i objekteve postare të shërbimit ekspres/jo-universal brenda vëndit dhe ndërkombëtare

Emri i personit juridik/fizik	Objekte ekspres/ Jo universal Postë brenda vëndit	Objekte ekspres/ Postë ndërkombëtare
YAPS	1,248,986	-
Posta Shqiptare	673,186	13,494
Albanian Courier	452,563	7,708
RAD MAIL	110,800	-
Albanian Delivery Express	55,085	1,618

DHL International Albania	21,925	35,180
TNT Express Albania	17,870	2,308
Ulysses Enterprises-Fedex	8,500	6,000
Albanian Cargo Service	8,289	19
United Transport	122	25,833
Sky Net Logistic	-	1,917
Totali	2,597,326	94,077

Nga krahasimi i numrit të objekteve postare të realizuara në shërbimet ekspres/jo-universale brënda vëndit dhe atyre ndërkombëtare në total për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare, rezulton se numri i objekteve postare të pranuar brënda vëndit gjatë vitit 2015 është rritur me rreth 6.1 % krahasuar me vitin 2014, ndërsa numri i objekteve ekspres ndërkombëtare është rritur me rreth 24 % krahasuar me vitin 2014.

Referuar tabelës së mësipërme rezulton se për ofruesit e shërbimeve postare ekspres brënda vëndit, për objektet e pranuar, Yaps ka volumin më të madh për 2015 me 1.2 milion objekte postar apo 48% të tregut. Për objektet postare ekspres ndërkombëtare, DHL ka volumin më të madh me 35 mijë pao 37% të këtij segmenti tregu.

7.2.1.2 Tregues të rrjetit postar

Posta Shqiptare e cila ofron shërbim në të gjithë vendin në **552** zyra të hapura për publikun ka treguesit më të mirë të rrjetit, e ndjekur nga Albanian Courier, United Transport, Albanian Cargo Service, Albanian Delivery Express, DHL International Albania, etj. Në përgjithësi prezenca e zyrave postare të ofruesve të tjerë, përveç Postës Shqiptare, është në qytetet kryesore të vëndit.

Përsa i përket infrastrukturës së mjeteve postare, Posta Shqiptare ka në përdorim **472** mjete transporti, Albanian Courier **45**, Rad Mail **27**, TNT Express Albania **24**, Albanian Delivery Express **15**, DHL International Albania **11**, të pasuar nga Ofruesit e tjerë.

Tabela 11 Numri i Zyrave postare sipas ofruesve (2015)

Emri i personit (juridik/fizik)	Zyra postare të hapura për publikun	Zyra postare jo të hapura për publikun
Posta Shqiptare	552	20
Albanian Courier	103	1
United Transport	102	1
Albanian Cargo Service	99	1
Albanian Delivery Express	69	1
TNT Express Albania	32	0
DHL International Albania	22	1

Ulysses Enterprises-Fedex	12	1
Sky Net Logistic	2	0
RAD MAIL	1	1
YAPS	1	1
Totali	995	28

7.2.1.3 Të punësuarit

Sektori postar karakterizohet nga përdorimi intensiv i forcës së punës dhe në shumë vende të BE, operatori postar publik është një ndër punëdhënësit më të mëdhenj të ekonomisë. Nga të dhënat statistikore të mbledhura nga Posta Shqiptare sh.a dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare, për vitin 2015 në sektorin postar ishin të punësuar rreth 2593 punonjës, që përbën një rritje të vogël me 3% në krahasim me vitin 2014. Gjithsesi numri i të punësuarve në vitin 2015 ishte më i ulët se në vitet 2012-2013, sic mund të vihet re nga figura e mëposhtme.

Figure 22 Ecuria e numrit të të punësuarve 2012-2015



Posta Shqiptare ka 2,278 të punësuar, apo 88% të punësuarve në sektorin postar. Operatorët e tjerë postarë kanë një numër shumë më të vogël të punësuarish dhe operatori me numrin më të madh të të punësuarve është Rad Mail me 58 punonjës në 2015.

7.2.1.4 Ankesat e përdoruesve (Reklamacionet)

Gjatë vitit 2015 pranë Posta Shqiptare janë depozituar 1062 reklamacione nga të cilat janë zgjidhur 808, pranë DHL janë depozituar 53 reklamacione nga të cilat janë zgjidhur 53, TNT Express Albania ka regjistruar 15 reklamacione, nga të cilat ka zgjidhur 15, Ulysess Enterprises dhe United Transport kanë regjistruar 6 nga të cilat kanë zgjidhur 6 reklamacione, ndërsa Albanian Delivery Express dhe Sky Net Logistics kanë pranuar 2 reklamacione nga të cilat janë zgjidhur 2.

Nga krahasimi i ankesave (reklamacioneve) të pranuar, gjatë vitit 2015 vërehet një rritje me rreth 6.5% të ankesave për ofruesin e shërbimit universal dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare në krahasim me vitin 2014, ndërsa nga krahasimi i ankesave (reklamacioneve) të zgjidhura gjatë vitit 2015 vërehet një rritje me rreth 11.3 % të ankesave nga ofruesi i shërbimit universal dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare në krahasim me vitin 2014.

II Puna gjatë vitit paraprak (2015)

8. Mbikqyrja e tregut të komunikimeve elektronike

Puna e AKEP gjatë vitit paraprak është udhëhequr nga angazhimi maksimal për zbatimin dhe përmbushjen e:

- Detyrimeve dhe objektivave rregullatore të përcaktuar në legjislacionin material,
- Politikat e zhvillimit sektorial të Këshillit të Ministrave,
- Rekomandimeve të Kuvendit,
- Direktivave të fushës të Komisionit dhe Parlamentit Europian,
- Akteve të BEREC, ERGP dhe ITU,
- Rekomandimeve sektoriale të Progres Raportit të KE për Shqipërinë,
- Programit vjetor të punës për vitin në vazhdim të paraqitur në Raportin vjetor të veprimtarisë së AKEP për vitin 2014.

8.1 Mbikqyrja dhe rregullimi ekonomik i tregut

Ligji nr. 9918 parashikon që tregjet përkatëse kombëtare të komunikimeve elektronike dhe produktet përkatëse, të cilat justifikojnë rregullimin dhe janë subjekte të rregullimit të veçantë, përcaktohen në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, me parimet e ligjit për konkurrencën dhe kushtet aktuale të tregut shqiptar, duke patur parasysh kërkesat e rregullimit të veçantë në sector dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian për tregjet përkatëse të produkteve dhe shërbimeve.

Përcaktimet e tregjeve, analizat e tyre dhe përcaktimi i sipërmarrësve, që kanë FNT, në tregjet përkatëse, bëhet nga AKEP në mënyrë periodike, por jo më pak se një here në dy vjet, në bazë të një rregulloreje, të hartuar në zbatim të këtij ligji dhe në përputhje me rekomandimet e BE-së.

8.1.1 Rregullimi ekonomik i tregut të komunikimeve elektronike

AKEP, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9918, dhe Rregullores “Për Analizën e Tregut”, gjatë vitit 2015 për analizat e tregut u fokusua në:

- Trajtimin e ankimeve të operatorëve celularë për Vendimet nr.2522-2526, datë 6.11.2014 të analizës së tregut celular dhe monitorimin e zbatimit të detyrimeve për mos-diskriminimin në tarifatat brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve të tjera celulare

- Kryerjen e procesit të analizës së tregut të telefonisë fikse (Këshillim Publik dhe vendimet përkatëse);

8.1.2 Masat rregulluese specifike për problematiken on-net/off-net:

Vendimet e datës 6.11.2014 të AKEP parashikonin që përcaktimet e mësipërme të jenë detyruese për operatorët celularë duke filluar aplikimin e tyre nga data 1.01.2015. Pas publikimit të vendimeve për FNT të operatorëve celularë për terminimin e thirrjeve dhe masat rregulluese përkatëse, katër operatorët celularë depozituan ankime administrative ndaj vendimeve të AKEP. AKEP me Vendimet nr.2542-2546, datë 13.03.2014 miratoi disa shtesa dhe ndryshime në Vendimet 2523-2526, datë 6.11.2014:

- Përcaktimin e një glide-path (reduktim të përshkallëzuar) në kohë të tarifës së terminimit të Plus sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 12 Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare

	1.04.2014	1.12.2014	1.04.2015	1.07.2015	1.01.2016
Vodafone/AMC	2.66	1.48	1.48	1.48	1.48
Albtelecom (EM)	4.00	1.48	1.48	1.48	1.48
Plus	6.52	6.52	4.00	2.66	1.48

Shënim: vlerat në Lekë/minutë pa TVSH

- Përcaktimin si afat të fillimit të zbatimit të detyrimeve për mos-diskriminimin në tarifatat on-net/off-net, në afatet e mëposhtme:

data 1.07.2015: për programet tarifore, ofertat, opsionet etj., për përdoruesit me parapagim dhe përdoruesit e rinj me kontratë, përfshirë rinovimet e kontratave ekzistuese që kryhen pas kësaj date,

data 1.01.2016: për të gjitha programet e tjera tarifore të aplikuara për përdoruesit aktualë me kontratë (kontrata me programe tarifore standarde dhe të personalizuar/specifike).

Detyrimet dhe afatet e mësipërme nënkuptojnë që:

- duke filluar nga data 1.07.2015 nuk lejohet aplikimi i tarifave të ndryshme on-net/off-net për përdoruesit me parapagim, përdoruesit e rinj me kontratë dhe përdoruesit aktualë me kontratë që kryejnë rinovim të kontratës pas datës 1.07.2015,
- duke filluar nga data 1.01.2016 nuk lejohet aplikimi i tarifave të ndryshme on-net/off-net edhe për përdoruesit me kontrata specifike si dhe përdoruesit aktualë me kontratë,
- detyrimet aplikohen për të gjitha llojet e programeve tarifore: standard, oferta, opsione, promocione etj.

Në vijim të vendimeve të mësipërme, AKEP u dërgoi operatorëve celularë sqarime të detajuara për mënyrën e zbatimit të detyrimit të mos-diskriminimit në tarifatat brenda dhe jashtë

rrjetit. AKEP gjatë vitit 2015 e në vijim, ka monitoruar nga afër zbatimin nga operatorët celularë të detyrimeve të mësipërme dhe efektin në trafikun e thirrjeve telefonike të përdoruesve celularë në baza mujore.

8.1.2.1 Efektet në planet tarifore

Detyrimet e mësipërme sollën ndryshime të rëndësishme në planet tarifore të operatorëve celularë:

- përfshirjen e sasive të barabarta të minutave brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve celulare apo të thirrjeve brenda dhe jashtë rrjetit (pa dallim destinacioni) në pagesat fikse të planeve tarifore me kontratë dhe me parapagim,
- reduktim të ndjeshëm të numrit të ofertave të përkohshme promovionale dhe rritje të numrit të paketave standarde me përfitime më të mëdha për përdoruesit celularë.

Më poshtë janë dhënë disa shembuj të ndryshimeve të kryera për zbatimin e detyrimeve të mos-diskriminimit në tarifat on-net/off-net në planet tarifore të operatorit më të madh celular Vodafone Albania, që ishte dhe objekt i hetimit të thelluar nga Autoriteti i Konkurrencës në periudhën 2012-2014.

Tabela 13 Ndryshimet në tarifat standarde të thirrjeve me parapagim (Vodafone Club)

	2014	2015	Ndryshimi 2015/2014
Thirrje brenda grupit (Vodafone Club)	39	N/A	
Drejt Vodafone	54	39	-28%
Drejt rrjeteve të tjera celulare	39	29	-26%
Drejt rrjeteve Fiks	39	29	-26%

Tarifat në Lekë/minutë me TVSH

Siç mund të vihet re tarifat e thirrjeve off-net janë reduktuar me 26% në vitin 2015. Vodafone tashmë aplikon vetëm një plan tarifor standard me parapagesë, Vodafone Club, dhe ka hequr planet e tjera tarifore standarde me parapagesë. Gjithashtu ofertat e përkohshme (ose me afat të pacaktuar) për përdoruesit me parapagim janë ndryshuar në paketa opsionale për këtë kategori përdoruesish, si në tabelën në vijim.

Tabela 14 Ndryshime në ofertat e përdoruesve me parapagim Vodafone Albania

	2014	2015	2014	2015	2014	2015
Emërtimi	Ofertë Ditore	Paketë Ditore Standarde	Ofertë Javore	Paketë Javore Standarde	Ofertë Mujore Club Mix	Paketë Mujore Standarde Club Mix
Çmimi (lekë)	70	70	300	300	1000	1000

Minuta brenda rrjetit/grupit	600	100	1200	300	3000 (MB/SMS/minuta Brenda Vodafone Club)	3000 MB/SMS/Minuta Kombëtare
Minuta Kombëtare	15		n/a		40	

Tabela paraqet ndryshimet e kryera në dy programe tarifore me kontratë, ku vihet re se janë hequr minutat pa limit brenda rrjetit dhe janë zëvendësuar me mijëra minuta kombëtare (on-net, off-net dhe drejt fikse).

Tabela 15 Ndryshime në plane tarifore të përdoruesve me kontratë Vodafone Albania

	Vodafone RED 1		Vodafone RED 2	
	2014	2015	2014	2015
Pajtimi Mujor	4,800	4800	7,800	7800
Minuta brenda rrjetit	pa limit	4000	pa limit	6000
Minuta Kombëtare	250		500	
Internet	1 GB	3 GB	1.5 GB	7GB
Minuta Ndërkombëtare*	Opsionale	200	Opsionale	300
Thirrje drejt rrjetit celular pas konsumit të paketës (lekë/min)	33.62	18.00	33.62	18.00


Tabelat e mësipërme paraqesin një pjesë të ndryshimeve të kryera nga Vodafone Albania, ndërkohë që ndryshime të tilla janë kryer për të gjitha planet tarifore të tjera si dhe të tre operatorët e tjerë celularë.

Këto ndryshime nga të katër operatorët celularë kanë çuar në rritje të përfitimeve të përdoruesve fundorë, pasi sasia e minutave të përfshira në pagesat fikse është e mjaftueshme dhe duke filluar nga pagesa shumë të ulëta fikse. Ofertat/paketat tarifore mund të mos kenë më thirrje 'pa limit' brenda rrjetit/grupit, por ato kanë sasi të konsiderueshme thirrjesh (qindra deri në mijëra minuta brenda dhe jashtë rrjetit) sa që praktikisht në shumë raste mund të konsiderohen pa limit. Pra përdoruesit celularë me të njëjtën kosto (pagesë) kanë përfituar sasi të konsiderueshme thirrjesh jashtë rrjetit celular (drejt rrjeteve të tjera celulare). Efektet e këtyre ndryshimeve janë vënë re në sasinë e thirrjeve dhe strukturën e thirrjeve të përdoruesve të katër operatorëve celularë.

8.1.2.2 Efektet në thirrjet celulare

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e strukturës së thirrjeve të përdoruesve celularë sipas destinacionit të thirrjeve në periudhën janar 2014 - dhjetor 2015. Nga të dhënat vihet re ndryshime të mëdha në strukturën e thirrjeve dhe tendencat e rritjes së peshës së thirrjeve off-net (drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare) dhe reduktimin e peshës së thirrjeve brenda rrjetit (on-net). Pesha e thirrjeve off-net është rritur nga 5% në Janar 2014 në 30% në dhjetor 2015. Në të njëjtën periudhë pesha e thirrjeve on-net është reduktuar nga 90% në janar 2014 në 66% në dhjetor 2015.

Figure 23 Ecuria e strukturës së thirrjeve nga rrjetet celulare (janar 2014 - dhjetor 2015)




Ndryshimet më të ndjeshme të strukturës së thirrjeve janë vënë re në korrik 2015 e në vijim, që përkon me afatin e fillimit të aplikimit të detyrimit të mos-diskriminimit në rrjetet e katër operatorëve celularë. Gjatë vitit 2015 është vënë re gjithashtu luajtje të mëdha të sasisë dhe proporcionit të thirrjeve dalëse ndërkombëtare nga rrjetete celulare. Sasia dhe proporcioni i thirrjeve ndërkombëtare është rritur ndjeshëm në gjashtëmujorin e parë 2015 për shkak të ofertave të operatorëve për këta lloj thirrjesh. Megjithatë në muajt gusht e në vijim operatorët celularë kanë reduktuar ndjeshëm ofertat për thirrjet ndërkombëtare për shkak të rritjes së kostove të terminimit të këtyre thirrjeve në vendet e tjera (ritje e tarifave të terminimit nga operatorët e vendeve të huaja për thirrjet hyrëse ndërkombëtare që vijnë nga vendet jashtë BE).

Të katër operatorët celularë kanë pasur ndryshime të ndjeshme në strukturën e thirrjeve dalëse të përdoruesve të tyre. Raporti i thirrjeve on-net/off-net të operatorit më të madh celular, Vodafone Albania, ka ndryshuar nga 97% v 3% në janar 2014 në 78% v 22% në dhjetor 2015. Për Telekom Albania ky raport ka pësuar ndryshime edhe më të mëdha, nga 96% v 4% në janar 2014 në 68% v 32% në dhjetor 2015.

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e trafikut të thirrjeve brenda rrjetit (on-net) dhe drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare (off-net) në periudhën janar 2014 - dhjetor 2015. Nga të dhënat mund të vihet re sa sasia e thirrjeve off-net e operatorëve celularë është rritur 5.5 herë gjatë kësaj periudhe: nga rreth 30 milion minuta në muaj në rreth 167 milion minuta në muaj. Në të njëjtën periudhë sasia e thirrjeve on-net është reduktuar ndjeshëm me 29%, nga 520 milion minuta në muaj 368 milion minuta në muaj. Nga figura mund të vihet re se ndryshimet më të mëdha të

sasive të trafikut on-net dhe off-net janë në periudhën korrik - dhjetor 2015, trafiku off-net është rritur me 65%, ndërsa trafiku on-net është reduktuar me 21%.

Figure 24 Ecuria e sasisë së trafikut on-net dhe off-net janar 2014 - dhjetor 2015



Rritja e ndjeshme e sasisë së trafikut off-net dhe reduktimet e tarifave të terminimit kanë çuar dhe në ndryshime të ndjeshme të të ardhurave/pagesave neto midis operatorëve celularë për trafikun e terminuar në rrjetet e tyre, të cilat kanë rritur aftësitë konkurruese të dy operatorëve më të vegjël dhe të rinj në treg, Plus dhe Albtelecom (EM).

8.1.3 Analiza e tregut të telefonisë fikse

AKEP në vitin 2015 kreu procedurat e analizës së tregut të telefonisë fikse që përmbante analizën e tregjeve përkatës të mëposhtëm:

- Tregu me pakicë i aksesit në rrjet publik telefonik nga vendndodhje fikse.
- Tregu me pakicë i thirrjeve telefonike të disponueshme për publikun nga vendndodhje fikse.
- Tregu me shumicë i origjinimit të thirrjeve në rrjetin telefonik publik të ofruara nga vendndodhje fikse .
- Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve për rrjete publike telefonike individuale të ofruara nga vendndodhje fikse.
- Tregu me shumicë i shërbimeve tranzite në rrjetet telefonike publike fikse.

AKEP publikoi dokumentin e analizës për Këshillim Publik më 25.06.2015 deri më 15.09.2015, dhë në përfundim të periudhës së Këshillimit në AKEP u depozituan komente

nga katër operatorë si dhe nga Autoriteti i Konkurrencës. AKEP më 8.10.2015 publikoi versionin final të dokumentit të analizës së tregut të telefonisë fikse dhe vendimet përkatëse për FNT dhe masat rregulluese në treg. AKEP me Vendimet nr.2617-2620, datë 8.10.2015 miratoi dokumentin përfundimtar të analizës së tregut të telefonisë fikse dhe:

- Përcaktimin e Albtelecom sh.a. sipërmarrës me FNT në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetin e vet fikse dhe tregun e tranzitimit të thirrjeve kombëtare në rrjete fikse dhe vendosjen e masave rregulluese,
- Përcaktimin e 80 sipërmarrësve (operatorë alternativë) me FNT në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetet e tyre individuale të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese,
- Përcaktimin e Telekom Albania sh.a sipërmarrës me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik Telekom Albania drejt numrave gjeografikë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese.

Ndër konkluzionet kryesore të analizës së tregut me pakicë të telefonisë fikse ishin:

- Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse ka pasur tendencë reduktimi duke filluar nga viti 2012 dhe në vitin 2014 rënia vjetore ishte 16%. Kjo tendencë rënie ka vazhduar edhe në vitin 2015, megjithëse me normë më të ulët rënie.
Në Shqipëri janë rreth 80 operatorë alternativë që zotërojnë rrjetin e vet të aksesit (kryesisht me linja bakri në rrjetin e aksesit por edhe me kabllor koaksial dhe pa tela duke ofruar dhe thirrje telefonike për pajtimtarët e vet. Rrjetet kabllore kanë zgjeruar ndjeshëm zonat e ofrimit të shërbimit dhe operatori më i madh alternativ (Abcom) është operator kabllor me presencë rrjeti në disa zona gjeografike (7 nga 12 qarqe).
- Shumica e operatorëve kryesorë alternativë dhe Albtelecom ofrojnë paketa tarifore me pagesë fikse mujore që përfshin dhe thirrje telefonike në pagesën fikse. Përdorimi i paketave bundle (shporta shërbimesh) është rritur ndjeshëm. Në fundvitin 2014, 41% e përdoruesve të shërbimeve telefonike të Albtelecom përdornin paketa të integruara dyfishe dhe trefishe, Telefoni, Internet dhe TV,
- Trafiku nga rrjetet celulare ka vazhduar të rritet ndjeshëm ndërsa trafiku nga rrjetet fikse ka vazhduar të reduktohet ndjeshëm. Në vitin 2014 thirrjet nga rrjetet fikse përbënin vetëm 3% të totalit të thirrjeve telefonike të origjinuara nga rrjetet celulare dhe fikse së bashku,
- Në 2010-2014 përdorimi mesatar për përdorues i thirrjeve nga rrjete fikse është reduktuar me 46% (nga 151 minuta në muaj në 81 minuta), ndërsa thirrjet nga rrjete celulare janë rritur me 56% (nga 110 minuta në muaj në 172 minuta),
- Reduktimi i ndjeshëm i tarifave celulare në vitet e fundit ka rritur në masë të madhe efektin zëvendësues të thirrjeve nga rrjete fikse me thirrje nga rrjete celulare. Kjo vihet re në konvergencën e nivelit të tarifave nga rrjetet celulare dhe nga rrjetet fikse (në 2014 shpenzimi mesatar për një minutë thirrje nga rrjet celular ishte 3.12 lekë/minutë me TVSH). Ky efekt konvergjuës vihet re edhe në tarifatat e thirrjeve

dalëse ndërkombëtare të cilat tradicionalisht kanë qenë shumë më të lira në rrjetet fikse,

- Norma e penetrimit të shërbimeve të telefonisë fikse në 2014 arriti në 9%, ndërsa për telefoninë celulare ishte 119% për përdorues aktivë dhe 172% sipas kartave SIM. Mbulimi me sinjal GSM për popullsi është mbi 99%,
- Kohëzgjatja mesatare e thirrjeve nga rrjete celulare për vitin 2014 ishte rreth 2 minuta ndërsa rrjete fikse (Albtelecom) 2.5 minuta. Kjo tregon se kohëzgjatja e thirrjeve nga rrjete celulare është në rritje dhe duke konvergjuar me kohëzgjatjen e thirrjeve nga rrjete fikse.

Bazuar në përfundimin e përkufizimit të tregut përkatës në nivel me pakicë dhe faktin që ky treg nuk është as pjesë e listës së tregjeve përkatëse të Rregullores së Analizës së tregut dhe as pjesë e rekomandimit të vitit 2014 të KE për tregjet përkatës, AKEP ka kryer testin e 3 kritereve nëse ky treg është i justifikuar për ndërhyrje ex-ante apo jo.

Nga analiza e tre kritereve rezulton se asnjë prej tyre nuk plotësohet dhe në përputhje me rregulloren e analizës së tregut dhe rekomandimet e KE, tregu me pakicë i aksesit/thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse nuk plotëson testin e tre kritereve dhe nuk konsiderohet si treg i justifikueshëm për ndërhyrje ex-ante. Ndër faktorët kryesorë që çojnë në mosplotësimin e këtij testi janë:

- LLU dhe akses bits-stream janë dy masa rregullatore për Albtelecom që janë të disponueshme. Gjithashtu AKEP ka propozuar dhe procedura për thjeshtëzimin e aksesit në tubacione (Rregullore për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës pasive) për të reduktuar barrierat në ndërtimin e rrjeteve, Nje operator alternativ duke kërkuar akses bits-stream ose LLU me qëllim ofrimin e aksesit broadband për përdorues fundorë, ka mundësi të zgjerojë bazën e klientëve edhe në ofrimin e shërbimit të telefonisë si atë të aksesit edhe atë të thirrjeve duke përdorur teknologji IP,
- Të dhënat tregojnë për një konvergjencë të thirrjeve nga rrjete fikse dhe celulare, si dhe fakti që Telekom Albania ofron shërbim GSM Fiks nëpërmjet rrjetit celular prej disa vitesh tashmë, tregon se operatorët celularë nuk kanë pengesa për t'u futur në tregun e ofrimit të shërbimeve nga vendndodhje fikse duke përdorur rrjetet e tyre celulare.

AKEP në vijim të heqjes së masës së rregullimit të tarifave me pakicë të Albtelecom për telefoninë fikse (vendimi i Analizës së tregut në vitin 2013), me Vendimin Nr. 2619, datë 8.10.2015 hoqi statusin me FNT të Albtelecom në tregjet me pakicë të telefonisë fikse.

Bazuar në përfundimin e përkufizimit të tregjeve përkatës me shumicë të origjinimit dhe tranzitimit të thirrjeve dhe faktin që këto dy tregje nuk janë as pjesë e listës së tregjeve përkatës të Rregullores së Analizës së tregut dhe as pjesë e rekomandimit të vitit 2014 të KE për tregjet përkatës, AKEP kreu testin e 3 kritereve nëse këto dy tregje janë të justifikuar për ndërhyrje ex-ante apo jo.

Nga analiza e tre kriterëve rezulton se tregu i tranzitimit plotëson testin e tre kriterëve ndërsa tregu i origjinimit nuk plotëson testin e tre kriterëve. Ndër faktorët kryesorë që çojnë në këto konkluzione janë:

- Bazuar në përkufizimin e tregut me pakicë dhe testin e 3 kriterëve për tregun me pakicë, origjinimi i thirrjeve nga vendndodhje fikse duhet të përfshijë edhe origjinimin e thirrjeve nga rrjete celulare dhe vetofrimin e tyre. Gjithashtu në kushtet specifike të Shqipërisë ku rreth 80 operatorë alternativë kanë investuar në rrjetet e tyre fikse, përfshirë rrjetet e aksesit, mund të themi që origjinimi i thirrjeve në nivel me shumicë nuk ndeshet me pengesa të larta jo-kalimtare.
- Në kushtet e zhvillimit të rrjeteve të telefonisë fikse në Shqipëri ku janë rreth 80 operatorë me rrjetet e tyre, Altelecom është i vetmi operator që ka shtrirje kombëtare dhe për shumë operatorë është mundësia e vetme për të ofruar shërbime tranzitimi drejt rrjeteve të tjera kombëtare, fikse dhe celulare. Ofrimi i shërbimit tranzit kombëtar të plotë (pa nevojë për tranzitim edhe me një operator tjetër) kërkon lidhjen/interkonektimin me 80 operatorë fikse të shpërndarë në shumë zona gjeografike në Shqipëri dhe me secilin nga katër operatorët celularë.

Në vijim të përfundimeve të analizës së tregut në 2013, AKEP rishikoi faktorët për statusin me FNT në tregjet e sipërcituar, duke marrë në considerate pjesën e tregut në tregjet përkatës të analizuar:

- Për terminimin e thirrjeve nuk priten ndryshime pasi edhe modeli CPP (Pala Thirrëse Pagan) do të vazhdojë të ekzistojë të paktën në periudhë afatmesme,
- Për tranzitimin e thirrjeve kombëtare Altelecom vazhdon të ketë pjesë tregu të lartë (mbi 60%),
- Efektet e rregullimit të tarifave të terminimit të OA. Rregullimi i tarifave të terminimit të operatorëve alternativë ka shmagur problemet e aplikimit të tarifave të ndryshme për operatorë të ndryshëm dhe mos-marrveshjet e mundshme për këto tarifa terminimi,
- Nivelin e tarifave të terminimit në Shqipëri krahasuar me vendet e BE dhe rajonit,
- Shpërndarjen gjeografike të rrjeteve të OA dhe nevojën për shërbimet e tranzitimit të thirrjeve kombëtare të Altelecom, si pika e vetme e lidhjes së shumë OA me operatorët e tjerë telefonikë.

Bazuar në vlerësimin e faktorëve për FNT në tregjet përkatëse të terminimit dhe tranzitimit në rrjete fikse, AKEP vlerësoi se:

Altelecom sh.a. përmbush kushtet për t'u shpallur sipërmarrës me FNT në:

- tregun e terminimit të thirrjeve drejt pajtimtarëve të rrjetit fikse Altelecom,
- tregun e tranzitimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet fikse; 80 sipërmarrës të rrjeteve alternative fikse dhe Telekom Albania përmbushin kushtet për t'u shpallur sipërmarrës me FNT në,

- tregun e terminimit të thirrjeve drejt pajtimtarëve të rrjetit të tyre fiks (për pajtimtarët e GSM Fiks për Telekom Albania).

Në lidhje me statusin e FNT të Altelecom për terminim dhe tranzitim të thirrjeve, AKEP vendosi detyrimet e mëposhtme:

- Detyrimi i Mosdiskriminimit (Neni 39),
- Detyrimi i transparencës, përfshirë publikim të RIO (Neni 40),
- Detyrimi për ndarjen e llogarive (Neni 41),
- Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42),
- Detyrimi për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (Neni 45).

Masat rregulluese ndaj operatorëve Alternativë dhe të Telekom Albania (Telekom Albania fiks) për FNT në terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre janë:

- Detyrimi i Mosdiskriminimit (Neni 39),
- Detyrimi i transparencës (Neni 40),
- Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42),
- Detyrimi për kontroll tarife (neni 45),

Detyrimet për këta operatorë nuk përfshijnë publikim të RIO-s, si dhe një sërë detyrimesh të tjera të vendosura ndaj Altelecom. Detyrimi i kontrollit të tarifës përfshin rregullimin nga AKEP të tarifave të terminimit të operatorëve alternativë.

Në lidhje me tarifat e terminimit në rrjetin Altelecom, 80 OA dhe telekom Albania, AKEP vendosi reduktimin e tyre sipas vlerave dhe afateve të dhëna në tabelën e mëposhtme.

Tabela 16 Ndryshimet në përqindje të tarifave të terminimit në rrjetet fikse (1.09.2014-2018)

	1.09.2014	1.01.2016	1.01.2017	1.01.2018	Ndryshimi 2016/2014	Ndryshimi 1.01.2018/2014
Altelecom						
Lokal/Njëfish	1.19	1.48	1.29	0.70	24%	-41%
Dyfish	1.85				-20%	-62%
POI	12	12	12	2		
OA						
Lokal	1.34	1.48	1.29	0.70	10%	-48%
Mesatare- Njëfish/dyfish	1.77				-16%	-60%
Telekom Albania						
Terminimi lekë/minutë	1.19	1.48	1.29	0.70	24%	-41%
Tarifë fikse për thirrje	0.38	0.0	0.0	0.0	-100%	-100%

Tarifat pa TVSH

Nga tabela vihet re se reduktimet variojnë nga 41-62% për tarifat e terminimit të thirrjeve në lek/minutë dhe 100% për tarifën për thirrje, e cila u vendos të hiqet më 1.01.2016. Gjithashtu duke filluar nga data 1.01.2016:

- Reduktohet numri i segmenteve të tarifimit të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse nga 2 në 1,
- Hiqet asimetria e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse të operatorëve alternativë me tarifat e terminimit në rrjetin Altelecom,
- Niveli i tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse është i njëjtë me nivelin e tarifës së terminimit në rrjetet celulare (deri më 31.12.2016).

Ndryshimet e tarifave të terminimit në rrjetet fikse pritet të japin një shtysë të re në konkurrencën në treg për thirrjet telefonike fikse paralelisht me thjeshtëzimin e tarifimit të operatorëve me njëri-tjetrin dhe për pajtimtarët. Këto reduktime synojnë dhe reduktimin e stimujve për problematikën e tarifave të ndryshme on-net-off-net të ngjashme me tregun celular dhe rrisin stimujt për tarifim unifik në rrjetet fikse dhe celulare pavarësisht destinacionit fiks/celular. Reduktimet e tarifave të terminimit në rrjetet fikse janë në linjë edhe me reduktimet e kryera tashmë për tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare. Niveli i tarifave të terminimit në rrjetet fikse në Shqipëri në Janar 2018 pritet të arrijë nivelin mesatar të vendeve të BE/BEREC në 2014, pra me një sfazim 4 vjet. Ky sfazim gjykohet i justifikuar për shkak të ndryshimeve të mëdha të zhvillimit të rrjeteve fikse në Shqipëri dhe vendet e BE apo dhe rajonit, penetrimi shumë i ulët dhe sasia e thirrjeve shumë e ulët.

Duke marrë në konsideratë vlerat e tarifave të terminimit deri në 1.01.2014, në periudhën kohore prej 4 vitesh (1.01.2014 - 1.01.2018) ndryshimet në tarifat dhe segmentet e terminimit në rrjetet fikse janë të mëdha:

- Reduktim të niveleve të terminimit në rrjetin Altelecom nga 3 në 2 dhe më pas në 1,
- Reduktimi i tarifave të terminimit nga 1.5-3.5 lekë/minutë në 0.7 lekë/minutë, që përbën reduktim me 50-80%,
- Reduktim të numrit minimal të pikave të interkoneksionit (POI) të Altelecom nga 84 në 12 dhe më pas në vetëm 2.

Reduktimi i pikave të interkoneksionit të Altelecom në 1.01.2018, nga 12 në 2, krijon kohë të mjaftueshme për OA për përshtatje me zhvillimet e fundit dhe investimet e Altelecom (rrjeti NGN/NGA), duke krijuar njëkohësisht stimuj për Altelecom për vazhdimin e investimeve në modernizim të rrjetit fiks që duhet të sjellë përfitime për gjithë tregun në tërësi, sidomos për përdoruesit fundorë.

8.2 Administrimi i burimeve të fundme, autorizimet dhe facilitetet

Një aspekt shumë i rëndësishëm i veprimtarisë së AKEP-it është administrimi i regjistrimit të sipërmarrësve, burimeve natyrore të fundme (spektri i radiofrekuencave dhe numeracioni) si dhe çertifikatave e licencave. Kjo veprimtari bazohet në kompetencat ligjore të përcaktuara

në ligjin nr. 9918/2008, i ndryshuar, sipas të cilave për të përmbushur qëllimin dhe objektivat rregullatorë të përcaktuara nga ky ligj AKEP-i ka kompetencë:

- Regjistrimin e sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike në përfundim të procesit të njoftimit,
- Bashkëpunimin me Ministrin për hartimin e Planit Kombëtar të Frekuencave,
- Përgatit Planin e Përdorimit të Frekuencave dhe administron brezat e frekuencave të caktuara për qëllime civile, për përdorim publik ose privat, me përjashtim të brezit të frekuencave të caktuara për transmetime radio e televizive, të cilat administrohen nga AMA,
- Lëshon autorizimet individuale për përdorimin e frekuencave,
- Kryen procedurat e përcaktuara, sipas këtij ligji, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, pas miratimit përkatës,
- Bashkërendon punën me administratat e vendeve fqinje dhe të vendeve të tjera për caktimin dhe përdorimin e radio-frekuencave, për pjesën e spektrit që administron,
- Harton, miraton dhe administron Planin Kombëtar të Numeracionit për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë,
- Cakton numrat dhe seritë numerike të sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike,
- Siguron disponueshmërinë e një baze qëndrore të dhënash për portabilitetin e numrit;
- Merr masat që sipërmarrësit të zbatojnë detyrimet, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesave të vendit, të sigurisë publike edhe në rast lufte apo gjendje të jashtëzakonshme,
- Krijon, mirëmban dhe përditëson bazën e të dhënave elektronike për sektorin e komunikimeve elektronike dhe siguron që këto të dhëna, në formë informacioni, t'i bëhen të vlefshme publikut, në përputhje me rregullat për informimin publik dhe të ruajtjes së konfidencialitetit.

Në zbatim të këtyre kompetencave dhe detyrave ligjore, AKEP, gjatë vitit 2015 ka kryer këtë veprimtari:

8.2.1 Autorizimi për të ofruar rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike sipas regjimit të autorizimit të përgjithshëm

8.2.1.1 Regjistrimi i Njoftimit:

Sipas ligjit 9918/2008, i ndryshuar autorizimi për të ofruar rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë bëhet:

- a) Përmes njoftimit, kur ofrimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike nuk kërkon përdorimin e burimeve natyrore të kufizuar,

- b) Pas njoftimit dhe dhënies së të drejtës së përdorimit, në rastin kur ofrimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike kërkon përdorimin e burimeve natyrore të fundme.

Autorizimi i hyrjes në treg të subjekteve për ofrim rrjetesh dhe shërbimesh publike të komunikimeve elektronike gjatë vitit 2015, është bazuar në dispozitat e rregullores “Për Autorizimin e Përgjithshëm” miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 1774 datë 02.02.2012, e ndryshuar gjatë vitit 2014 me qëllim përshtatjen e ndryshimeve ligjore të ligjit 9918 dhe për të përmirësuar aplikimin përkatës *on-line*.

Aplikimi on-line bazuar në kushtet e anekseve të rregullores, ka bërë të mundur marrjen e një informacioni të detajuar dhe të nevojshëm mbi:

- rrjetet/shërbimet që ofron sipërmarrësi,
- statusin ligjor, shoqëruar me ekstraktin e QKR-së,
- teknologjinë e përdorur dhe mediumet e komunikimit,
- kushtet e ofrimit të aksesit dhe shërbimit pajtimtarit-kontrata tip,
- të dhënat mbi masat e marra nga sipërmarrësit për garantimin e sigurisë së rrjetit.

AKEP, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9918/2008, dhe Rregullores “Për Autorizimin e Përgjithshëm”, mbi administrimin e Regjistrit të Sipërmarrësve për Ofrimin e Rrjeteve dhe Shërbimeve Publike të Komunikimeve Elektronike, përfshirë këtu edhe regjistrimin e operatorëve audiovizivë, Regjistrin të Licencave të Përgjithshme të Operatorëve Publikë dhe Ofruesve të Shërbimeve Postare, si dhe Regjistrin të Informacionit Periodik të Raportuar nga Sipërmarrësit, përgatit informacione periodike mujore për sipërmarrësit që kanë njoftuar online për fillim/ndryshim/mbyllje aktiviteti për rrjetet dhe shërbimet publike të komunikimeve elektronike dhe i publikon ato në faqen elektronike të AKEP. Sipërmarrësit bëjnë përditësimin e ndryshimeve në Regjistër nëse ndryshimet kanë ndodhur më parë në Regjistrin Tregtar të QKR.

Me qëllim përmirësimin e procedurës së aplikimit online dhe të procesit të zbatuar nga subjektet e interesuara për t’u pajisur me licencë/autorizim/çertifikatë sipas akteve normative të nxjerra nga AKEP-i:

- a. Rregullore Nr.7, datë 23.12.2008, “Për dhënien e licencës “Për stacionet radio të anijes”,
- b. Rregullore Nr.6, datë 23.12.2008, “Për dhënien e “Çertifikatës Operatorit Radiodetar”,
- c. Rregullore datë 23.12.2008, “Për dhënien e licensës “Për stacionet radio të avionit””.
- d. Rregullore Nr.5, datë 23.12.2008, “Për dhënien e Autorizimit “Për stacionet radio bregdetare”,
- e. Rregullore Nr.14, datë 13.04.2010, “Për dhënien e licencës “Autoriteti i Llogarive Detare dhe Kodin AAIC”,

- f. Rregullore datë 13.04.2010, “Për shërbimet radioamatore në Republikën e Shqipërisë”,
- g. Rregullore Nr.21, datë 18.03.2011, “Për dhënien e Licencës së Përgjithshme për Ofrimin e Shërbimeve Postare”,
- h. Rregullores Nr.37 date 29.10.2015 “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”.

U krye ndërhyrje legjislative në këto akte duke parashikuar dispozita të cilat përmirësojnë zbatimin e procedurës së aplikimit online.

Gjatë vitit 2015 përveç regjistrit të sipërmarrësve janë përditësuar dhe regjistrat e shërbimeve të tjera me të dhënat e kërkuara sipas ligjit nr. 9918 dhe akteve rregullatore përkatëse, duke kryer periodikisht publikimin e tyre në “*ëeb site*” të AKEP.

Sipas rregullores “Për shërbimet radioamatore në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me VKD të AKEP, Nr.1222, datë 13.04.2010, e ndryshuar, është vijuar procesi për ndjekjen e procedurave për pajisje me licencë dhe çertifikatë për radioamatorë, mbajtja e korrespondencës me aplikantët dhe zbardhja e licencave të përkohshme për radioamatorët e huaj.

Gjatë vitit 2015, sipas procedurës së trajtimit të kërkesave për shërbimet e lëvizëshme ajrore dhe detare, është vazhduar me regjistrimin e subjekteve aplikuese për licenca/autorizime dhe çertifikata.

Sipas kërkesave të parashikuara në rregulloret për shërbimet e lëvizëshme ajrore dhe detare, janë evidentur në regjistra të veçantë të dhënat për subjektet e licensuara për stacionet radio të anijes, avionit, stacionet radio bregdetare, për autoritetin e llogarive detare dhe kodin AAIC dhe personat e pajisur me çertifikatën e operatorit radiodetar, të cilat janë publikuar në faqen ëeb të AKEP.

Më poshtë paraqiten në mënyrë tabelare sipërmarrësit dhe autorizime/licenca/çertifikata të regjistruara në AKEP deri në fund të vitit 2015 si dhe të ndarë edhe për disa nga shërbimet kryesore të ofruara.

Tabela 17 Regjistri i Sipërmarrësve që kanë njoftuar për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike deri më 31.12.2015

Regjistri i Sipërmarrësve që kanë njoftuar për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, periudha 02.02.2012-31.12.2014		
Sipërmarrës të regjistruar sipas regjimit AP	Të regjistruar	Të ç’regjistruar
Sipërmarrës të regjistruar për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike;	184	78

Sipërmarrës që ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike që mundësojnë transmetimin e programeve audiovizuale	125, ku 12 prej tyre janë regjistruar në 2015		7
Telefoni - 86	Fiks	Mobile	Kartë me parapagim
	82	4	3
Internet	132		
Shërbim me vlerë të shtuar	26		
Transmetim të dhënash	45		
Linja me qera	20		

Subjektet e pajisur me Çertifikata/Licenca për periudhën janar 2015-31 dhjetor 2015 janë:

1. Çertifikatë Operatori Radiodetar të lëshuara 36,
2. Licencë për stacionet radio anije të lëshuara 5,
3. Licencë Radioamator i Huaj të lëshuara 20,
4. Autorizim për stacionet radio avion të lëshuara 3.

Në zbatim të Rregullores Nr.25, datë 14.06.2012 “Për Pajisjet Radio dhe Fundore të Telekomunikacioneve dhe Njohjen e konformitetit të tyre”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 1977, datë 14.06.2012 si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 546, datë 13.06.2013 “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacioneve dhe njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre”, janë pajisur me Çertifikatën e “Konfirmim për Njohjen e Konformitetit për Pajisjen Radio” 6 pajisje .

8.2.1.2 Procedura e ç’regjistrimit

AKEP ka ndërmarrë kryerjen dhe verifikimin e përmbushjes së detyrimeve nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe me anë procedurës të inspektimit në distancë është administruar informacionit i përfutur. Sipërmarrësit janë inspektuar, lidhur me përmbushjen e detyrimeve dhe zbatimin e:

- Ligjit nr. 9918/2008 i ndryshuar dhe rregulloreve të nxjerra në zbatim të tij,
- Rregullores nr. 20, datë 19.2.2010 “Për pagesat për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike” e ndryshuar,
- Rregullores nr. 27, datë 21.9.2012 “Mbi Publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike” e ndryshuar,
- Rregullores nr.12, datë 7.04.2010 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike” e ndryshuar; si dhe të,
- Kushteve të përcaktuara në Autorizimin e përgjithshëm lidhur me,
- Kushteve të përcaktuara në Autorizimin Individual për përdorimin e frekuencave,

- Kushteve të përcaktuara në aktet normative të AKEP lidhur me,
- Publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve,
- Kushteve të përgjithshme të kontratave tip me pajtimtarin.

Në përfundim të këtij verikimi, është konstatuar se disa prej sipërmarrësve të komunikimeve elektronike të regjistruar sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm për:

- Ofrim shërbimi telefonik public,
- Ofrimin shërbimi internet,
- Ofrimi shërbimi me vlerë të shtuar SMS, VAS etj.

Nuk kanë zbatuar detyrimet lidhur me:

- Shlyerjen e detyrimeve – kryerjen e pagesave në AKEP,
- Depozitim të pasqyrave financiare dhe raportimin e të dhënave statistikore dhe financiare periodike në AKEP,
- Ndërtimin e “ëeb site” dhe pasqyrimin i informacionit të kërkuar sipas ligjit dhe rregulloreve të AKEP mbi tarifatat, kushtet e aksesit etj.

Në përfundim të këtij procesi, AKEP ka ç’regjistruar gjithsej 41 sipërmarrës të cilët ofronin rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike.

Sipërmarrësit e tjerë të cilët kanë rezultuar të evidentuar me mospërbushje të detyrimeve kanë kërkuar ç’regjistrim për arsye se nuk duan të ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike.

8.2.2 Administrimi i spektrit të frekuencave dhe numeracionit

8.2.2.1 Lëshimi i autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave

AKEP ka punuar vazhdimisht për heqjen e barrierave administrative në procesin e lëshimit të Autorizimeve Individuale. Për këtë ka informatizuar sistemin e aplikimeve për pajisjen me autorizim për frekuencat dhe për numra. Këshilli Drejtues miratoi aktet rregullatore “Rregulloret për Autorizimin Individual” dhe “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren “Për caktim dhe përdorim të numrave dhe serive numerike dhe PKN” duke bërë të mundur dhe implementimin e procesit “Aplikim Online” për kërkesat e caktimit të frekuencave, caktimit të numrave dhe raportimin e interferencave.

Nga fillimi i vitit 2015, për operatorët e shërbimeve të komunikimeve elektronike janë lëshuar nga AKEP:

- 40 autorizime individuale për përdorimin e frekuencave në 505 lidhje fikse të reja/ndryshuara, nga të cilat:

Vodafone Albania	15 (50 lidhje të reja, 190 ndryshime, 30 revokime),
Telekom Albania	5 (40 lidhje të reja, 86 ndryshime, 60 revokime),
Plus Communication	2 (20 lidhje për 3G test, 0 ndryshime, 6 revokime),
Albtelecom	4 (15 lidhje të reja, 29 ndryshime, 67 revokime),
Të tjera	25 (66 lidhje të reja, 9 ndryshime, 37 revokime).
- 115 autorizime individuale për përdorimin e frekuencave në 240 sisteme PMR radiokomunikim dhe radioalarmi dhe revokimin e 120 autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave në sistemeve PMR radiokomunikim dhe radioalarmi.

Bazuar në Rregulloren Nr. 33, datë 15.05.2014 “Për kushtet e përdorimit të frekuencave pa autorizim individual dhe kërkesat teknike për pajisjet radio që përdoren në këto breza”, miratuar me Vendimin të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 2481, datë 15.05.2014, është bërë konfirmimi i 597 formularëve të deklarimeve të lidhjeve (access point) në brezin 2.4/5.8 GHz në Modulin e Aplikimeve Online për 22 sipërmarrës.

Kryerja e procedurave të përcaktuara, sipas ligjit, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, pas miratimit përkatës:

Me qëllim:

- përmbushjen me sukses të politikës së zhvillimit të sektorit të komunikimeve elektronike,
- nxitjen e një konkurrence sa më efçente në tregun e komunikimeve elektronike dhe përdorimin sa më të frytshëm të frekuencave në rastet e kufizimit të tyre,
- të shfrytëzimit sa më efektiv të spektrit dhe ofrimit të shërbime me cilësi dhe çmime sa më konkurruese për konsumatorin.

AKEP ka zbatuar një proces dhënie të drejtash përdorimi të frekuencave objektiv dhe transparent në përfitim të konsumatorëve dhe ekonomisë shqiptare.

Kështu, në vlerësim të një pjesë të spektrit të lirë (disa kanale) të brezit GSM 900 AKEP, duke marrë parasysh se nuk kishte mundësi teknike për të mundësuar futjen e një operator të ri, me qëllim rritjen e efektivitetit të shfrytëzimit të gjithë brezit të frekuencave, përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar, si dhe interesin e shprehur nga sipërmarrësit e autorizuar për përdorimin e këtij spektri planifikoi që kanalet e lira radio, të jepen për përdorim. Për cmimin

dhe kriteret e vlerësimit bazuar në përcaktimet e ligjit 9918, i ndryshuar u krye edhe Këshillim Publik me palët përdoruese të këtij spektri.

Në përfundim të tenderit publik me procedurë të hapur, me objekt “Dhënia në përdorim e frekuencave në brezin 900 MHz për sistemet GSM”, AKEP i dha të drejtën e përdorimit për 9 kanale (2x200 kHz) sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a., i shpallur fitues i kësaj procedure. Sa i përket shfrytëzimit të brezit GSM1800 MHz, situata ishte më e ndryshme. Për shkak të alokimit jo në vazhdimësi të spektrit për operatorët e licensuar më herët, kishte një *gap* prej 12.6 MHz në mes të brezit të alokuar dhe rreth 25 MHz të pa alokuar në fund të spektrit, pa llogaritur disa kanale sigurie midis brezave.

AKEP me vendimin Nr.2413, datë 27.01.2014 nisi një proces Këshillimi Publik “Mbi përdorimin e brezave të frekuencave GSM 900/1800”. Qëllimi kryesor i këtij këshillimi ishte:

- Arritja e përdorimit efikas dhe pa interferenca të spektrit radio në brezin GSM900/1800,
- Futja e shërbimit të ri 4G (IMT e avancuar) në tregun e komunikimeve elektronike,
- Marrja e një opinion nga sipërmarrësit për ndryshimin e kushteve në autorizimet individuale aktuale të brezit 900/1800 MHz, për lejimin e teknologjive të reja në këto frekuenca (UMTS/LTE), për aplikimin e përcaktimeve të Planit Kombëtar të Frekuencave ku përdorimi kryesor në brezin 900/1800 MHz përveç GSM është edhe TRA-ECS, për të cilin specifikohet shënimi “IMT është konsideruar si pjesë e TRA-ECS”,
- Përdorim të kanaleve shtesë në brezin GSM 1800 me qëllim rritjen e kapaciteteve për përballimin e numrit të rritur të përdoruesve dhe trafikut shtesë që gjenerohet.

Pas përfundimit të Këshillimit Publik për brezat 900/1800 MHz, AKEP pas miratimit nga ministri të numrit të të drejtave, kriterëve të vlerësimit dhe çmimin minimal, në nëntor 2014 miratoi dokumentin e tenderit me vendimin nr.2527, datë 12.11.2014. Me datë 03.03.2015 u hapen ofertat e pjesëmarrësve në garë.

Në përfundim të vlerësimit u shpallën fitues, Telekom Albania, Vodafone dhe Albtelecom të cilët kanë marrë nga 2 të drejta përdorimi, 2x6 MHz, në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/ËiMAX ndërsa Vodafone fitoi të drejtën edhe për 2.4 MHz shtesë.

Me anë të VKM nr.300, datë 08.04.2015, për “Disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 468, datë 30.05.2013, të Këshillit të Ministrave, për “Miratimin e planit kombëtar për zhvillimin e Broadband-it”, autorizohej heqja e kufizimeve teknologjike dhe ndryshimi i autorizimeve individuale përkatëse pa pagesë shtesë nga ana e mbajtësit të autorizimeve, dhe kryerjen nga AKEP të procesit të riorganizimit të spektrit në këto breza.

Kështu, me Vendimet Nr.2564, 2565, 2566 dhe 2567, datë 11.05.2015 AKEP miratoi dhënien e Autorizimeve Individuale sipërmarrësve Albtelecom, AMC (Telekom Albania), Vodafone

Albania dhe Plus Communication, për përdorimin e frekuencave të brezit 900 dhe 1800 MHz pa kufizim teknologjik.

Për të garantuar barazinë dhe që shërbimet 4G të ofruara në këto breza të ishin në përmbushje të treguesve të cilësisë së shërbimit të ofruar dhe zona e ofrimit të këtyre shërbimeve të ishte sa më e gjerë, AKEP vendosi që data e fillimit të ofrimit të këtyre shërbimeve, pra 4G, të ishte 1 shtatori. E gjithë periudha deri më 15 gusht, datë kur operatorët do të raportnin në AKEP ishte planifikuar për zhvendosje në spektër për tu ripozicionuar në përputhje me autorizimet e reja të lëshuara nga AKEP dhe për të kryer teste.

Intensiteti i veprimeve si nga AKEP ashtu edhe nga operatorët ishte shumë i lartë kjo si për shkak të futjes për herë të parë të këtyre shërbimeve në tregun shqiptar ashtu edhe të vështirësisë së implementimit të këtyre sistemeve.

Duke vlerësuar punën e të gjithë aktorëve pjesëmarrës në këto procese dhe mbështetjen e dhënë si për AKEP ashtu edhe për operatorët, 1 shtatori si dita e fillimit ofrimit të shërbimeve 4G edhe në Shqipëri u finalizua me sukses.

Pas heqjes së kufizimeve teknologjike pa pagesë, sipërmarrësit përdorues të këtyre brezave të frekuencave:

- kanë detyrimin e mbulimit me shërbim të zonave të veçanta të territorit ku mungon aksesimi në shërbimet bazë si telefonia dhe internet;
- përmirësimin e cilësisë së mbulimit me shërbim dhe ofrimin e shërbimeve Broadband për zonat nën parametrat e përcaktuar në rregulloren përkatëse.

Për një shfytëzim sa më efektiv të spektrit AKEP, me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr.2662, datë 28.12.2015 bëri miratimin e dokumentit të Tenderit Publik me Procedurë të Hapur me objekt: *“Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1970 – 1980 MHz çiftuar me 2160- 2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915 – 1920 MHz”* dhe Njoftimin për Tender Publik. Hapja e ofertave u bë në datën 15.02.2016.

AKEP në përputhje me legjislacionin në fuqi, në përfundim të procesit pajisi ofertuesin/at fitues me Autorizimin Individual përkatës.

Përsa i përket përdorimit të brezit të frekuencave 2500–2600 MHz , në përfundim të Këshillimit Publik dhe miratimit nga Ministri të numrit të të drejtave, kritereve të vlerësimit dhe çmimit minimal, AKEP në shkurt 2015 miratoi me Vendimin nr.2538, datë 19.02.2015 dokumentin e tenderit.

Në 9 Prill 2015 u hapen ofertat dhe u vijua me vlerësimin dhe dhënien e të drejtave të përdorimit. Në përfundim të procesit Vodafone Albania fitoi të drejtën e përdorimit të 20 MHz spektër të çiftuar dhe 20 MHz spektër të paçiftuar dhe Telekom Albania fitoi të drejtën e përdorimit për 20 MHz spektër të çiftuar.

Me qëllim nxitjen e një konkurrence sa më efçente në tregun e komunikimeve elektronike dhe përdorimin sa më të frytshëm të frekuencave në rastet e kufizimit të tyre AKEP me anë të Vendimit të Këshillit Drejtues Nr.2663, datë 28.12.2015 miratoi dokumentin e Tenderit Publik me Procedurë të Hapur me objekt: “*Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz*”. Hapja e ofertave është përcaktuar të bëhet në datën 10.03.2016. AKEP në përputhje me legjislacionin në fuqi, në përfundim të procesit pajisi ofertuesin/at fitues me Autorizimin Individual përkatës.

Brezi i frekuencave 3400-3600 MHz, 3600-3800 MHz është i pashfrytëzuar. AKEP ka kryer një këshillim publik lidhur me kushtet e përdorimit të këtij brezi duke propozuar ndarjen e brezit për dhënien në përdorim.

AKEP ka kryer një studim mbi prespektivën e administrimit dhe sigurimit të përdorimit sa më të frytshëm të brezit të frekuencave 790-862 MHz, pas kalimit nga brez i frekuencave të caktuar në Planin Kombëtar të Frekuencave për përdorim për transmetimet audiovizive nën administrimin e Autoritetit të Mediave Audiovizive, në brez të frekuencave të caktuar për përdorim për qëllime civile nën administrimin e AKEP, duke marrë në konsideratë çështjet dhe aspektet që lidhen me:

- Gjendjen aktuale të administrimit dhe përdorimit të spektrit të frekuencave,
- Zbatimin e akteve ligjore dhe nën ligjore në fuqi si dhe si Vendimet dhe Rekomandimet e ITU dhe CEPT për mënyrën e shfrytëzimit të brezit 790-862 MHz,
- Ndikimi në treg i dhënies në përdorim të këtij brezi të frekuencave për qëllime civile sipas PKF,
- Ndarja teknike efektive për dhënien e të drejtave të përdorimit të brezit të frekuencave;
- Kushtet teknike për përdorimin e brezit 790-862 MHz,
- Kushtet lidhur me mbulimin e territorit dhe shërbimet e ofruara,
- Procedura që duhet të zbatohet për dhënien në përdorim të këtyre brezave të frekuencave,
- Bashkë-ekzistencës me fqinj (DTT),
- Këshillimit me palët e interesuara, etj.

Bazuar në përcaktimet dhe rekomandimet ndërkombëtare si dhe në eksperiencat e vendeve të tjera me marrjen në administrim të spektrit (siç përcaktohet në PKF të miratuar me VKM Nr.466, datë 27.2.2013) AKEP do të realizojë një Këshillim Publik me tregun.

Ky Këshillim Publik duhet të bëjë të mundur që nëpërmjet çështjeve që do të trajtojnë të marrë maksimumin e mundshëm për ndërtimin e një procedure të saktë, transparente, asnjëanëse për dhënien në përdorim të tyre.

8.2.3 Bashkërendimi i punës me administratat e vendeve fqinje dhe të vendeve të tjera për caktimin dhe përdorimin e radio-frekuencave, për pjesën e spektrit që administron

AKEP vitet e fundit ka shtuar të gjitha përpjekjet për të bërë të mundur nënshkrimin e marrëveshjeve teknike me qëllim koordinimin ndërkufitar. Kryesisht është punuar për arritjen e marrëveshjeve të koordinimit për sistemet GSM/DCS1800 për të shmangur në maksimum interferencat në zonat kufitare.

Janë në fuqi marrëveshjet me Autoritetin e Kosovës, të Malit të Zi dhe Autoritetin Maqedonas. Ndërkohë AKEP vazhdon bashkëpunimin me Autoritetin e Malit të Zi dhe Kosovës për menaxhimin e parametrave teknike të stacioneve të përcaktuara në marrëveshjet përkatëse dhe vendosjen e tyre në normat e lejuara.

8.2.4 Hartimi, miratimi dhe administrimi i Planit Kombëtar të Numeracionit për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë

Me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr.2631, datë 29.10.2015, AKEP miratoi “Përfundimin e këshillimit publik të dokumentit “Ndryshime në Planin Kombëtar të Numeracionit” dhe:

- Miratimin e ndryshimeve në Planin Kombëtar të Numeracionit,
- Miratimin e ndryshimeve në Rregulloren për Caktimin dhe Përdorimin e Numrave dhe Serive Numerike”.

Duke marrë në konsideratë ndryshimet e propozuara në PKN, AKEP ka rishikuar Rregulloren Nr.10 për “ Caktimin dhe Përdorimin e Numrave dhe Serive Numerike dhe Planit Kombëtar të Numeracionit”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 932, datë 11.08.2009, e ndryshuar me VKD nr. 2350, datë 13. 09. 2013.

Janë bërë disa përmirësime në tekstin e rregullores së numeracionit më tepër të karakterit redaktiv duke e përshtatur me ndryshimet e ndodhura dhe janë përmirësuar disa përkufizime duke i përputhur ato me përkufizimet e dhëna në Ligjin nr.9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa i përket ndryshimeve që janë bërë në PKN ata kanë të bëjnë përveç të tjerash dhe me përshtatjen e ndarjes së re administrative, Ligji 115/2014 "Për ndarjen administrativo- territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" si dhe me kalimin në një rajon gjeografik, pa prekur strukturën dhe konfiguracionin aktual të ndrajës së NDC-ve.

Meqenëse është filluar aplikimi i numërformimit me “0” në të gjithë territorin duke filluar nga data 1 Janar 2015, kjo lehtëson procedurën e implementimit të ndryshimeve në PKN.

Në PKN janë bërë përpjekjet për të përshtatur emertimet e reja në përputhje me Ligjin 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" si:

- Njësia administrative;
- Bashkia;
- Qarku.

Për të argumentuar ruajtjen e NDC-ve për një periudhë kohe të pacaktuar është përshtatur ndarja e re e territorit në njësi, bashki e qarqe me ndarjen e mëparshme në PKN sipas komunave, bashkive të vogla dhe bashkive bazë.

Është bërë kujdes që të ruhen përcaktimet ligjore për rajonin gjeografik dhe ndarjet aktuale në zonat gjeografike (NDC) sipas njësisve administrative dhe bashkive me qëllim ruajtjen e parimit të alokimit parësor të deritanishëm.

Si përfundim AKEP, me këto ndryshime realizoi kalimin nga 12 rajone gjeografike në një rajon gjeografik duke hequr informacionin gjeografik në përdorimin e numrave (rajonet) dhe pa prekur në thelb planin e numërformimit.

Ky ndryshim thelbësor rrit efektivitetin e përdorimit të numrave, i përgjigjet:

- ndryshimeve të mëdha demografike që kanë ndodhur në Shqipëri dekadën e fundit, veçanërisht rritja e madhe e popullimit të zonave urbane si Tirana, Durrësi etj,
- zhvillimit të rrjeteve të gjeneratës së re, nëpërmjet të cilave bëhet i mundur ofrimi i shërbimeve broadband dhe nëpërmjet saj reflektimi i ndikimeve në PKN të migrimit të rrjeteve TDM në rrjetet NGN,
- zgjerimit të zonës gjeografike për portabilitetin e numrit.

8.2.5 Caktimi i numrit dhe serive numerike të sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike:

Aplikimi për numrat dhe seritë numerike është pothuaj i automatizuar duke eliminuar kështu thuajse të gjitha procedurat ndërmjetëse administrative që zgjasnin këtë proces. Është ngritur sistemi i menaxhimit të Planit të Numeracionit që përfshin të gjithë kategoritë e numrave dhe matricën e ndërfaqur online.

Gjatë viti 2015 janë përpunuar dhe procesuar:

- Alokime numra dhe seri numerike janë trajtuar 39 aplikime;
- Anullim numeracioni janë trajtuar 37 aplikime.

8.2.6 Sigurimi i disponueshmërisë së bazës qendrore të të dhënave për portabilitetin e numrit:

Në mënyrë të vazhdueshme AKEP ka ndjekur funksionimin e sistemit të portabilitetit të numrit CRDB.

Në përgjithësi procesi ka ecur mirë. Një tablo me shifrat e numrave të bartur në fund të viteve 2014 dhe 2015 paraqitet si më poshtë:

Shërbimi Telefonik	I lëvizshëm		Fiks	
	2014	2015	2014	2015
Numra të bartur	102796	95782	5336	2661

Sipas të dhënave të CRDB (bazës së të dhënave të këtij sistemi) rezulton një shifër prej afro 2661 numrash fiks të bartur.

8.3 Mbikëqyrja e Faciliteteve

Menaxhimi i programit ATLAS.

Në kuadër të administrimit të proceseve që lidhen me mbikëqyrjen e ndërtimit të rrjeteve dhe shërbimeve shoqëruese (faciliteteve) është realizuar menaxhimi dhe integrimi në sistemin ATLAS si pjesë e sistemit Eëb-Gis i informacioneve hapsinore dhe jo hapsinore të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike për sistemeve të transmetimit të radio frekuencave dhe sistemeve për infrastrukturën e komunikimeve elektronike kabllore dhe kanalizime.

Bazuar në të dhënat e administruara nga ky sistem rezulton rreth 5,000,000 metra kabëll fibër optike e shtrirë në të gjithë territorin e vendit. Disa prej sipërmarrësve kryesorë të shtrirjes së fibrës optike dhe të tubacioneve të rrjeteve të komunikimeve elektronike të cilët bëjnë përditësime periodike në sistemin ATLAS po i rendisim më poshtë:

Spërmarrësi	Shtrirja e Kabëllit Optik në rrethe dhe akse kryesore rrugore
ALBtelecom	Në të gjitha rrethet dhe akset rrugore kryesore
ATU	Në akset rrugore kryesore
Abissnet	Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Korçë, Lushnje, Kavajë, Elbasan
Abcom	Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Lushnje, Pogradec, Shkodër
Tring	Tiranë, Durrës, Shkodër, Lushnje, Kavajë, Elbasan, Fier, Vlorë, Gjirokastër, Korçë, Berat, Rrogozhin, Peqin, Lezhë, Librazhd, Shijak
Nisatel	Vlorë, Durrës
VIVO	Tiranë, Durrës
Pronet	Tiranë
Itel	Tiranë
Itirana	Tiranë

Telekom Albania	Tiranë
Apollnet	Fier
Artan Zhiva	Pogradec
Enada on Line	Elbasan
ESDE	Tiranë
Keminet	Tiranë
Neofone	Tiranë
PLUS	Tiranë
Tel-kom	Elbasan
TVM Devolli	Devoll

Sipërmarrësi	Shtrirja e Tubacioneve në rrethe dhe akse kryesore rrugore
ALBtelecom	Në akset rrugore kryesore dhe shumicën e rretheve
Abissnet	Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Korçë, Lushnje, Kavajë, Elbasan
Abcom	Fier, Lushnje, Pogradec, Shkoder, Vlorë
Tring	Tiranë,
Nisatel	Vlorë, Durrës
VIVO	Tiranë

Moduli bën të mundur krijimin e hartave të prognozimit të përhapjes së sinjalit të përdorur nga operatorët që operojnë në vendin tonë, duke u bazuar në modelet më të përparura të rekomanduara nga ITU, ITU-R REC P.526, ITU-R REC P.530, ITU-R REC P.1546 për zonën e Tiranës dhe më tej.

8.4 Përmirësimi dhe zgjerimi i shërbimit Broadband

Me qëllim përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimit broadband është organizuar takimi me përfaqësuesit e operatorëve mobile në Republikën e Shqipërisë përkatësisht: TELEKOM ALBANIA, VODAFONE ALBANIA dhe ALBtelecom, për arritjen e marrëveshjes midis palëve për shtrirjen dhe përmirësimin e mbulimit të shërbimit Broadband në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Nga monitorimi në terren u arrit: Përcaktimi i zonave për investime të përbashkëta të operatorëve mobilë për shtimin dhe përmirësimin e shërbimeve GSM/UMTS/LTE përkatësisht:

- Vermosh Qendër,
- Valbona Qendër,
- Gërmenj,
- Kepi i Rodonit,
- Shkopet,
- Grykë Nokë.

Përcaktimi i zonave për bashkëpunim midis operatorëve mobile për shtimin dhe përmirësimin e shërbimeve GSM/UMTS/LTE përkatësisht:

- Qafë Shtama,
- Lura Fshat,
- Qafa e Vishës,
- Thethi,
- Gorica,
- Tri Porti (Vlorë).

Janë përgatitur raporte të detajuara dhe anekset me informacionin për marrëveshjen e mësipërme.

8.5 Monitorimi i spektrit të frekuencave, cilësisë dhe inspektimit

Për të garantuar ushtrimin e kompetencës ligjore lidhur me mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, në përputhje me këtë ligj dhe aktet e tjera në zbatim të këtij ligji, veçanërisht të zbatimit të kushteve të përgjithshme të përcaktuara në Autorizimin e Përgjithshëm si dhe të përdorimit të frekuencave dhe numeracionit në përputhje me kushtet e përcaktuara në Autorizimet Individuale, AKEP-i kryen në mënyrë të vazhdueshme inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve, monitorimin e cilësisë së shërbimit dhe monitorimin e përdorimit të spektrit prej tyre.

Detyrat për ushtrimin e veprimtarisë së inspektimit, monitorimit të cilësisë dhe monitorimit të spektrit si dhe vendosja e masave administrative kryhen nga Drejtoria e Monitorimit të Frekuencave, Cilësisë dhe Inspektimit (DMFCI).

8.5.1 Inspektimi

AKEP ka realizuar të gjitha objektivat e përcaktuara për vitin 2015, duke punuar me përgjegjësi, profesionalizëm dhe përkushtim me qëllim përmbushjen e detyrave, në zbatim të kuadrit ligjor dhe nënligjor aktual, si pjesë përbërëse aktive e Drejtorisë së Monitorimit të Frekuencave, Cilësisë dhe Inspektimit pranë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Ndjekja e Inspektimeve dhe problematika të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike.

Në zbatim të rregullores Nr.34, datë 23.12.2014 “Për Inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative” dhe Urdhrit Nr.1390 prot, datë 22.01.2015 "Për procedurën e inspektimit në distancë, administrimin e informacionit të përftuar dhe planifikimit të tematikës të inspektimit dhe monitorimit”, për vitin 2015 janë kryer 28 inspektime tek sipërmarrësit e komunikimeve elektronike të regjistruar në regjistrin e sipërmarrësve që

ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm.

Gjatë këtyre inspektimeve u konstatua se 9 sipërmarrës që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike në përputhje me kushtet e Autorizimit të Përgjithshëm (disa prej të cilëve iu lanë disa detyra dhe rekomandime), dhe 19 sipërmarrës nuk kishin zbatuar rregulloret e miratura nga AKEP dhe për këto shkelje u vendosën masa administrative me gjobë sipas ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

U vendosën 11 gjoba me vlerë 2.050.000 lekë nga të cilat u arkëtuan 1.350.000 lekë dhe janë në proces gjyqësor me AKEP për tu arkëtuar dhe 700.000 lekë.

Objekti i inspektimeve sipas planit vjetor ka qenë:

- Verifikimi i zbatimit të:
 - i) Kushteve të përcaktuara në Autorizimin e Përgjithshëm lidhur me:
 - ii) Kushteve të përcaktuara në Autorizimin Individual për përdorimin e frekuencave.
 - iii) Kushteve të përcaktuara në aktet normative të AKEP lidhur me:

8.5.2 Ndjekja e arkëtimeve të pagesave nga debitorët e AKEP

Vëmendje e veçantë i është kushtuar çështjes së arkëtimit të pagesave të pashlyera nga sipërmarrësit sipas parashikimeve ligjore dhe AKEP ka arritur të arkëtojë në llogarinë bankare shumën 8,641,198 lekë nga sipërmarrësit debitorë, si më poshtë vijon:

NR.	Sipërmarrësit	Përshkrimi i aktivitetit	Detyrimi për AKEP dhe Tarifë	Paguar
1	Nisatel sh.p.k	Mbikëqyrje	885,258	885,258
2	Iva Elektronik sh.p.k	Mbikëqyrje	13,595	13,595
3	Tibo sh.p.k	Mbikëqyrje	7,345	7,345
4	Orikum Telecom sh.p.k	Mbikëqyrje	4,713	4,713
5	Vivo Communication sh.p.k	Mbikëqyrje	368,888	368,888
6	Kraner sh.p.k	Mbikëqyrje	5,156	5,156
7	Netsyscom sh.p.k	Mbikëqyrje	41,297	41,297
8	Sintel sh.p.k	Mbikëqyrje	48,334	48,334
9	FBD sh.p.k	Mbikëqyrje	52,382	52,382
10	IT Tirana sh.p.k	Mbikëqyrje	442,168	442,168
11	Alban Tirana sh.p.k	Mbikëqyrje	28,886	28,886
12	Fibernet sh.p.k	Mbikëqyrje	37,045	-
13	Lunaltel shpk	Mbikëqyrje	6,582	-
14	Merita Xhika	Mbikëqyrje	3,176	3,176

15	Plus Communicatios Sha	Mbikëqyrje	6,200,000	6,000,000
16	Abissnet Sha	Mbikëqyrje	340,000	240,000
17	Vivo Communicatios	Mbikëqyrje	347,963	150,000
18	ASC Shpk	Mbikëqyrje	350,000	350,000
	Shuma		9,182,788	8,641,198

8.5.2 Marrjen e masave organizative dhe operative për detyrimin e sipërmarrësve lidhur me zbatimin e rregullave teknike për rrjetet.

Për zbatimin e rregullave teknike të përcaktuara në ligjin nr. 9918 dhe Rregulloren Nr.22 datë 24.06.2011 “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërurbane të komunikimeve elektronike”, është punuar për detyrimin e sipërmarrësve të cilët ndërtojnë ose përdorin rrjete të komunikimeve elektronike dhe ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike, që të zbatojnë kushtet e parashikuara në legjislacionin për të mos rrezikuar jetën dhe shëndetin e qytetarëve.

AKEP gjatë vitit 2015 në bashkëpunim me OSHEE dhe sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike kreu dhe mbikëqyri punën për largimin dhe sistemimin e kabllave nga shtyllat e OSHEE dhe shtyllat e ndriçimit të Bashkive, përfshirë trasversime të ulëta, në 23 qytete të Shqipërisë.

Gjatë vitit 2015 u arrit të bëhet një përmirësim rrënjësor i këtyre rrjeteve në qytetet kryesore të vendit, ku u shmangën rrjetet e komunikimeve elektronike nga rrjetet e energjisë dhe në shumicën e rrugëve kryesore dhe qendra tashmë kanë përfunduar ose është drejt përfundimit.

Kjo është një arritje e rëndësishme për garancinë e rrjeteve në uljen e rrezikshmërisë të këtyre instalimeve të rrezikshme për jetën e personelit të sipërmarrësve, përmirësimi i mirëmbajtjes si të rrjeteve të komunikimeve elektronike, por dhe të energjisë dhe ndriçimit.

Masat e marra deri tani kanë sjellë në zonat e ndërhyra një gjendje krejtësisht tjetër si në sigurimin teknik dhe treguesit e cilësisë së shërbimit por edhe në aspektin estetik dhe urbanistik të këtyre zonave. AKEP ka krijuar mundësinë e konsultimit me ëeb-in e AKEP në adresën: <http://www.akep.al/foto-galeri>.

Ashtu si AKEP ka deklaruar, vitet 2015 dhe 2016 janë vite të stabilizimit të rrjeteve dhe infrastrukturës urbane dhe instalimeve në segmentin e fundit.

Me përfundimin e fazës së urgjencës dhe daljes nga situata shumë serioze dhe plotësisht jashtë rregullave teknike të sigurisë, viti 2016 do të përqëndrohet në stabilizimin e këtij rrjeti fundor, ku siç dihet, këtu ka probleme serioze të zbatimit të Rregullores Nr. 22, për standartet e parashikuara aty në një seri nenesh dhe rregullash.

Për këtë qëllim AKEP u ka kërkuar operatorëve të rrjeteve që:

- Brenda datës 30 Dhjetor 2015, të dërgohen në AKEP parashikimet për ndërhyrje dhe rrugët ose zonat që parashikohen nga operatorët e rrjeteve si të përfshira në këto kërkesa të AKEP.
- Çdo sipërmarrës duhet të marrë në konsideratë këto kërkesa në planifikimet e tij për vitin 2016.

Në këtë aspekt, brenda muajit janar 2016, AKEP bëri një verifikim për të evidentuar zonat që mendon që duhet ndërhyrë gjatë vitit 2016 për çdo qytet, si dhe do të organizojë një tavolinë të rrumbullakët për të përcaktuar planin e veprimit deri në fund të vitit.

AKEP, ashtu si ka vepruar deri tani, do të koordinojë punën mes operatorëve dhe bashkëpunimin me OSHEE, për koordinimin e punëve në zona ku ka ndërthurje të rrjeteve si dhe do të jetë në ndjekje të planit në dinamikë.

Kjo ndërhyrje është e domosdoshme dhe në kohën e duhur dhe do të kërkohet bashkëpunim dhe nga instancat lokale, për sa ato janë përgjegjës për të disiplinuar përfundimisht këtë pjesë shumë problematike dhe jashtë kushteve, në disa raste dhe atyre më minimale, që kërkohen për mirëfunksionimin e tyre në standartet e kërkesave të rrjeteve Broadband.

8.5.3 Monitorimi i spektrit të frekuencave

Në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, rregullores për Monitorimin e Spektrit të Frekuencave dhe Urdhrit Nr. 1380, datë 29.12.2014, për monitorimin e pikave repetitive në territorin e vendit, AKEP ka realizuar objektivat e mëposhtme:

- Monitorimin dhe kontrollin periodik të frekuencave që përdoren në pikat kryesore të transmetimit në territorin e vendit,
- Monitorimin dhe zgjidhjen e problematikave të dala nga interferencat e operatorëve/sipërmarrësve të komunikimeve elektronike,
- Bashkëpunimin ndërinstitucional,
- Bashkëpunimin rajonal lidhur me problematikat që dalin në harmonizimin e përdorimit të frekuencave në rajonet kufitare dhe interferencat.

8.5.3.1 Monitorimi i radiolidhjeve fikse në pikat transmetuese të vendit

Monitorimi është kryer minimumi një herë në vit për pikat kryesore të trasmetimit sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 18 Monitorimi

Nr.	Vendi ku u kryhen matjet	Rrethi	Periudha e matjeve
1	Kërtushaj, Vorë, Ardenicë	Durrës, Tiranë, Fier	Gjatë muajit janar
2	Pinet, Kodër Durrës, Zvërnec,	Tiranë, Durrës, Vlorë	Gjatë muajit shkurt
3	Likovun, Grabian, Dajt	Fier, Lushnje, Tiranë	Gjatë muajit mars
4	Tarabosh, Tyrbe, Petresh, Krrabë,	Shkodër, Lezhë, Elbasan, Tiranë	Gjatë muajit prill
5	Çervenakë, Korçë, Gllavë,	Pogradec, Korçë, Tepelenë	Gjatë muajit maj
6	Sopot, Mile, Midë, Tregtan,	Gjirokastër, Sarandë, Pukë, Kukës	Gjatë muajit qershor
7	Tarabosh, Tyrbe, Petresh, Krrabë,	Shkodër, Lezhë, Elbasan, Tiranë	Gjatë muajit korrik
8	Çervenakë, Korçë, Gllavë,	Pogradec, Korçë, Tepelenë	Gjatë muajit gusht
9	Sopot, Mile, Midë, Tregtan,	Gjirokastër, Sarandë, Pukë, Kukës	Gjatë muajit shtator
10	Likovun, Grabian, Dajt	Fier, Lushnjë, Tiranë	Gjatë muajit tetor
11	Kërtushaj, Vorë, Ardenicë	Durrës, Tiranë, Fier	Gjatë muajit nëntor

8.5.3.2 Subjektet që ofrojnë Shërbim Audiovizual

Gjatë monitorimit të pikave të mësipërme janë identifikuar disa subjekte, kryesisht ato që ofrojnë shërbim audiovizual (broadcast), të cilat përdorin lidhje fikse pa u pajisur me Autorizim Individual. Për këto subjekte në disa raste u mbajt proces-verbal ku u njoftuan për të aplikuar në Modulin e Aplikimeve Online për pajisje me Autorizim Individual për lidhje fikse pikë më pikë dhe në disa raste të tjera u morr masa e sekuestrimit të pajisjeve.

8.5.3.3 Subjekte që ofrojnë shërbimet internet dhe data

Gjatë monitorimit të pikave të mësipërme janë identifikuar disa subjekte të cilat përdorin lidhje fikse mikrovalore, për të cilat u morr masa e sekuestrimit të pajisjeve dhe vendosjes së gjobave bazuar në nenin 134, 135 dhe 137 të ligjit 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” datë 19.5.2008 (i ndryshuar).

8.5.3.4 Subjekte të cilat ofrojnë internet nëpërmjet sistemeve që operojnë në brezin e frekuencave 2.4 dhe 5.8 GHz

Gjatë monitorimit të pikave në të gjithë territorin e vendit janë identifikuar shumë subjekte që shpërndajnë internet duke mos respektuar rregulloren Nr. 33 datë 15.05.2014 për "Kushtet e përdorimit të frekuencave pa Autorizim Individual dhe kërkesat teknike për pajisjet radio që përdoren në këto breza".

Pikat ku përdoren më shumë këto frekuenca janë: Mali i Dajtit, Petresh, Ardenicë, Likovun, Tyrbe, Tarabosh, Prezë dhe Vorë. Gjatë monitorimit janë bërë matje të frekuencave në këto

breza dhe është marrë masa e sekuestrimit të pajisjeve për të gjitha subjektet që përdorin këto breza.

Disa nga këto subjekte kanë aplikuar në AKEP, për tu pajisur me Autorizim Individual për përdorimin e frekuencave në lidhje fikse radio. Në monitorimin që u bë në 6-mujorin e dytë të vitit u vu re se shumica e këtyre subjekteve të cilat përdornin brezin 2.4 dhe 5.8 GHz nuk i përdornin më këto frekuenca, duke gjetur alternativa të tjera për shpërndarje interneti si shpërndarje me fibër optike etj.

8.6 Interferenca që shfaqin rrezikshmëri

Gjatë vitit 2015 në zbatim të Rregullores Nr. 35 datë 23.12.2014 Për “Administrimin e interferencave”, miratuar me Vendim Nr. 2529, datë 23.12.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, ligjin 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, datë 19.05.2008 (i ndryshuar), janë trajtuar ankesa nga subjektet e radionavigacionit brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë si:

- Ankesë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik të Italisë, ankesë nga HAKOM (Autoriteti Rregullator i Kroacisë) si dhe ankesë nga Albcontrol (ANTA),
- Në ankesën e bërë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik të Italisë, lidhur me interferencat e shkaktuara në brezin 800 MHz e cila përdoret për teknologjinë LTE. Burimet e sinjaleve interferues vijnë nga territori i Republikës së Shqipërisë të cilat janë transmetime analoge të sipërmarrësve audiovizivë. Për këtë problematikë AKEP bëri me dijeni Autoritetin e Mediave Audiovizive e cila ka në administrim këtë brez të frekuencave dhe i kërkoi ndërhyrjen e menjëherëshme për zgjidhjen e këtyre problemeve,
- Në ankesën që është bërë nga HAKOM specialistët e rregullatorit kroat kanë gjetur burimin e interferencës në frekuencën 113,710 MHz i cili është identifikuar si “Radio Eurostar“. AKEP i ka përcjellë AMA-s shkresën për zgjidhjen e këtij problemi. Pasi AMA trajtoi këtë problem dhe ndaj subjektit u morr masë për respektimin e parametrave të transmetimit (maskën, nivelin e ERP, etj) në përputhshmëri me kushtet e licencës,
- Në ankesën e bërë nga Albcontrol specialistët e AKEP bënë të mundur identifikimin e burimit të interferencës e shkaktuar nga një kamera e cila ishte vendosur në barin e “Bar Piazza” dhe aksesohet me rrjetin nëpërmjet lidhjes ëireless. Për arsye të dëmtimit të pajisjes shkactohej emetim në brezin e frekuencave në të cilat punon radari i Albcontrol. Në këtë rast u morr masa e bllokimit dhe sekuestrimit të pajisjes.

Problematike ngelet fakti i interferencave që shfaqen në hapsirën ajrore shqiptare për avionet që tranzitojnë vendin tonë dhe janë në lartësi mbi 7 km nga toka. Në këtë rast shqetësimin dhe zhurmat i dëgjojnë pilotët dhe jo komanduesit në tokë. AKEP nuk disponon mjete për të bërë matje në këto lartësi.

8.7 Interferenca që dëmtojnë cilësinë e shërbimit

Ankesa për interferenca janë paraqitur nga sipërmarrësi Albtelecom sh.a në Tiranë dhe Vlorë në teknologjinë UMTS, në pikat e transmetimit Mile, Tregtan dhe Koplík në brezin e radiolidhjeve fikse 6 GHz. Vodafone Albania sh.a ka paraqitur ankesë për interferencë në Kukës, Tiranë dhe Fier në teknologjinë UMTS. Telekom Albania sh.a ka paraqitur ankesë për interferencë në Shijak në frekuencat e dedikuara për përdorim GPS, në Tiranë dhe Korçë në teknologjinë UMTS.

Për sipërmarrësin Albtelecom sh.a gjatë monitorimit të radiolidhjeve Tregtan-Kukës, Mile-Sarandë dhe Koplík-Shkodër rezultoi se në këto transmetime shfaqen ndërhyrje ndërmjet dy polarizimeve në të cilat pajisjet e sipërmarrësit transmetojnë, në këtë rast u la detyrë verifikimi i kushteve të funksionimit të pajisjeve. Nga monitorimet e kryera në teknologjinë UMTS në Tiranë interferenca nuk është e vazhduar po shfaqet në mënyrë periodike gjë e cila bën të vështirë identifikimin e burimit në një kohë të shkurtër. Në lidhje me interferencën e shfaqur në Vlorë është identifikuar burimi i interferencës i cili emetohej nga transmetuesi i sipërmarrësit Vlora Chanel, në këtë rast u mor masa e bllokimit të funksionimit të transmetuesit dhe ju la detyrë sipërmarrësit të rregullojë parametrat teknik të transmetimit përpara së të vendosi në punë këtë transmetues.

Për sipërmarrësin Vodafone Albania sh.a nga monitorimet e kryera në teknologjinë UMTS në Tiranë interferenca nuk është e vazhduar po shfaqet në mënyrë periodike gjë e cila bën të vështirë identifikimin burimit në një kohë të shkurtër. Nga monitorimi i kryer në Kukës për ndërhyrje në teknologjinë UMTS rezultoi se interferenca shkaktohej nga vetë pajisja pasi emetonte jashtë brezit të saj në teknologjinë UMTS në këtë rast u la detyrë verifikimi i kushteve të funksionimit të pajisjeve. Nga monitorimi në Fier për ndërhyrje në teknologjinë UMTS u identifikua burimi i interferencës i cili emetohej nga transmetuesi i sipërmarrësit "AVN TV", në këtë rast u morr masa e bllokimit të funksionimit të transmetuesit dhe ju la detyrë sipërmarrësit të rregullojë parametrat teknik të transmetimit përpara së të vendosi në punë këtë transmetues.

Për sipërmarrësin Telekom Albania sh.a nga monitorimet e kryera në frekuencat e dedikuara për përdorim GPS u identifikua burimi i interferencës i emetuar nga transmetuesi i sipërmarrësit "Johaniter TV", në këtë rast u morr masa e bllokimit të funksionimit të transmetuesit dhe ju la detyrë sipërmarrësit të rregullojë parametrat teknik të transmetimit përpara së të vendosi në punë këtë transmetues. Nga monitorimet e kryera në teknologjinë UMTS në Tiranë rezultoi se interferenca nuk është e vazhduar por shfaqet në mënyrë periodike gjë e cila bën të vështirë identifikimin burimit në një kohë të shkurtër, në lidhje me ankesën e paraqitur për qytetin e Korçës është bërë i mundur identifikimi i burimit të interferencës i emetuar nga transmetuesi i sipërmarrësit "Magic TV", në këtë rast u morr masa e bllokimit të funksionimit të transmetuesit dhe ju la detyrë sipërmarrësit të rregullojë parametrat teknik të transmetimit përpara se të vendosi në punë këtë transmetues.

Masat janë marrë në përputhje me ligjin 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” datë 19.05.2008 (i ndryshuar), rregullores Nr. 35 datë 23.12.2014 Për “Administrimin e interferencave”, miratuar me Vendim Nr. 2529, datë 23.12.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

8.8 Bashkëpunimi

AKEP ka bashkëpunuar ngushtësisht me AMA-n për marrjen e masave ndaj subjekteve broadcast që shkaktojnë interferenca. Njëkohësisht është koordinuar me veprime të përbashkëta me Ablcontrol për mbajtjen në kontroll të brezit të frekuencave të cila përdoren për shërbime radionavigimi.

Bashkëpunimi rajonal lidhur me problematikat që dalin në harmonizimin e përdorimit të frekuencave në rajonet kufitare dhe interferencat

Gjatë vitit 2015 janë mbajtur marrëdhënie institucionale dhe është bashkëpunuar me rregullatorin kroat HACOM, rregullatorin e Malit të Zi EKIP, rregullatorin e Maqedonisë AEK dhe Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik të Italisë për trajtimin e problematikave që janë shfaqur në rastet e ndërferncave të shkaktuara.

8.9 Monitorimi i cilësisë së shërbimit

Gjatë vitit 2015 AKEP ka kryer monitorimin e cilësisë së shërbimit të qyteteve dhe akseve rrugore për teknologjitë GSM/UMTS/LTE si më poshtë:

1. Për shërbimet GSM/UMTS

1.1 Qytetet: Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Elbasan, Fier, Lushnje,

1.2 Akset rrugore: Tiranë – Durrës – Kavajë – Lushnje - Fier; Tiranë – Elbasan – Peqin - Rrogozhinë. Tiranë – Lezhë – Shkodër,

1.3 Hartimin e raportit përmbledhës mbi mbulimin me sinjal GSM për të katër operatorët si dhe për sinjalin ECDMA për të tre operatorët të cilët ofrojnë këto shërbime, për qytetet e mësipërme.

2. Për shërbimin LTE

2.1 Gjatë muajit gusht, përpara futjes së shërbimit të teknologjisë së LTE për operatorët Telekom Albania dhe Vodafone Albania në muajin shtator sipas Autorizimit përkatës u realizua monitorimi mbi verifikimin e përdorimit të shërbimit LTE për qytetin e Tiranës , Durrësit dhe aksit rrugor Tiranë-Durrës,

2.2 Janë hartuar raportet përmbledhës mbi treguesit e cilësisë së shërbimit për teknologjinë LTE për qytetin e Tiranës, Durrësit dhe aksit rrugor Tiranë-Durrës,

2.3 Janë njoftuar operatorët që ofrojnë shërbimin mobile për marrjen e masave për përmbushjen e KPI për teknologjinë LTE.

3. Për shërbimet GSM/UMTS/LTE

3.1 Për qytetet: Pogradec; Korçë; Ersekë; Devoll, dhe pikat turistike: Dardhë; Voskopojë; Gërmenj,

- 3.2 Monitorimin e treguesve të cilësisë së shërbimit për shërbimet GSM/UMTS/LTE për akset rrugore: Pogradec-Korçë; Devoll-Ersekë,
- 3.3 Janë hartuar raportet përmbledhës mbi treguesit e cilësisë së shërbimit për shërbimet GSM/UMTS/LTE për akset rrugore: Pogradec-Korçë, Devoll-Ersekë, për qytet Pogradec, Korçë, Ersekë, Devoll, për pikat turistike, Dardhë, Voskopojë, Gërmenj të cilët u janë dërguar operatorëve për marrjen e masave dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit në zonat problematike.
- 4. Mbi përdorimin e shërbimit UMTS
 - 4.1 Monitorimi mbi verifikimin e përdorimit të shërbimit UMTS për qytetin e Tiranës nga operatori PLUS Communication sipas autorizimit të kërkuar për testim në disa zona,
 - 4.2 Detyrimin e operatori PLUS Communication për ndërprerjen e ofrimit të shërbimit UMTS për qytetin e Tiranës deri në momentin e pajisjes me Autorizimin përkatës nga AKEP pasi ishte jashtë afateve të kërkuara.

8.10 Verifikimi i marrëveshjes së koordinimit ndërkufitar

- 1. Gjatë vitit 2015 janë realizur matje të përbashkëta ndërkufitare për verifikimin e zbatimit të Marrëveshjes së Koordinimit Nr. 0102-707/1 datë 07.02.2014 për brezat GSM 900/1800 të firmosur në Podgoricë midis Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Republikës së Shqipërisë (AKEP) dhe Agjencisë së Komunikimeve Elektronike dhe Shërbimeve Postare të Republikës së Malit të Zi (EKIP), të segmentëve rrugorë Hani i Hotit-Velipojë-Muriqan, Muriqan-Shirokë, Shkodër-Lezhë.
- 2. Janë hartuar raportet përmbledhës mbi nivelin e fuqisë së sinjalit GSM 900/1800, si dhe të përdorimit të kanaleve jo-preferenciale në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga operatorët mobile që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Republikën e Malit të Zi.
- 3. Raportet janë dërguar Rregullatorit të Malit të Zi për marrjen e masave për respektimin e marrëveshjes së firmosur më datë 07.02.2014 në Podgoricë midis Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Republikës së Shqipërisë (AKEP) dhe Agjencisë së Komunikimeve Elektronike dhe Shërbimeve Postare të Republikës së Malit të Zi (EKIP).
- 4. Është bërë njohja e operatorëve mobile Shqiptar me raportin e përgatitur nga rregullatori i Malit të Zi.
- 5. Janë njoftuar të katër operatorët e shërbimit mobile për marrjen e masave për respektimin e marrëveshjes së koordinimit ndërkufitar, uljen e fuqisë së trasmetimit dhe përdorimi i kanaleve preferencialë.
- 6. Janë planifikuar matje të përbashkëta ndërkufitare për vitin 2016 mbi verifikimin e zbatimit të masave të marra nga operatorët mobile të të dy vëndeve fqinje.

8.11 Zhvillimi i projektit “Sistemi Kombëtar Monitorimi të Spektrit të Frekuencave për Shqipërinë”

Gjatë vitit 2015 ka vijuar zbatimi i projektit të përbashkët AKEP- ITU për ngritjen e një Sistemi Kombëtar Monitorimi të spektrit të frekuencave për Shqipërinë”.

Me përfundimin e ndërtimit të Stacionit Fiks të Monitorimit në Pinet, mbyllet faza e parë e “Projektit për ngritjen e Sistemit Kombëtar të Monitorimit të spektrit të frekuencave”, duke bërë të mundur, së bashku me Stacionin Fiks të Monitorimit në Krujë, monitorimin 24 orë të brezit të frekuencave 20-3000 MHz, në një zonë 70 km rreth Tiranës dhe Durrësit, duke përfshirë dhe aeroportin ndërkombëtar në Rinas. Këto stacione do të kontrollohen në distancë nga Qendra Kryesore e Kontrollit (MCC), pjesë e Qendrës Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave, në Tiranë.

Në muajin maj u bë i mundur një upgrade i plotë i QKLM. Përditësimi i programit të monitorimit të cilësisë së shërbimit TEMS Investigation dhe raportimit TEMS Discovery në versionin e tyre më të fundit mundëson një monitorim sa më të saktë për operatorët e telefonisë së lëvizshme.

Në muajin nëntor në kuadër të implementimit të projektit për ngritjen e Sistemit Kombëtar të Monitorimit të spektrit të frekuencave, u përfundua rikostrusioni i godinës të AKEP e cila do të plotësojë të gjitha nevojat aktuale dhe të perspektivës me ambiente pune për një Qendër Kombëtare Monitorimi të spektrit të frekuencave (Qendër Kontrolli Kryesore – MCC).

8.12 Ushtrimi i funksioneve rregullatore në teknologjinë e informacionit dhe zhvillimit të broadband

Legjislacioni i fushës parashikon një rol dhe funksione të rëndësishme të AKEP për shërbimet me brez të gjerë, aksesin në internet dhe administrimin e cctld.al. Gjithashtu një aspekt shumë të rëndësishëm të punës përbën dhe mbështetja teknike për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit të brendshëm dhe aplikacioneve që përdoren për ofrimin e shërbimeve ndaj sipërmarrësve dhe të tretëve.

Për mbulimin e kësaj veprimtarie në strukturën dhe organikë e AKEP është ngritur Drejtoria e teknologjisë së Informacionit dhe Zhvillimit të Broadband.

Funksionet kryesore të drejtorisë janë:

- Administrimi i domain cctld.al, nën domainet e tij si dhe ENUM,
- Trajtimi i çështjeve që lidhen me aksesin në internet, shërbimet me brez të gjerë dhe masat mbrojtëse,
- Administrimi i sistemeve on line të shërbimeve administrative dhe rregullatore që kryen AKEP,
- Administrimi i aplikacioneve të AKEP,
- Studime, analiza dhe hartimi akte rregullatore për çështje që lidhen me objektin e veprimtarisë së drejtorisë.

8.12.1 Administrim i sistemeve cctld .al

Numri i domain-eve të regjistruar për vitin 2014 është **5,466** dhe kemi një numër total prej

15,975 domain-e. Në total verifikohet një rritje mbi 15% të domain-eve krahasur me vitin 2014.

Është evidentuar një rritje e konsiderueshme e domain-eve tek regjistrarët e akredituar duke kaluar AKEP nga regjistrari dominues në vendin e tretë. Dhe pse ka patur fluks aplikimesh pranë AKEP, ka patur dhe shume transferime të domain-eve nga AKEP tek regjistrarët e tjerë. Numri i domain-eve sipas regjistrarëve është paraqitur në tabelën më poshtë:

Tabela 19 Rregjistrarët

Regjistrari	Nr. Domain në 2014	Regjistrime në 2015	Nr. Domain në 2015
AKEP	4478	478	3423
Albtelecom sh.a	131	25	49
ShqipëriaCom sh.p.k	4962	2308	6497
Ëebhost sh.p.k	2037	2201	4342
Keminet sh.p.k	822	285	1028
Studio Driar	586	169	636

Është kryer administrimi dhe mirëmbajtja e *root server-ave të .al*, procesimi i aplikimeve kryesisht për regjistrim dhe modifikim teknik në përputhje me Rregulloren Nr. 2. për regjistrimin e domain-eve nën zonën .al dhe nën domain-eve .gov.al, .edu.al, .org.al, .com.al, .mil.al, .net.al.

Bazuar në numrin e domain-eve të regjistruar gjatë vitit 2015 dhe në numrin e tyre në fund të vitit 2015, rrezulton se më shumë se 2000 domain-e nuk janë rinovuar. Për këtë arsye dhe rritja e numrit të domain-eve të regjistruar është në vlerën e rreth 15%.

Më poshtë janë paraqitur në forme tabelare të dhënat e detajuara të numrit të domain-eve.

Tabela 20 Domainët

Domain	Numri i domain-eve të regjistruar, deri 2010	Numri i domain-eve të regjistruar, deri 2011	Numri i domain-eve të regjistruar, deri 2012	Numri i domain-eve të regjistruar, deri 2013	Numri i domain-eve të regjistruar, deri 2014	Numri i domain-eve të regjistruar, deri 2015
.al	3912	6200	8334	11466	12530	14621
.com.al	435	544	630	748	676	774
.gov.al	192	273	301	337	265	275
.org.al	93	116	134	165	145	145
.edu.al	81	124	133	129	106	120
.net.al	18	23	28	35	30	37
.mil.al	8	8	8	8	2	3
Total	4,793	7,387	9,568	12,888	13,760	15,975

Gjithashtu është kryer administrimi i sistemeve mbështetëse të cctld.al si:

- Monitorim i aksesit të jashtëm të Sistemit DNS, lidhjet përkatëse me ISP, ku shërbimi është ofruar nga 2 ISP, linja primare nga ABCOM dhe linja sekondare me Albtelecom kanë qënë në nivelin e kërkuar, pra një aksueshmeri në internet prej 100% për cctld .al,
- Monitorim dhe administrim i sistemit FRED, sistem i menaxhimit të domain .al,
- Ndjekja e problematikës dhe implementimi i zgjidhjeve për raportimet e regjistruarëve të akredituar.

Sa i përket sistemit qendror të administrimit të domain-eve .al janë kryer disa përmirësime në shërbimet e ofruara për regjistrarët e akredituar dhe në administrimin e domain-eve në tërësi. Është përmirësuar komunikimi i regjistrarëve nga API dhe janë shtuar funksionalitetet si vijon:

- CheckBlackList Domain on ReneëDomain,
- List contacts by domain,
- List NSSET by domain,
- Gjenerimi i çertifikatave të reja të sigurisë për regjistrarët (nga sistemi qendror).

Shërbimet e mësipërme u shtojnë më shumë lirshmëri veprimi dhe komunikimi regjistrarëve të akredituar si dhe përmirësojnë komunikimin e sistemin qendror të administrimit të domain-eve .al.

Gjithashtu janë përmirësuar dhe janë shtuar shërbimet në nivelin e administrimit të domain-eve:

- Filtrim i domain-eve sipas kontakteve “Posedues”,
- Filtrim i domain-eve sipas kontakteve “Administrativë”,
- Ekstrakt i të dhënave nga sistemi të një domain-i të caktuar sipas kërkesës,
- Shfaqja e Auth Code për të gjithë domain-et në ndërfaqen e Administratorit,
- Bllokimi i domain-eve sipas kërkesave në nivelin administrative.

Është kryer përmirësimi i hardëare mbi të cilat funksionon ccTLD.al si dhe janë përmirësuar komunikimet e tij në ndërfaqet API dhe Eëb.

Gjatë gjithë vitit janë raportuar disa probleme në komunikimin e regjistrarëve me sistemin qendror të cilave u është dhënë zgjidhje imediate.

Janë kryer auditime të sistemit në disa raste me kërkesën e regjistrarëve në lidhje me regjistrimin apo skadimin e disa domain-eve.

Nga AKEP si regjistra janë kryer procedurat e administrimit të doamin-eve të regjistruar si

regjistrar. Janë kryer njoftimet për rinovim dhe është vepruar për lëshimin e faturave përkatëse në kohë dhe brenda afateve si dhe dërgimi i faturave me mail në adresat përgjegjëse. Gjithashtu është rakorduar rinovimi i domain-eve të cilët kanë kryer pagesën përkatëse për rinovim.

8.13 Portabiliteti i Numrit

Në kuadër të përmbushjes së objektivave të AKEP për funksionimin dhe operimin normal të sistemit të CRDB sipas Rregullores dhe realizimi i procesit të bartjes së numrave për pajtimtarët gjatë vitit 2015 është kryer menaxhimi i sistemit dhe komunikimit midis operatorëve dhe ofruesit të CRDB. Gjenerimi i raporteve përkatëse në lidhje me procesin e bartjes së numrit dhe operatorëve.

8.14 Mbyllja e faqeve të internetit me përmbajtje të paligjshme

AKEP bazuar në kërkesat e ardhura nga institucione si Autoritetit të Mediave Audiovizive në zbatim të detyrimeve ligjore të ligjit nr.9918 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 15, i ka kërkuar ofruesve të shërbimit të Internetit (ISP) mbylljen e faqeve të internetit të cilat kryejnë transmetimin e evenimenteve sportive shqiptare apo të huaja në dispozicion të publikut, në mënyrë të kundraligjshme.

Në bashkëpunim dhe me kërkesë të Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit në zbatim të detyrimeve ligjore të ligjit nr.9918 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 15, AKEP i ka kërkuar ofruesve të shërbimit të Internetit (ISP) mbylljen e faqeve të internetit të cilat kryejnë vendosjen në dispozicion të publikut në mënyrë interaktive të veprave kinematografike, në mënyrë të kundraligjshme.

AKEP gjithashtu në vazhdimësi bazuar në vendimet dhe kërkesat që vijnë nga Zyra Shqiptare e të Drejtave të Autorit por edhe nga institucione të tjera për mbylljen e faqeve të internetit me përmbajtje të paligjshme, u ka kthyer përgjigje sipas rastit këtyre kërkesave.

8.15 Mbështetja e zbatimit të strategjisë për broadband

Janë hartuar aktet e nevojshme rregullatore në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në:

- Planin Kombëtar për Zhvillimin e Broadband miratuar me VKM nr. 468 datë 30.05.2013,
- Strategjinë e Qeverisë Shqiptare për Kalimin nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Dixhitale e Këshillit të Ministrave.

Janë analizuar Dokumente të tjera të rëndësishme dhe shumë të nevojshme, si:

ITU & Cisco - Planing for Progress - National Broadband Plans
ITU - Broadband Reports - Impact of Broadband on the Economy
ITU - Case Study Albania - Strategies for the promotion of broadband services and infrastructure, Case Study Macedonia, Romania, etc
ITU - Regulating broadband prices
ITU GSR 2014 - Monitoring implementation of Broadband Plans and Strategies
BEREC - Broadband Promotion Report 2013
BEREC – Report on mobile broadband prices
European Commission - Trends in European broadband markets
European Commission - Quality of Broadband in Europe 2013
OECD - Broadband Growth Policies
OECD - National Broadband Plans
UNDP - ICT for Development
World Bank - Building broadband - Strategies and policies
IRG - FSR Study on Broadband Promotion etj.

Gjatë muajve tetor, nëntor dhe dhjetor 2015 është punuar për formulimin e Strategjisë së AKEP për Broadband, çështje e cila është në ndjekje e sipër për të përfshirë të gjitha detyrimet ligjore, VKM-të, aktet rregullatore dhe VKD-të e AKEP, rekomandimet e ITU, BEREC etj në këtë Strategji.

Me qëllim vlerësimin dhe analizimin e situatës së Broadband në Shqipëri, është kryer përgatitja e informacionit (të dhënave) që do tu kërkohen operatorëve dhe kryesisht për:

- Internet Exchange Points dhe Data Rooms, etj,
- Kapacitetet e aksesin ndërkombëtar në internet dhe kapacitetet me shumicë që ju shesin ISP-ve të vogla në Shqipëri,
- Internetin në shkolla,
- Numrin e përdoruesve Internet 3G/Edge,
- Km e fibrës së shtirë nga operatorët kryesorë të fibrës optike dhe në veçanti për FTTH të shtrirë, në shtrirje apo në planet e aferta për tu shtrirë (zonat, numri i FTTH-ve, FTTH aktive, etj),
- Shpërndarjen e abonentëve nëpër rrethe, bashki dhe komuna, mënyrat e lidhjes së tyre, plane të aferta për rritjen e shtrirjes, etj),
- Abonentet biznes të tyre,
- Shërbimet Triple Play,
- Kërkesa të tjera sipas Analizës Broadband miratuar me VKD nr. 2416 datë 04.02.2014

8.16 Mbi Masat Teknike dhe Organizative për të Garantuar Sigurinë dhe Integritetin e Rrjeteve dhe/ose Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike.

- AKEP me anë të vendimit Nr. 2632 datë 29.10.2015 ka miratuar Rregullore nr. 37 datë 29.10.2015 “Mbi Masat Teknike dhe Organizative për të Garantuar Sigurinë dhe Integritetin e Rrjeteve dhe/ose Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”.
- Kjo rregullore është miratuar në një kohë ku vëmendje po i kushtohet këto vitet e fundit Strategjisë Kombëtare të Sigurisë, kapitulli mbi sigurinë e komunikimeve elektronike, si dhe bazuar në udhëzimet e ENISA (European Union Agency for Network and Information Security) e cila gjatë vitit 2014 ka publikuar disa dokumenta orientues kryesisht për autoritetet rregullatore në lidhje me sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike. Vlen të theksohet se deri tani kushtet dhe detyrimet për sipërmarrësit lidhur me masat teknike dhe organizative për të realizuar sigurinë e rrjeteve dhe/ose të shërbimeve të ofruara prej tyre përveç nenit 122 “Masat Mbrojtëse”, janë të prekura në Rregulloren Nr. 24, “Për Autorizim e Përgjithshëm” dhe Rregulloren Nr. 31, “Për termat e përgjithshme të kontratës së pajtimit për lidhjen dhe aksesin në rrjetin publik të komunikimeve elektronike”.
- Rregullorja mbi sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike ka në fokus përcaktimin e detyrimeve dhe masave bazë që operatorët duhet të ndërmarrin për të minimizuar apo parandaluar ndodhjen e incidenteve të sigurisë në rrjetet dhe/ose shërbimet e komunikimeve elektronike dhe për ti raportuar ato nëse ndodhin, përcaktimin e kushteve që duhet të plotësojë një cënim ose incident sigurie, në mënyrë që të lindë detyrimi i operatorëve për të informuar AKEP në lidhje me këtë cënim ose incident, standardizimin në vlerësimin dhe raportimin e incidenteve të sigurisë, mënyrën dhe përmbajtjen e raportimit të masave të sigurisë dhe incidenteve të sigurisë që duhet dorëzuar në AKEP.
- AKEP gjatë këtij viti përpara hartimit të draft rregullores për të patur dhe tablo më të qartë në lidhje me situatën “Mbi zbatimin e detyrimeve për sigurinë e komunikimeve elektronike” sipërmarrësve të komunikimeve elektronike u ka kërkuar informacion dhe të dhëna konkretisht në lidhje me :
 - Politikat e dokumentuara të sigurisë dhe implementimi i tyre lidhur me përpunimin e të dhënave në sisteme e veçanërisht për të dhënat personale.
 - Masat që kanë marrë për të informuar përdoruesit për një rrezik të veçantë, mënyrën se si rreziku mund të reduktohet nga përdoruesit, si dhe kostot e mundshme, që duhet të mbulohen nga përdoruesi, nëse rreziku që ndodh është jashtë masave, që mund të marrë sipërmarrësi.
 - Në rastet e cënimit të të dhënave personale, nëse kanë patur njoftime që janë kryer ndaj abonentit dhe AKEP-it për këto konstatime.
 - Sipërmarrësit duhet të mbajnë një inventar të shkeljeve të të dhënave personale, që përmban fakte lidhur me këto shkelje, ndikimin e tyre dhe masat e ndërmarra rregullatore. Ky inventar përfshin vetëm informacion të nevojshëm për këtë qëllim. Inventarin dhe numrin e rasteve të shkeljeve të hasura.
- Raportin me rezultatet e auditit të sigurisë të kryer nga një organ i çertifikuar dhe i

pavarur ose një autoritet kompetent në lidhje me masat mbrojtëse dhe sigurinë, duke përfshirë sistemet Hardëare dhe Softëare.

- AKEP bazuar në analizën e kryer nga raportimet e marra, ka arritur në konkluzionin se nga evidentimi i 182 sipërmarrësve, vetëm 45 sipërmarrës kanë përmbushur plotësisht detyrimet ligjore dhe ato rregullatore.

8.17 Dhoma e Server-ave pranë Qendrës Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave (QKMF)

Dhoma e Serverave lokalizohet në ambjentet e AKEP, QKMF. Dhoma e serverave është pika më sensibil e kësaj Qendre dhe e sistemit informatik sepse përqëndrimi i pajisjeve kompjuterike, mekanike, elektrike dhe elektronike është më i lartë se në ambjentet e tjera të punës. Në këtë ambjent ku do të vendosen sisteme të një rëndësie të veçantë në nivel kombëtar. Ka një kapacitet për të hostuar deri në 3 kabinete 42U.

Objektivat e arritur me përfundimin e këtij projekti janë:

- Standardizimi, menaxhimi dhe mirëmbajtja e dhomës së serverave të AKEP,
- Garantimi ifunksionimit të infrastrukturës kompjuterike në kushte normale dhe në kushte emergjence,
- Garantimi i fleksibilitetit të infrastrukturës fizike,
- Minimizimi i probabilitetit të mosfunksionimit të sistemeve të informacionit nga faktorë të jashtëm,
- Rritja e sigurisë së informacionit.

8.17.1. Ngritja e sistemit reserve (Backup) në Qendrën Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave

AKEP me zgjerimin e kapaciteteve egzistuese informatike dhe gjithashtu me mënyren e menaxhimit sistemeve për Backup/Restore/Monitoring në platforma tërësisht të sigurta për ruajtjen e disponueshmerise të shërbimeve dhe të të dhënave për administratën dhe për përdoruesit e tjerë të shërbimeve të AKEP ka implementuar një zgjidhje për ruajtjen e të dhënave dhe disponueshmerinë e shërbimeve në raste të difekteve në sisteme apo arsye të tjera të ndërprerjes së funksionimit normal. Zgjidhje është e dedikuar për platforma Virtuale në përdorim të AKEP dhe është një nga teknologjitë që ka aftësinë për të përmirësuar proceset e kryerjes së punëve dhe shërbimeve si dhe efikasitetin duke ofruar disponueshmëri më të madhe.

Sistemi Secure Backup off-site është një nevojë e domosdoshme për tu përgjigjur nevojave të sotme që ka AKEP për shërbimet, sigurinë e informacionit si dhe për përdoruesit e shërbimeve të autoriteti.

Me realizimin e këtij projekti është bërë e mundur krijimi i sistemeve redundante duke

siguruar disponueshmërinë e sistemeve IT dhe sigurinë e informacionit si dhe bërjen e mundur të operimit në kushte normale të AKEP edhe në rastet e mosfunksionimit të sistemeve primare të IT.

8.18 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe mbrojtja e konsumatorit

Ligji nr. 9918 parashikon që AKEP

- zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, në rastet kur ato lidhen me zbatimin e këtij ligji dhe të rregullave të nxjerra në zbatim të tij,
- nëse një mosmarrëveshje me një pajtimtari dhe një sipërmarrësi që ofron shërbime të komunikimit elektronik publik nuk mund të zgjidhet nëpërmjet procedurave për trajtimin e ankesave, sipas nenit 107 të këtij ligji, pajtimtari mund të kërkojë nga AKEP-i të zgjidhë mosmarrëveshjen.

Ligji nr. 46/2015 parashikon që AKEP:

- zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet ofruesve të shërbimeve postare dhe përdoruesve, kur të tilla mosmarrëveshje kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji,
- zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet ofruesve të shërbimit postar që lidhen me zbatimin e këtij ligji dhe rregullave të nxjerra në zbatim të këtij ligji.

Për ushtrimin e këtyre funksioneve, të shqyrtimit të ankesave administrative ndaj akteve të nxjerra nga AKEP, sipas procedurës së parashikuar në legjislacionin e procedurave administrative, përfaqësimit në shqyrtimin gjyqësor çështjeve ku AKEP është palë, si dhe të hartimit të projektakteve që nxjerr AKEP-i dhe interpretimit administrativ të legjislacionit kur paraqitet nevoja, në strukturë dhe organikën e institucionit është ngritur dhe funksionon drejtoria e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe mbrojtjes së konsumatorit.

Në këtë kuadër gjatë vitit 2015:

- janë hartuar dhe nxjerrë nga AKEP, 11 (njëmbëdhjetë) akte administrative të karakterit normativ (Rregullore),
- është përfaqësuar AKEP dhe janë ndjekur çështjet gjyqësore ku AKEP është palë në:
 - 22 (njëzet e dy) çështje në shqyrtim në Gjykatën kompetente të Shkallës së parë,
 - 7 (shtatë) çështje në shqyrtim në Gjykatën kompetente të Apelit,
 - 7 (shtatë) çështje në shqyrtim në Gjykatën e Lartë;
- janë shqyrtuar dhe është marrë vendim (ose janë në proces) për zgjidhjen e 5 (pesë) mosarrëveshjeve ndërmjet sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike,

- janë shqyrtuar dhe dhënë rekomandime (ose janë në proces) për zgjidhjen e 11 (njëmbëdhjetë) mosarrëveshjeve ndërmjet pajtimtarëve dhe sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike,
- janë shqyrtuar dhe është marrë vendim (ose janë në proces) për 15 (pesëmbëdhjetë) ankime administrative të palëve ankimuese kundra akteve të nxjerra nga AKEP,
- AKEP është angazhuar në trajtim juridik profesional dhe konsulencë ligjore në shqyrtimin e të gjitha praktikave administrative të depozituara në AKEP (dokumente, shkresave, akteve dhe projekt akteve) nga institucionet shtetërore, personat juridike privatë dhe personat fizikë.

8.19 Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe administrimi i brendshëm.

Me Vendim të Kuvendit të Shqipërisë nr.88/2015 “Për miratimin e strukturës, organikes dhe kategorizimit të pozicioneve të punes të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)” është miratuar struktura organizative dhe organika e AKEP, e përbërë nga 73 punonjës.

Gjatë vitin 2015, AKEP përmbushi detyrimet ligjore që burojnë nga ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë “i ndryshuar, dhe legjislacionin në fuqi të marrdhënieve të punës të nëpunësve civil dhe për punonjësit mbështetës, si për përmbushjen e detyrave funksionale, ashtu dhe për rritjen e performancës.

8.19.1 Në drejtim të menaxhimit të burimeve njerëzore është realizuar

- Implementimi i strukturës së re, miratuar me Vendim të Kuvendit të Shqipërisë nr.88/2015 të Kuvendit të Shqipërisë “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punes të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)” është ndjekur në zbatim të Ligjit Nr.152/2013 “Për nëpunësin Civil” i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi për nëpunësit civil dhe sipas Kodit të Punës për punonjësit mbështetës duke mundësuar rritjen e efikasitetit të stafit dhe cilësisë së kapaciteteve të burimeve njerëzore, në përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe rritjes së fleksibilitetit dhe transparencës në ushtrimin e funksioneve, në gjithë veprimtarinë e punës së AKEP.
- Janë mbikëqyrur dhe menaxhuar burimet njerëzore, duke zbatuar ndryshimet në legjislacionin për shërbimin civil, në respektim të parimeve kryesore të tij, për të mundësuar reduktimin e subjektivizmit në procesin e konkurrimit, përzgjedhjes së kandidatëve të kualifikuar profesionalisht, bazuar në merita, transparencë dhe llogaridhënie.
- Janë ndjekur trajnimet e nëpunësve në periudhë prove në Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA).
- Në zbatim të Ligjit nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil” dhe akteve nënligjore të tij AKEP ka zhvilluar gjatë vitit 2015 sipas strukturës së miratuar të gjitha procedurat e vendeve vakante të AKEP duke bërë publikimin e tyre në portalin e Shërbimit

Kombëtar të Punësimit dhe në faqen zyrtare të institucionit www.akep.al. Gjithçka është realizuar duke respektuar detyrimin ligjor të Vendimit nr.243, datë 18.3.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” dhe Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”.

- Në zbatimin e Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 ”Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë” dhe të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005 ” Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, Autoriteti Përgjegjës ka realizuar detyrat duke përmbushur të gjitha detyrimet ligjore të vendosura nga ILDKPKI lidhur me përditësimin e regjistrit të subjekteve që mbartin detyrim për deklarim të interesave private dhe për çdo informacion që kërkohet në lidhje me subjektet e deklarimit në AKEP.
- Mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 119, datë 18.9.2014, “Për të drejtën e informimit” nëpërmjet Programit të Trasparencës së AKEP, duke mundësuar azhurnimi në vijmësi të faqes zyrtare të AKEP me informacionet të domosdoshme në zbatim të legjislacionit në fuqi.
- Duke qenë se AKEP është një institucion që mbikëqyr sektorë shumë të specializuar siç janë ato të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve postare është punuar në vazhdimësi për rritjen e kapaciteteve dhe ngritjen profesionale të stafit të AKEP duke mundësuar pjesëmarrjen në disa aktivitete kualifikuese si seminare, trajnime dhe programe të organizuara nga ITU, UPU, Cullen International dhe agjenci të tjera të specializuara në fushën e telekomunikacioneve.
- Shfrytëzimi efikas i të gjitha burimeve, në drejtim të trajnimit të punonjësve të AKEP, mendojmë se ka mundësuar realizimin me sukses të objektivave të përcaktuara në legjislacionin e komunikimeve elektronike.
- Duke qenë se dosjet e personelit dhe regjistri themeltar i punonjësve kanë vlerë administrative e juridike është bërë e mundur mirëadministrimi i tyre sipas Kodit të Punës dhe Ligjit të Nënpunësit Civil 152/2013 dhe akteve nënligjore të tij.
- Për shkak të rëndësisë së veçantë që kanë të dhënat e personelit është plotësuar në vijim **Regjistri Themeltar i Personelit** sipas Vendimit Nr. 11/2014 të Kuvendit të Shqipërisë, “Për miratimin e strukturës, organikës, dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP). Duke koordinuar edhe me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe Pagesave, për të dhënat e nevojshme për pagat, klasat, vjetërsinë në punë etj., është ndjekur në dinamikë pasurimi i dosjeve të personelit, duke bërë në to ndryshimet përkatëse në bazë të akteve administrative.
- Ka vazhduar puna në informatizimin dhe automatizimin e proceseve të punës në institucion me zbatimin e programit “Payroll”, Revzone dhe Access Controllit.
- Menaxhimi i shërbimeve mbështetëse të AKEP-it, në të dy godinat, në funksion të institucionit, duke bërë të mundur funksionimin normal të veprimtarisë së tij. Për mirëmbajtjen e zyrave me qira dhe ndjekjen e procesit të rikonstruksionit të godinës

së AKEP, Rr. Reshit Çollaku Nr.43, Tiranë. Ka përfunduar me sukses rikonstrukcioni i godinës dhe është marrë në dorëzim objekti.

- Korrespondenca me intucionet e tjera ASPA, DAP, Shërbimi Kombëtar i Punësimit etj, në lidhje me çështje të ndryshme të cilat janë ndjekur nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Administrimit të Brendshëm.
- Procesi i “Vlerësimit në Punë” të punonjësve civil dhe të punonjësve mbështetës.

8.19.2 Në drejtim të marrëdhënive me publikun:

- Është realizuar informimi sistematikisht me shtypin e shkruar, elektronik dhe viziv dhe është përgatitur memo përkatëse lidhur me artikujt në të cilët është referuar AKEP-i.
- Është mbajtur kontakt i vazhdueshëm me mediat, duke azhornuar bazën e të dhënave me personat kyç të kontaktit në mediat më të rëndësishme në vend dhe adresimi njëkohësisht i kërkesave dhe interesimeve të gazetave apo mediave të ndryshme të vendit për informacion.
- Është azhornuar në vazhdimësi faqja e Internetit e AKEP me informacione të përditësuara dhe përkthime të njoftimeve në gjuhën angleze.
- Janë trajtuar (në bashkëpunim me strukturat përkatëse të AKEP) kërkesa të ndryshme të ardhura nga subjekte të interesuar në adresën pr@akep.al lidhur me procedurat kompetencë e AKEP.
- Është menaxhuar adresa elektronike info@akep.al, duke përcjellë pranë Kabinetit korrespondencën e ardhur.

8.19.3 Aktivitete / Koferenca / Seminare/Trajnime

Në kuadër të proceseve integruese të Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) ka thelluar bashkëpunimin me Komisionin Evropian, vendet anëtare dhe institucionet homologe Evropiane.

Ka ndjekur dhe ka siguruar pjesëmarrjen e stafit të AKEP në takimet e organizuar nga BE-REC si dhe ka ndjekur punën në Grupet e punës së BEREC.

Ka ndjekur takimet e Grupit Rregullator Evropian të Shërbimit Postar ERGP, duke siguruar pjesëmarrjen në Takimet Plenare.

Ka marrë pjesë në aktivitetet kryesore të ITU për 2015, si ERC-ITU 2015 dhe ËSIS-15. AKEP ka përgatitur dhe dërguar informacione periodike në Komisionin Evropian në kuadër të zbatimit të MSA, Dokumentit të Partneritetit Evropian (2007), rekomandimeve të

Raporteve të Progresit dhe rekomandimeve të nënkomiteteve të Stabilizim-Asociimit:

- Për Komitetin e Stabilizim-Asociimit mbi zhvillimin e tregut të telekomunikacionit në kuadër të zbatimit të MSA,
- Për nënkomitetin BE-Shqipëri “Tregu i Brëndshëm dhe Konkurrenca, përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit”,
- Për nënkomitetin BE-Shqipëri “Shoqëria e Informacionit dhe Politikat Sociale”,
- Për nënkomitetin BE-Shqipëri “Inovacioni, Burimet Njerëzore dhe Shoqëria e Informacionit”

Duke qenë se AKEP është një institucion që mbikëqyr sektorë shumë të specializuar siç janë ato të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve postare, është punuar në vazhdimësi për rritjen e kapaciteteve dhe ngritjen profesionale të stafit. Gjatë vitit 2015, është shfrytëzuar çdo mundësi trajnimi financiar nga fondet e AKEP, të organizatave ku vendi ynë është anëtar dhe kontribues si dhe të institucioneve homologe.

Trajnimet e kryera janë bazuar në domosdoshmërinë e forcimit dhe promovimit të kapacitetit të kapitalit intelektual “*burime njerëzore*” që posedon sot administrata e AKEP si dhe në përmbushjen e objektivave të AKEP, si më poshtë:

Tabela 21 Aktivitet

Nr.	Aktiviteti	Institucioni Organizues
1.	Takimin e 22-të Plenarë të BEREC	BEREC
3.	Pjesëmarrjen në takimin e 6-të BE-Shqipëri për “Tregun e Brëndshëm dhe Konkurrencën, përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit”	KE
4.	Forumi e Telekomunikacionit dhe Media	Cullen International
5.	Konferencën Rajonale mbi Reformën Postare	UPU
6.	Takimi i VI të Komitetit Stabilizim Asociimi	KE
7.	Konferenca Strategjike Globale të UPU-së	UPU
8.	Forumi i ITU Brezi gjerë për Zhvillim të qendrueshëm	ITU
9.	ËSIS 2015	ITU
10.	Konferenca Rregullatore e AEK	AEK
11.	Samiti European Internet of Things	Forum Europe
12.	Seminari Menaxhimi i Spektrit Kalimi në Transmetimet Dixhitale	ITU

13.	Përforcimi i kontrollit Financiar fondet BE	European Academy
14.	Konferenca e 10-të Menaxhimit i Spektrit	Forum Europe
15.	Trajnimi Mbi Rregullacioni e Telekomit European	Cullen international
16.	Ceremonin e 10-të vjetori i RATEL	RATEL
17.	Takimi i 23-të Plenar i Berec	BEREC
18.	Takim Pune AKEP-RTR	RTR
19.	Takimi i 8 Plenar i ERGP	ERGP
20.	Vizite Studimore Projektit GIS AEK	AEK
21.	Konf. 13 Ndërkombëtare për Telekomunikacionin	HAKOM
22.	Seminari Menaxhimi i Spektrit	BTK
23.	Konferencën Rajonale “Aktiviteti Rregullator në Sektorin e Komunikimeve Elektronike”	EKIP-ITU
24.	Vizitë pune për firmosja e MoU me UKE	AKEP - UKE
25.	Takimi plenarë i 24 të BEREC	BEREC
26.	Vizitë pune për firmosjen e MoU me AKOS	AKEP-AKOS
27.	ITU ERC 2015	ITU
28.	Takimin e 9-të Plenare të ERGP	ERGP
29.	Pjesëmarrje në Takimin e 25-të Plnarë të BEREC	BEREC
30.	Ndjekjen e kursit të trajnimit <i>online</i> « Ëireless and Mobile Broadband Internet »	ITU
31.	Pjesëmarrjen në Takimin e 7-të i Nënkomitetit Bashkimi Evropian-Shqipëri për “Inovacionin, Shoqëria e Informacionit dhe Politikat Sociale”	BE
32.	Pritjen në vizitë pune të delegacionit të ARKEP	AKEP-ARKEP
33.	Pritje e Delegacionit të EKIP	AKEP-EKIP
34.	Organizimin e Samitit të Rregullatoreve të Rajonit	AKEP-Intracom
35.	Konferencën “Digi-Dare Before the Final Sëitchover”	OSBE Kosovë

8.19.4 Në drejtim të administrimit të brendshëm janë kryer

Të gjitha procedurat e prokurimeve publike dhe me blerje të vogla janë realizuar sipas legjislacionit, akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Të gjitha procedurat e ndjekura gjenden në formatet bashkëlidhur informacionit.

Gjatë vitit 2015, janë realizuar 16 prokurime publike, kontratat e të cilave janë lidhur në vitin 2015. Në të gjitha procedurat e realizuara, është bërë kujdes dhe janë plotësuar formularët e deklarimit të konfliktit të interesave nga antarët e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe njësia e prokurimit.

Tabela 22 Regjistri i realizimeve të prokurimit publik për Vitin 2015

Nr.	Objekti i prokurimit	Fondi Limit (pa TVSH)	Vlera e kontratës (me TVSH)	Lloji i procedurës së prokurimit	Koha e zhvillimit të procedurës
1.	Upgrade i Qendrës Kombëtare të Lëvizshme të Monitorimit të Cilësisë	11. 200.000 Lekë	11.089.565 Lek	Procedurë e hapur	19.03.2015
2.	Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/ËiMAX		9.029.441 Euro 6.800.014 Euro 7.700.000 Euro	Procedurë e hapur	02.03.2015
3.	Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690MHz për aplikimet TRA-ECS		3.020.634 Euro 3.320.104 Euro	Procedurë e hapur	09.04.2015
4.	Sistemi i menaxhimit të proceseve të AKEP	10. 000.000 Lekë	9.701.000 Lek	Procedurë e hapur	24.06.2015
5.	Ndërtimi i stacionit Fiks i Monitorimit (RFMS) në Pinet (Shellter, kullë, rrethim, sistem sigurie, kamera/akses kontrolli, etj.	5.166.667	5.143.660	Kërkesë për propozim	08.05.2015
6.	Blerje karburanti	2.250.000	2.250.000	Kërkesë për propozim	05.05.2015
7.	Ruajtja e objekteve të AKEP me roje private	4.420.000	3.908.239	Kërkesë për propozim	01.07.2015
8.	Blerje pajisje kompjuterike	816.666	793,400	Kërkesë për propozim	15.06.2015
9.	Mobilim i disa ambjenteve të Qendrës Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave	2.143.906	1.604.9000	Kërkesë për propozim	17.08.2015
10.	Zhvillimi i Sistemit Kombëtar të Monitorimit të Frekuencave për pajisje stacioni monitorimi Fiks(RFMS) në Pinet	53. 666.667 Lek	52.712.450 Lek	Procedurë e hapur	28.09.2015
11.	Krijimi Cluster Bistalk Qendër Referencë të Centralizuar	2.666.667	3.040.002	Kërkesë për propozim	16.09.2015
12.	Blerje pajisje për Qendrën e Monitorimit të Frekuencave	487.882	584.4000	Kërkesë për propozim	12.10.2015
13.	Upgrade i sistemit të Menaxhimit të Regjistrave.al	2.722.500	3.1448.000	Kërkesë për propozim	23.10.2015
14.	Dhoma e Serverave pranë Qendrës Kombëtare të Monitorimit	5.000.000	5.616.000	Kërkesë për propozim	12.10.2015

15.	Ngritja e Sistemit reserve (Bacup) në Qendrën Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave	3.900.000	4.411.200	Kërkesë për propozim	13.10.2015
16.	Blerje e shërbimit të informacionit rregullator	15.000 Euro		Kërkesë për propozim	11.01.2016

9. Mbikqyrja e tregut të shërbimeve postare

9.1 Veprimtaria e AKEP për shërbimin postar - 2015

Hyrja në fuqi e Ligjit të ri për “Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”:

Kuvendi i Shqipërisë më datë 7.05.2015 miratoi Ligjin Nr. 46/2015, “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj zëvendësoi Ligjin nr. 8530, datë 23.9.1999, “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Pas botimit në fletoren zyrtare ligji 46/2015 hyri në fuqi në muajin Qershor 2015. Ligji 46/2015, për “Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, është përgatitur në përputhje të plotë me kuadrin ligjor të BE-së për sektorin postar, konkretisht me Direktivën 96/97/EC, e amenduar me Direktivën 2002/39/EC si dhe kryesisht me Direktivën 2008/6/EC, e cila ka ndryshuar thelbësisht Direktivën 96/97/EC sa i përket hapjes së plotë të tregut postar për konkurrencën.

Përgjatë procesit për hartimin e Ligjit 46/2015, AKEP ka qënë pjesë përbërëse e grupeve të punës të drejtuara nga Ministria përgjegjëse për shërbimin postar, duke kontribuar vazhdimisht dhe në mënyrë proaktive për përmirësimin dhe plotësimin e Ligjit 46/2015, duke i kushuar një vëmendje të veçantë sigurimit të shërbimit postar universal, për ofrimin e një minimumi shërbimesh me çmime të përballeshme si dhe përfitimin e të gjithë përdoruesve pavarësisht vendndodhjes së tyre gjeografike

9.2 Paketa rregullatore e hartuar dhe miratuar nga AKEP në zbatim të Ligjit 46/2015

Përgjatë vitit 2015, AKEP në ushtrim të kompetencave ligjore të përcaktuara nga neni 9 i Ligjit 46/2015, si organi rregullator kombëtar përgjegjës për rregullimin dhe mbikqyrjen e shërbimit postar, ka hartuar dhe miratuar aktet nënligjore përkatëse në zbatim të Ligjit 46/2015, duke krijuar kështu dhe paketën rregullatore të përshtatshme për garantimin e cilësisë së shërbimit universal postar, përmbushjen e kriterëve për ofrimin e shërbimit universal të parashikuara në Ligjin 46/2015, llogaritjen e kostove neto të shërbimit universal postar, përcaktimin efektiv të procedurave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesve dhe ofruesve të shërbimit postar dhe mosmarrëveshjet midis ofruesve, si dhe përcaktimin e hollësishëm të formës, përmbajtjes dhe dokumentacionit plotësues të kërkesës/njoftimit për të ofruar shërbimet postare nën regjimin e autorizimit të përgjithshëm.

Konkretisht, në nenin 65, të Ligjit 46/2015, AKEP është ngarkuar të nxjerr aktet nënligjore përkatëse në zbatim të neneve 12, pika 1; 14, 4; 16, pika 1; 19, pika 2 dhe 8; 31, pika 5; 33, pika 1; dhe 55, pika 6.

Brënda afatit ligjor prej 6 muajsh, të vendosur nga Ligji 46/2015, AKEP ka hartuar dhe miratuar aktet nënligjore (regulloret) në zbatim të këtij ligji, si më poshtë:

- a) Me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.2627, date 29.10.2015 është miratuar dokumenti Rregullore nr.36, datë 29.10.2015 ***“Për Ofrimin e Shërbimit Universal Postar”***.

Bazuar në përcaktimet e ligjit 46/2015, datë 07.05.2015 “Për ofrimin e shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë”, shërbimi universal postar përfshin ofrimin e vazhdueshëm të një minimumi të përcaktuar shërbimesh postare, me çmime të përballueshme, të mundshëm për të gjithë përdoruesit në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga vendndodhja gjeografike, dhe me një cilësi të përcaktuar me rregullore nga AKEP (neni 12 i Ligjit 46/2015). Në këtë rregullore janë përcaktuar treguesit e cilësisë së ofrimit të shërbimit postar brënda vëndit dhe për ofrimin e shërbimit universal postar ndërkombëtar, të cilat janë në përputhje të plotë me standartet e vendosura në Europë dhe në botë për shërbimet universale postare të përcaktuara nga UPU.

Ky dokument, sanksionon gjithashtu dhe të drejtat dhe detyrimet për ofruesin e shërbimit universal postar, si dhe për përdoruesit e këtij shërbimi, përcakton rregullat dhe kriteret për krijimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit postar me qëllim sigurimin e ofrimit të shërbimit universal në të gjithë territorin e vëndit, si dhe parashikon kushtet për mundësimin e aksesit në rrjetin postar për çdo ofrues të autorizuar nga AKEP dhe përdoruesve me shumicë të shërbimeve postare.

- b) Me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.2643, date 19.11.2015 është miratuar Rregullore nr.38, date 19.11.2015 ***“Për dhënien e Autorizimit të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare”***.

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri 46/2015, është sanksionuar se ofrimi i shërbimeve postare që nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal postar do të mund të kryhet përmes autorizimit të përgjithshëm, me njoftim. Për këtë qëllim, si dhe në zbatim të dispozitave ligjore, AKEP ka përcaktuar me këtë dokument kushtet e përgjithshme për ofrimin e shërbimit postar që nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal, si dhe të kërkesave thelbësore për ofrimin e shërbimeve postare. Në këtë rregullore është parashikuar gjithashtu procedura e njoftimit me shkrim, forma dhe përmbajtja e kërkesës si dhe dokumentacioni mbështetës që duhet të paraqes çdo subjekt që kërkon të ofrojë shërbime postare jashtë shërbimit universal postar.

- c) Me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.2652, date 17.12.2015 është miratuar Rregullore nr.39, datë 17.12.2015 ***“Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit postar dhe mosmarrëveshjeve ndërmjet ofruesve të shërbimit postar”***.

Sipas kompetencave të njohura nga ligji 46/2015, AKEP është autoriteti i cili ushtron të drejtën për të zgjidhur mosmarrëveshjet midis përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit postar, si dhe midis ofruesve të shërbimit postar. Në plotësim të dispozitave ligjore, AKEP me këtë rregullore ka përcaktuar jo vetëm procedurat që duhet të ndiqen nga ofruesit e shërbimeve postare dhe të përdoruesve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve por dhe strukturën përkatëse e cila do të zhvillojë procesin ankimor pranë AKEP. Gjithashtu, AKEP me këtë rregullore ka miratuar dhe formularin tip për paraqitjen e kërkesës për shqyrtimin e mosmarrëveshjes midis ofruesve të shërbimit postar, ose midis ofruesve dhe përdoruesve të shërbimit postar.

- d) Me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.2653, date 17.12.2015 është miratuar dokumenti Rregullore nr.40, date 17.12.2015 ***“Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi të dhënat e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”***.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është grumbullimi, evidentimi dhe përdorimi i të dhënave statistikore dhe financiare mbi shërbimet postare, për të bërë të mundur analizën mbi tendencat e zhvillimit të tregut postar. Kësisoj ky dokument ka përcaktuar në mënyrë të hollësishme procedurat dhe kushtet për plotësimin dhe dërgimin e të dhënave statistikore dhe financiare nga çdo ofrues i shërbimeve postare, duke parashikuar dhe mënyrat e raportimit dhe afatet për përmbushjen e këtij detyrimi.

- e) Me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.2658, date 28.12.2015 është miratuar Rregullore nr.20, datë 28.12.2015 ***“Për procedurën edhe menyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare”***.

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave mbi të cilat AKEP bazohet në përputhje me detyrimet ligjore, për procedurën që ndjek dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP, për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe atë postar, me qëllim garantimin për plotësimin e nevojave për financimin dhe buxhetin e AKEP, për ushtrimin e veprimtarisë si organ kompetent në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, nëpërmjet pagesave për mbikëqyrjen e tregjeve respektive, që duhet të kryejnë sipërmarrësit dhe ofruesit e shërbimeve postare.

- f) Me Vendim të Këshillit Drejtues Nr.2642, datë 19.11.2015 dhe Nr.2649, datë 3.12.2015 janë miratuar për këshillim publik¹⁶ dy draft-rregulloret e mëposhtme:

1. Rregullore për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostove të shërbimit universal postar,
2. Rregullore për llogaritjen e kostove neto të shërbimit universal postar.

¹⁶ Versionet finale të dy rregulloreve u miratuan me Vendimet e KD të AKEP nr.2670 dhe nr.2671, datë 3.03.2016.

Përgjatë procesit të hartimit të rregulloreve, në zbatim të ligjit 46/2016, janë organizuar disa takime me ofruesit e shërbimeve postare për prezantimin e objektivave të AKEP në përm-bushje të detyrimeve ligjore, me qëllim njohjen dhe diskutimin mbi komentet që kane patur palët e treta për përfshirjen e tyre në dokumentet rregullatore si dhe mbi detyrimin që kane ofruesit e shërbimeve postare për zbatimin e kërkesave të akteve rregullatore të miratuara nga AKEP.

9.3 Regjimi i ri i autorizimeve

Hyrja në fuqi e Ligjit 46/2015, solli ndryshim dhe sa i përket kushteve dhe kërkesave thelbësore që duhen të plotësojnë ofruesit e shërbimeve postare me qëllim ofrimin e shërbimeve postare. Sipas dispozitave të Ligjit 46/2015, ofruesi/ofruesit e SHërbimit Universal postar pajisen me autorizim individual ndërsa ofruesit e shërbimeve postare (që nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal) ofrojnë shërbimet sipas sistemit të autorizimit të përgjithshëm. AKEP ka dhënë Autorizimin Individual si ofruesi i vetëm i Shërbimit Universal Postar, me afat pesë vjeçar, Postës Shqiptare sh.a, si dhe janë ndjekur procedurat ligjore për kalimin e Ofruesve të tjerë të shërbimeve postare të pajisur nga AKEP me “Licencë të Përgjithshme për ofrimin e shërbimeve postare”, nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm.

9.4 Autorizim Individual për Postën Shqiptare

Në mbështetje të nenit 64 pika 3 e ligjit 46/2015, me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr.2581, datë 22.06.2015, AKEP pajisi subjektin Posta Shqiptare sh.a., me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar, me afat 5 vjeçar.

AKEP në përgatitjen e autorizimit individual të Posta Shqiptare u bazua kryesisht në:

- Ligjin 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”,
- Direktivat e KE “Për shërbimin Universal Postar”,
- Marrëveshjen në fuqi të subjektit “Posta Shqiptare” me Ministrin, Marrëveshje nr.1713, datë 26.05.2011 “Për ngarkimin e përm-bushjes së detyrimeve të shërbimit bazë postar në Republikën e Shqipërisë”,
- Eksperiencën e autoriteteve rregullatore të rajonit dhe BE,
- Dokumentacionin e dërguar nga Posta Shqiptare për t’u pajisur me Autorizim Individual me nr. 2091/1, datë 10.06.2015.

9.5 Transpozimi i Liçencave në Autorizim të Përgjithshëm

Sipas përcaktimeve të ligjit të mëparshëm subjektet e pajisur nga AKEP me “Licencë të Përgjithshme për ofrimin e shërbimeve postare” të regjistruar në regjistrin e AKEP deri në datën 31.12.2015 janë:

- Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare sh.a.
- Ofruesit e shërbimeve postare (10 subjekte).

Në zbatim të Ligjit Nr.46/2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të Rregullores nr.38, datë 19/11/2015, “Për Autorizimin e Përgjithshëm për Ofrimin e Shërbimeve Postare”, AKEP ka paisur subjektet në fjalë me Çertifikatë të Konfirmimit të Njoftimit për ofrimin e shërbimeve postare që nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal postar sipas Regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm. Transpozimi u krye në muajin Dhjetor 2015 duke përdorur modulën on-line të AKEP për këtë qëllim.

III Statusi i Shërbimit Universal

10. Statusi i shërbimit universal për shërbimet publike të komunikimeve elektronike

AKEP gjatë vitit 2015 realizoi një proces konsultimi me tre operatorët më të mëdhenj celularë për mbulimin me sinjal rrjeti GSM/UMTS të disa zonave të largëta si dhe për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar me rrjet UMTS në disa zona me densitet të ulët të popullsisë. Secili operator ra dakort për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në zonat e evidentuara individuale dhe të tre operatorët nënshkruan një marrëveshje kuadër bashkëpunimi më datë 5.11.2015 me tabelat përkatëse për investime të përbashkëta në 7 zona të largëta të territorit të Shqipërisë gjatë vitit 2016. Angazhimet individuale të tre operatorëve celularë dhe plani i investimeve të përbashkëta për zonat me densitet të ulët popullsie u miratuan nga AKEP me Vendimet nr. 2646, 2547 dhe 2548, date 03.12.2015.

Operatorët celularë kanë përmbytur detyrimet e mbulimit (territor dhe popullsi) dhe cilësisë së shërbimit sipas autorizimeve individuale, ndërkohë që këto masa (angazhimet e operatorëve dhe vendimet e AKEP) përveç rritjes së cilësisë së shërbimeve me akses broadband synojnë rritjen e mbulimit me sinjal telefonik dhe shërbime broadband duke kontribuar në këtë mënyrë në shërbimin universal në territorin e R.SH. Koordinimi/inkurajimi nga AKEP i një ose disa operatorëve që të ofrojnë akses në vendndodhje specifike gjeografike ku nuk ka mbulim me sinjal telefonik, jashtë skemës së SHU, është një prej veprimeve të parashikuara nga AKEP në Planin Kuadër 2013-2016 për Shërbimin Universal në fushën e komunikimeve elektronike.

Niveli i tarifave të thirrjeve telefonike (nga rrjete fikse dhe celulare) në Shqipëri vazhdon të jetë i përballueshëm dhe mbulimi me rrjete fikse dhe celulare në këto vite të fundit është përmirësuar si për shërbime tradicionale telefonie edhe për akses broadband nga rrjete fikse dhe celulare.

Nga krahasimi i paketës tarifore standarde Familjare të Albtelecom me paketat standard në vendet e rajonit rezulton se:

- Tarifa e pajtimit mujor standard e Albtelecom në nivelin 5 Euro/muaj (700 lekë/muaj me TVSH) është aktualisht më e ulëta në rajon (përveç Kosovës me rreth 4 Euro/muaj me TVSH),
- Vendet që kanë patur tarifë pajtimi mujor të ulët si Serbia, Mali i Zi, Maqedonia kanë lëvizur drejt rritjes së tarifës së pajtimit mujor dhe ndryshimet në Shqipëri të kësaj tarife duken të ngjashme me këto vende,

- Sasia dhe vlera monetare e thirrjeve të përfshira në tarifën mujore të Albtelecom janë më të lartat në rajon (pozitive për përdoruesin). Njëkohësisht në tarifën mujore Albtelecom përfshinte dhe akses në Internet 1Mbps, që përbën përfitim shtesë për përdoruesit e kësaj pakete,
- Vlera e tarifës së pajtimit mujor të paketës standarde të Albtelecom është në nivel të ngjashëm me tarifën e pajtimit mujor të paketave me përdorim të ulët në Kroaci, Maqedoni, Turqi dhe Kosovë dhe me përfitime ekstra (sasia e thirrjeve dhe aksesit në Internet të përfshira në tarifën e pajtimit mujor) më të mëdha se në këto vende.

Paketat standarde të operatorëve alternativë kanë tarifë pajtimi mujor shumë të ulët, madje ASC dhe Telekom Albania ofrojnë dhe paketa tarifore me parapagim (Pajtim mujor zero).

Karakteristikë tjetër e operatorëve Alternativë është ofrimi falas i thirrjeve brenda rrjetit (të përfshira në pagesën mujore).

Raporti i ITU, *Measuring the Information Society Report 2015*, në matjen e nivelit të tarifave për shërbimet e telefonisë fikse dhe celulare dhe aksesit broadband nga rrjet fiks dhe celular, i vë theksin përbalueshmërisë së çmimeve, dhe në bazë nivelit të tarifave në fillim të vitit 2015, ka bërë renditjen e vendeve sipas peshës që zënë shpenzimet për shporta të ndryshme konsumi të thirrjeve telefonike dhe aksesit broadband, fiks dhe celular.

Në këtë raport renditja e Shqipërisë është sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela 23 Renditja e Shqipërisë për shpenzimet indeksin e cmimve të ICT

	ITU Renditja 2014 ¹⁷		Vlerësimi i AKEP për 2015 ¹⁸	
	% GNI	Renditja ITU	% GNI	Renditja
Telefoni Fikse	1.77	91	1.77	91
Broadband Fiks	1.77	58	1.77	58
Telefoni celulare	8.03	138	1.70	75
Broadband celular	1.26-2.53	58-79	1.26-2.53	
IPB	3.9	106	1.7	65-68

Shqipëria renditet në vende të mira përse i përket tarifave të aksesit broadband por në vende më të ulëta për telefoninë, sidomos telefoninë celulare. Për telefoninë fikse është përdorur paketa familjare e Albtelecom dhe Shqipëria renditet në vendin 91. Për Shqipërinë, shpenzimet për këtë nën-shportë të shprehura në USD janë më të ulëtat në rajon, megjithatë sipas peshës ndaj GNI për frymë Shqipëria renditet pas Kroacisë, Malit të Zi dhe Serbisë në rajon, për shkak të GNI p.c më të ulët në rajon.

¹⁷ IPB (ICT Price Basket) matet si mesatarja e peshave ndaj GNI të telefonisë fikse, broadband fiks dhe telefoni celular. Shpenzimet për çdo shportë maten sipas metodologjise së ITU. GNI për frymë për Shqipërinë në 2014: 4505USD. Renditja kryhet sipas % ndaj GNI nga vlera më ulët në më të madhen për rreth 180 vende.

¹⁸ Vlerësimi është bërë vetëm për shportën e telefonisë celulare me ndryshimet në 2015.

Për telefoninë celulare, megjithëse tarifat efektive të paguara nga përdoruesit janë shumë të lira (ARPM dhe ARPU më të ulëta në Evropë), Shqipëria në raportin e ITU renditet në vende shumë të ulëta (138) për shkak se metodologjia e ITU merr në konsideratë vetëm tarifat standarde të thirrjeve (pay as you go) për përdoruesit me parapagim dhe jo ofertat e përkohëshme të operatorëve. Shpenzimet e llogaritura nga ITU për këtë nën-shportë (rreth 50 minuta kombëtare dhe 100 SMS kombëtare në muaj) me tarifat standarde të Vodafone Albania për paketën Vodafone Club, janë në nivelin 30USD dhe 8% e GNI për frymë në 2014.

AKEP bazuar në ndryshimet e tarifave të ndodhura gjatë vitit 2015 si dhe në tarifat që aktualisht paguajnë përdoruesit celularë, ka rivlerësuar shpenzimet për këtë nën-shportë dhe rezultatet dhe efekti në IPB janë dhënë në tabelën e mësipërme. Nga programet tarifore të katër operatorëve rezulton se me 800 lek (6.4 USD) mund të konsumohen 200 minuta dhe SMS kombëtare, pra katër herë më shumë thirrje së nën-shporta e ITU dhe 5 herë më lirë se vlerësimi i ITU. Ky rivlerim e çon Shqipërinë nga vendi 138 për nën-shportën e telefonisë celulare në vendin 75, dhe IPB nga vendi 106 në vendet 65-68, me renditjen më të mirë në rajon për përballeshmërinë e tarifave të ICT.

11. Statusi i ofrimit të shërbimit postar

11.1 Përcaktimet ligjore dhe nënligjore për ofrimin e shërbimit universal postar

Bazuar në përcaktimet e ligjit 46/2015, datë 07.05.2015 “Për ofrimin e shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë”, shërbimi universal postar përfshin ofrimin e vazhdueshëm të një minimumi të përcaktuar shërbimesh postare, me një cilësi të përcaktuar, të mundshëm për të gjithë përdoruesit në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga vendndodhja gjeografike, dhe me çmime të përballeshme, sipas përcaktimeve në nenin 12 të këtij ligji.

AKEP, në mbështetje të nenit 64 pika 3 e Ligjit 46/2015, me Vendimin Nr.2581, datë 22.06.2015 ka pajisur shoqërinë “Posta Shqiptare” sh.a. me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar me afat 5 vjeçar.

Në plotësim të kërkesave të nenit 65 të ligjit 46/2015, MIAP, ka nxjerrë:

- Urdhër nr. 6174, datë 16.12.2015, "Për përcaktimin e dëndësisë së pikave të aksesit për ofrimin e shërbimit universal postar".
- Udhëzimin nr.4038, datë 4.09.2015, për “Përcaktimin e shërbimeve universale postare që ofrohen pa pagesë për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër”, i cili përcakton detyrimet e ofruesit të shërbimit universal për ofrimin e objekteve postare cekograme pa pagesë për personat e verbër ose pjesërisht të verbër.

AKEP, në zbatim të nenit 65 të ligjit 46/2015 ka miratuar paketën e plotë rregullatore të ofrimit të shërbimeve postare, pjesë e së cilës është dhe Rregullorja nr. 36 datë 29.10.2015

“Për ofrimin e shërbimit universal postar”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr.2627, datë 29.10.2015 në të cilën janë përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen nga rrjeti postar i një ofruesi të shërbimit universal, me qëllim përmbushjen e standardeve të cilësisë së shërbimit postar.

Sipas kërkesave të Autorizimit Individual Posta Shqiptare duhet të përmbushë ndër të tjera:

1. Detyrimin për ofrimin e shërbimit universal postar ndaj çdo përdoruesi në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga vendndodhja gjeografike, duke përfshirë shërbimet postare brenda vendit dhe ndërkombëtare.
2. Organizimin e rrjetit postar me qëllim sigurimin e shërbimit universal postar sipas kërkesave të Ligjit 46/2015 dhe akteve rregullatore të miratuara nga AKEP për ofrimin e shërbimit universal postar.
3. Standardet e cilësisë së shërbimit universal postar.
4. Parimet për përcaktimin e tarifave dhe kostove për ofrimin e shërbimit universal postar.

11.2 Tregues të volumit dhe cilësisë së shërbimit universal postar


Sipas të dhënave të raportuara nga Posta Shqiptare për vitin 2015, shërbimi universal postar me një numër prej 17,313,717 objekteve të pranuar zë 96% të totalit të objekteve postare, përkundërt 4% që zë shërbimi ekspres me një numër prej 686,680 objekte postare të pranuar.

Posta Shqiptare për përmbushjen e detyrimit ligjor, dhe akteve rregullatore të nxjerra nga AKEP, ofron shërbimin universal postar me një rrjet postar të organizuar, në 552 zyra, me 597 sportele për ofrimin e shërbimit universal postar, nga të cilët 361 sportele janë të automatizuara/kompjuterizuara, duke mbuluar me shërbim të gjithë territorin e vendit. Për pranimin e objekteve postare ka venë në dispozicion të përdoruesve 601 kuti postare dhe për dorëzimin e objekteve postare 588 kuti postare.

11.2.1 Shërbimi universal postar / postë brenda vendit

Volumin kryesor në shërbimin universal postar që ofron Posta Shqiptare për objektet postare të pranuar brenda vendit e zënë objektet e thjeshta me 13,748,055 copë ose 81.7 %, të ndjekura nga objektet e regjistruara me 3,070,324 ose 18.2 %, dhe 0.1% pako/koli dhe urdhërpagesa. Në Figurën 25 të paraqitur më poshtë, jepen të dhënat lidhur me numrin e objekteve të shërbimit universal postar brenda vendit të pranuar nga Ofruesi i Shërbimit Universal gjatë vitit 2015, si dhe të dhënat krahasimore të këtyre shërbimeve në raport me vitet paraardhëse.

Figure 25 Posta Shqiptare - Shërbimi universal postar / brenda vendit 2012-2015



Nga krahasimi i të dhënave rezulton se numri i objekteve postare të pranuar për shërbimin universal postar të postës brenda vendit gjatë vitit 2015 ka rënë me rreth 7.5 % krahasuar me vitin 2014.

11.2.2 Shërbimi universal postar / postë ndërkombëtare – Viti 2015

Në shërbimin universal postar/ postë ndërkombëtare treguesit më të mirë Posta Shqiptare i ka në objektet e thjeshta me 264,035 copë ose 53 %, objektet e regjistruara me 214,988 copë ose 43 %, të ndjekura nga shërbimet e tjera.

Figure 26 Posta Shqiptare – Shërbimi universal postar/ Postë ndërkombëtare





Figure 27 Posta Shqiptare – Shërbimi universal postar / Postë ndërkombëtare - Krahasimi në vite.



Nga krahasimi i të dhënave rezulton se numri i objekteve të realizuara në shërbimin universal postar të postës ndërkombëtare gjatë vitit 2015 ka rënë me rreth 9.2 % krahasuar me vitin 2014.

11.3 Dendësia e pikave të aksesit të Shërbimit Universal Postar

Në funksion të rjetit postar Posta Shqiptare për vitin 2015, ka realizuar në ofrimin e shërbimit universal postar këta tregues kryesorë:

- Objekte postare të pranuar nga Posta Shqiptare për shërbimin universal postar 17,313,717 në raport me popullsinë (banorë rezident) 2,886,026 janë **6 objekte / banorë**.
- Për numrin e zyrave postare gjithësej të hapura për publikun 552, për ofrimin e shërbimit universal postar nga Posta Shqiptare në raport me popullsinë 2,886,026, një zyre postare i ofron shërbimin universal postar një numri mesatar të popullsisë prej **5,228 banorë /zyrë**.
- Për numrin e zyrave postare gjithësej të hapura për publikun 552, për ofrimin e shërbimit universal postar nga Posta Shqiptare në raport me sipërfaqen 28,748 Km², ka një zyrë postare mesatarisht në një sipërfaqe prej **52 Km² / zyrë**.

11.4 Standardet e cilësisë së shërbimit universal postar

AKEP, për te garantuar cilësinë e shërbimit universal postar sipas standardeve ndërkombëtare, ka përcaktuar në Rregulloren për ofrimin e shërbimit universal postar, standardet për shërbimin universal postar brenda vëndit dhe postës ndërkombëtare.

1. Standardet e cilësisë për shërbimin universal postar brenda vendit të ofruar nga Posta Shqiptare:

	Afati Kohor i shpërndarjes (D+n)	Objektivi (në përqindje sipas afatit)	Realizimi (në përqindje sipas afatit)
Brenda për brenda qytetit	D + 1	95%	
	D + 2	5%	
Ndërmjet qyteteve	D + 1	85%	
	D + 2	15%	
Në fshatra	D + 2	60%	
	D + 3	20%	
	D + 4	20%	

2. Standardet e cilësisë së shërbimit universal postar ndërkombëtar:

	Afati Kohor i shpërndarjes (D+n)	Objektivi (në përqindje kumulative)	Realizimi (në përqindje kumulative)
Vendet e BE (Poste Europe)	D + 3	85%	
	D + 5	97%	
Vendet e Tjera (UPU)	D + 5	85%	

11.5 Tarifat e shërbimit universal postar

Ligji 46/2015 përcakton dhe parimet për tarifat e shërbimit universal postar dhe metodat e mundshme për rregullimin e tyre. Sipas nenit 28 të ligjit 46/2015, tarifat për çdo shërbim që bën pjesë në shërbimin universal postar duhet të përmbushin parimet e mëposhtme:

- a) të jenë të përballueshme dhe të tilla që të gjithë përdoruesit, pavarësisht vendndodhjes së tyre gjeografike, të kenë akses në shërbimet e ofruara,
- b) të jenë të orientuara drejt kostos dhe të sigurojnë nxitje për ofrimin efikas të shërbimit universal postar,
- c) të jenë të njëjta për shërbime të njëjta në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë,
- d) të jenë transparente dhe jo-diskriminuese, të mos dëmtojnë konkurrencën.

Tarifat aktuale të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare Sh.a. janë të miratuar me VKM nr.466, datë 22.09.2002 dhe nuk kanë pësuar ndryshim gjatë kësaj periudhe. Posta Shqiptare gjatë vitit 2015 ka depozituar në AKEP kërkesën për rishikim të tarifave të shërbimit postar në të cilat bëjnë pjesë dhe tarifat për shërbimin universal postar. AKEP, bazuar në përcaktimet e ligjit 46/2015, si dhe kërkesën me të dhënat e dërguara nga Posta Shqiptare, aktualisht është në proces diskutimi me Postën Shqiptare sh.a, si Ofrues i vetëm i Shërbimit Universal Postar për rishikimin e tarifave të shërbimit universal postar.

11.5.1 Përmbledhje e krahasimit të tarifave të Posta Shqiptare me tarifën benchmark në vendet e BE

AKEP përgjatë vitit 2015 ka analizuar tarifën e shërbimit postar universal të ofruar nga Posta Shqiptare dhe ka bërë krahasime me tarifën në vendet e rajonit dhe BE. Disa nga përfundimet kryesore të kësaj analize janë dhënë më poshtë:

Ecuria e tarifave të shërbimeve postare në vendet e BE në periudhën 2004-2011 tregon se:

- Tarifën e letrave 20 g, prioritare dhe jo-prioritare, brënda vëndit dhe ndërkombëtare, janë rritur me 33-50% në terma nominale dhe 11-20% në terma reale,
- Tarifën e letrave me shumicë (bulk) janë rritur me 16-18% në terma nominale dhe reduktim me 1.4% deri në rritje me 1.6% në terma reale,
- Tarifën për pakot e vogla postare (1-2kg) janë rritur me 31-37% në terma nominale dhe 7-11% në terma reale,
- Tarifën kanë pasur norma vjetore rritje me të madhe para vitit 2009 se pas vitit 2009.

Ndërkohë në Shqipëri në periudhën 2003-2015 nuk ka pasur ndryshime të tarifave të shërbimeve postare (pjesë e Shërbimit Universal) të ofruara nga Posta Shqiptare, ndërkohë që norma e ndryshimit të Indeksit të përgjithshëm të çmimeve të konsumit (ICK) në periudhën 2003-2014 ka qënë 33%.

Tabelat e mëposhtme paraqet një përmbledhje të krahasimit të tarifave të objekteve të ndryshme postare në vendet e rajonit dhe BE sipas publikimit të ERGP (Grupi i Rregullatorëve Evropianë të Postave), të shprehura në Euro dhe Euro PPP, të krahasuara me tarifën e Postës Shqiptare për këto objekte.

Tabela 24 Përmbledhje e Krahasimit të tarifave për objekte të ndryshme postare

	20g		50g		500g		Pako 1Kg		Pako 2Kg		Pako 10 Kg	
	EURO	EURO PPP	EURO	EURO PPP	EURO	EURO PPP	EURO	EURO PPP	EURO	EURO PPP	EURO	EURO PPP
Mesatare BE	0.63	0.71	0.78	0.87	2.15	2.38	5.61	5.65	6.11	6.25	9.63	9.81
Mesatare Rajon	0.42	0.82	0.49	1.01	1.42	2.98	1.23	2.36	1.39	2.72	2.53	5.10
Shqipëri	0.29	0.65	0.36	0.81	0.50	1.13	0.43	0.97	0.64	1.45	0.93	2.10
Shqipëri/Mesatare BE	-55%	-9%	-54%	-7%	-77%	-53%	-92%	-83%	-89%	-77%	-90%	-79%
Shqipëri/ Mesatare Rajon	-31%	-22%	-27%	-20%	-65%	-62%	-65%	-59%	-54%	-47%	-63%	-59%

Burimi ERGP dhe AKEP

Nga të dhënat e tabelës se mësipërme mund të vihet re se tarifën e Postës Shqiptare në kursin normal të kembimit (tarifën në Euro) janë:

- 54-90% me të ulëta se mesatarja në vendet e BE,

- 27-65% më të ulëta se mesatarja në vendet e rajonit,
- për pakot postare 10-13 herë më të ulëta se mesatarja në vendet e BE dhe 2-3 herë më të ulëta se mesatarja në vendet e rajonit.

Tabela e mësipërme si dhe në publikime të ndryshme për tarifën e shërbimeve postare të ERGP dhe KE, dhe institucione të ndryshme ndërkombëtare, përdorin edhe kurset e këmbimit të përshtatura me nivelin e përgjithshëm të çmimeve të vendit përkatës apo fuqinë blerëse (PPP-Purchasing Power Parity), pasi sektori postar ka përdorim intensiv të punës dhe shpenzimet për paga zënë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve totale për ofrimin e shërbimit postar dhe një ndër kriteret kryesore për tarifën e shërbimit universal postar është përballeshmëria. Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të përmblodhur tarifën mesatare të BE dhe rajonit, si dhe tarifën e Postës Shqiptare, të gjitha të shprehur në LEK, duke përdorur kursin e këmbimit Euro PPP, dhe nivelin e ndryshimit të tarifave mesatare në vendet e BE dhe Rajonit me tarifën në Shqipëri.

Tabela 25 Tarifën mesatare BE- Rajon dhe Posta Shqiptare në LEK

	Leter 20g	Leter 50g	Leter 500g	Pako 1Kg	Pako 2Kg	Pako 10Kg
ALL LEK	40	50	70	60	90	130
Mesatare BE LEK	44	54	148	350	388	608
Mesatare Rajon LEK	51	62	185	146	169	316
Ndryshimi BE/Shqipëri	10%	8%	111%	484%	331%	368%
Ndryshimi Rajon/Shqipëri	27%	25%	164%	143%	88%	143%

Nga tabela e mësipërme me tarifa të përshtatura me fuqinë blerëse në Shqipëri (kursi i këmbimit PPP), mund të vihet re se:

- tarifën e letrave 20g-50g në vendet e BE dhe rajonit janë 8-25% më të larta se tarifën e Posta Shqiptare,
- tarifën e pakove postare në vendet e rajonit janë 88-143% më të larta se të Posta Shqiptare ndërsa në vendet e BE këto tarifa janë 331-484% më të larta se të Posta Shqiptare.

Për sa më sipër mund konkludohet se në Shqipëri tarifën e shërbimit universal postar nuk kanë probleme përballeshmërie. Tarifën e Posta Shqiptare nuk kanë ndryshuar për 12 vjet dhe janë deri në 13 herë më të lira se në vendet e BE/Rajonit. Struktura e tarifave të objekteve postare të Posta Shqiptare ka diferencë të mëdha me ato të vendeve të BE.

- Në vendet e BE tarifën e letrave 500g janë rreth 3 herë më të larta se letrat 20g apo 50g, ndërsa tarifën e Posta Shqiptare kanë diferencë shumë të vogël,
- Tarifën e pakove postare në vendet e BE janë disa herë më të larta se tarifën e letrave 500g, ndërsa tarifa e Postës Shqiptare për pakot 1kg është me e ulët se tarifa e letrës 500g, ndërsa tarifa për një pako postare deri në 10 kg është vetëm 130 lek.

Diferencat e mëdha në vendet e BE midis tarifave të pakove postare dhe letrave rezultojnë për shkak të diferencave në kosto të këtyre objekteve postare në proceset e përpunimit dhe shpërndarjes:

- Letrat janë me volume shumë më të mëdha se paketat postare dhe si rezultat dhe ekonomitë shkaktojnë me të lartë, janë të standartizuara në format, mund të shpërndahen pa mjete motorike, përpunimi është më ekonomik,
- Paketat postare kanë kosto më të larta në shpërndarje pasi ato në të shumtën e rasteve kryhen me mjete motorike.

11.6 Problematika për ofrimin e shërbimit (universal) postar

Përdorimi mesatar për banor i shërbimeve postare në Shqipëri është shumë i ulët krahasuar me vendet e BE dhe rajonit. Megjithatë shërbimet postare në vendet e tjera kanë shënuar rritje të ndjeshme në sasi totale të objekteve postare (sidomos letra), numri i objekteve postare për frymë në vendet e BE dhe rajonit është shumë më i lartë (50-252 letra/banorë) se në Shqipëri me rreth 7 objekte postare për banorë në vit.

Një ndër problemet më të mëdha që ndikojnë në përdorimin e ulët të shërbimeve postare në Shqipëri nga konsumatorët dhe bizneset është mungesa e adresave të sakta postare dhe kutive postare për dorëzimin e objekteve postare (letra, paketa të vogla) në adresën e marresit (familjare). Mungesa e adresave të sakta çon në probleme të shpërndarjes së objekteve postare duke krijuar besueshmeri të ulët të publikut të gjere dhe bizneseve për cilësinë e shërbimit postar dhe kjo rezultojnë në përdorim shumë të ulët të shërbimeve postare në Shqipëri (numri i objekteve postare për banorë shumë herë më i ulët se vendet në rajon dhe BE).

Problematika me adresat dhe kutitë postare detyron konsumatorët dhe bizneset që të përdorin mënyra alternative për dërgimin/marrjen e objekteve postare:

- Përdorimi i adresës së qendrës së punës për marrje objektësh postare (sidomos paketa hyrëse ndërkombëtare) nga konsumatorët,
- Përdorimi i mjeteve të transportit publik për dërgim/marrje pakosh postare brenda vëndit nga konsumatorët,
- Përdorimi i pikave të shitjes/prezencës së bizneseve për dhënie të faturave të detajuara, pasqyrave financiare, kartave bankare etj.

Megjithatë zëvendësimi i komunikimit postar me komunikimin elektronik si për konsumatorët dhe për bizneset është i njohur dhe në rritje, përdorimi shumë i ulët i shërbimeve postare në Shqipëri vjen kryesisht nga besueshmeria e ulët e publikut të gjere dhe bizneseve për cilësinë e shërbimit postar të lidhur me sistemin jo të saktë të adresave dhe mungesën e kutive postare në adresat e marresit.

Sistemi i adresave duhet të jetë i integruar në mënyrë që të gjithë operatorët postarë dhe bizneset, institucionet të kenë adresë të sakta dhe të besueshme, për të shmangur problemet që ekzistojnë aktualisht si përdorimi i adresave të ndryshme për të njëjtën vendndodhje nga kompani të ndryshme utilitetesh, institucione të ndryshme publike (bashki, hipoteka, tatime etj).

Pra, mungesa e një sistemi të saktë dhe të integruar të adresave nuk çon vetëm në probleme të cilësisë dhe përdorimit me të ulet të shërbimeve postare por ndikon dhe në cilësinë e shërbimeve të tjera publike dhe sektore të tjera të ekonomisë, dhe si përfundim në përfitime me të uleta të konsumatorit Shqiptar nga shërbimet postare dhe të tjera të ofruara nga bizneset dhe shteti.

Një sistem i saktë dhe integruar i adresave, së bashku dhe me vendosjen e kutive postare në godinat e banimit, do të sillte jo vetëm në rritje të cilësisë së shërbimit postar por edhe në rritje të përdorimit/volumit të shërbimeve postare dhe në kushte të ofrimit efikas të Shërbimit Universal dhe në reduktim të kostove për njësi të elementëve të këtij shërbimi në Shqipëri.

IV Programi vjetor i punës për vitin në vazhdim

Programi vjetor i punës për vitin në vazhdim 2016 bazohet në vijimin e përmbushjes së:

- Detyrimeve dhe objektivave rregullatorë të përcaktuar në legjislacionin material,
- Politikat e zhvillimit sektorial të Këshillit të Ministrave,
- Direktivave të fushës të Komisionit dhe Parlamentit Europian,
- Akteve të BEREC, ERGP dhe ITU,
- Rekomandimeve sektoriale të Progres Raportit të KE për Shqipërinë,
- Kërkesave të paraqitura nga tregu.

Si dhe duke konsideruar:

- Tendencën e zhvillimit të tregjeve në kushtet e neutralitetit teknologjik dhe konsolidimit të tyre,
- Nxitjen e investimeve të orientuar drejt interesit më të lartë public,
- Mbrojtjen e interesave të konsumatorit,
- Praktikrat dhe eksperiencat më të mira Rajonale dhe Botërore.

12. Programi vjetor i punës për vitin në vazhdim 2016

12.1 Në drejtim të mbikëqyrjes dhe rregullimit ekonomik

1. Analiza e tregut/rishikimi i analizës së tregut të linjave me qira/akses broadband, përfshirë infrastrukturën pasive,
2. Monitorimi i zbatimit të detyrimeve të vendosura nga AKEP për operatorët celularë në 2014,
3. Analiza e tregut të telefonisë celulare,
4. Mbledhja, përpunimi dhe publikimi i të dhënave statistikore të komunikimeve elektronike,
5. Rishikim/përmirësim i formularëve të të dhënave statistikore dhe procesit të ruajtjes/përpunimit të tyre,
6. Rishikimi i Statusit të SHU të komunikimeve elektronike/përfshirë numeratorin telefonik,
7. Monitorim i ofertave referencë të aksesit dhe interkoneksionit të operatorëve me FNT,
8. Monitorimi i informacionit të publikuar në faqet e Internetit të operatorëve për përdoruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike,
9. Publikimi i tarifave të shërbimeve të komunikimeve elektronike,

10. Masa të mundshme rregulluese për roamingun ndërkombëtar,
11. Raportimet periodike dhe trajtim të çështjeve të tjera sipas Urdhrave të Brendshëm përkatëse.

12.2 Në drejtim të administrimit të burimeve të fundme, autorizimeve dhe faciliteteve

1. Ndjekja e Procedurës së Tenderit me objekt “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1965 – 1980 MHz çiftuar me 2155- 2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915 – 1920 MHz”,
2. Ndjekja e procedurës mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz”,
3. Hartimi i dokumentave mbi strategjinë dhe objektivat për futjen e shërbimeve të levizshme në brezat e frekuencave 800 MHz,
4. Ndjekja e procedurës rinovimit të Autorizimit Individual të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a. për përdorimin e frekuencave të brezit 900/1800 MHz,
5. Ndjekja e aplikimeve për pajisjen me AI për përdorimin e frekuencave,
6. Ndjekja e aplikimeve për pajisjen me numeracion dhe kode,
7. Ndjekja e procesit të portabilitetit të numrit, përditësimi i Rregullores,
8. Ndjekja e praktikave të koordinimit të frekuencave me institucionet e tjera, ndërkufitare, satelitore etj, përditësimi i marreveshjeve ekzistuese,
9. Ndjekja e aplikimeve për regjistrimin nën regjimin e AP,
10. Ndjekja e aplikimeve për pajisjen me çertifikata/licenca,
11. Ndjekja e aplikimeve për pajisje me Konfirmimin e Njohjes së Konformitetit të Pajisjeve Radio,
12. Ngritja e Sistemit të Përqendruar të Informacionit për rrjetet e komunikimeve elektronike,
13. Administrimi dhe përditësimi i Web-Gis, regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë (Atlasi Elektronik),
14. Verifikimi i raportimeve të sipërmarrësve të tregut të komunikimeve elektronike në Modulin e Aplikimeve Online për lidhjet në brezin 2.4/5.8GHz.

12.3 Në drejtim të monitorimit të spektrit të frekuencave, cilësisë dhe inspektimit

1. Zhvillimi i projektit për krijimin e Sistemit Kombëtar të Monitorimit të Spketrin të Frekuencave, Ndërtimi i Stacioneve të Thjeshtë Fiks Monitorimi (SRFMS), në sektorët rajonalë,
2. Monitorim i brezit të frekuencave 20 MHz – 3 MHz, në zonën Tiranë- Durrës nëpërmjet Stacioneve Fikse të Monitorimit në Krujë dhe Pinet,
3. Monitorimi i brezit të frekuencave të shërbimit të radionavigimit aeronautik 108 - 144 MHz, 960 - 1215 MHz dhe 1300 – 1350 MHz, në qytetin e Tiranës dhe qytetet kryesore në RSH,
4. Inspektimi i sipërmarrësve të tregut të komunikimeve elektronike,
5. Monitorimi periodik i frekuencave që përdoren në pikat kryesore të transmetimit në territorin e vendit, në brezat e frekuencave deri në 26 GHz,

6. Monitorimi i brezit të frekuencave 2.4 GHz dhe 5.8 GHz në pikat kryesore të transmetimit në territorin e vendit,
7. Monitorimi i brezit të frekuencave 2.6 GHz në qytetet kryesore të vendit,
8. Monitorimi i mbulimit dhe cilësisë së shërbimit në brezat e frekuencave GSM/UMTS/IMT/LTE në qytetet kryesore të Shqipërisë, rrugët kryesore kombëtare, zonat urbane dhe pikat turistike,
9. Monitorimi i mbulimit dhe cilësisë së shërbimit në brezat e frekuencave GSM/UMTS/IMT/LTE në zonat me densitet të ulët të popullsisë, të cilat do të mbulohen me shërbime broadband,
10. Monitorimi i mbulimit dhe cilësisë së shërbimit në brezat e frekuencave GSM/UMTS në zonat kufitare, sipas marrëveshjeve teknike midis AKEP dhe autoriteteve fqinje.
11. Upgrade i softëare-it të monitorimit ARGUS,
12. Administrimi i interferencave dhe zgjidhja e tyre në rastet e ankesave për ndërhyrje të dëmshme që vijnë nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike,
13. Zbatimi i rregullave teknike të përcaktuara në Rregulloren Nr. 22, datë 24.06.2011, dt.24.06.2011, “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërurbane të komunikimeve elektronike”, për stabilizimin dhe standartizimin e rrjeteve kabllore të komunikimeve elektronike.

12.4 Në drejtim të ushtrimit të funksioneve rregullatore në teknologjinë e informacionit dhe zhvillimit të broadband

1. Ndjekje e procesit të regjistrimit / rinovimit të domain-ve. Administrim i sistemit FRED (sistem i menaxhimit të domain .al),
2. Monitorim i aksesit në internet të Sistemit DNS (lidhjet përkatëse me 2 ISP),
3. Administrim dhe mirëmbajtje e sistemeve informatike dhe rrjetit kompjuterik të institucionit,
4. Menaxhimi i CRBD dhe Portabiliteti i Numrit,
5. Funksionimi i sistemit të CRDB sipas Rregullores dhe realizimi i procesit të bartjes së numrave për pajtimtarët,
6. Upgrade i dhomës së Server-ave pranë Q.K.M.F,
7. Sistemi i menaxhimit të proceseve të AKEP,
8. Ndjekja e zbatimit të strategjisë për broadband,
9. Ndjekja dhe realizimi i detyrave që do të caktohen për pjesëmarrje në Grupe pune të ndryshme.

12.5 Në drejtim të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe mbrojtjes së konsumatorit

1. Angazhim në konstatimin e nevojës për amendime/përditësime të akteve rregullatore të nxjerra nga AKEP dhe në fuqi, dhe në hartimin dhe ndryshimin e tyre në kuadër të përmirësimit të kuadrit rregullator me legjislacionin kombëtar dhe përqasjes së plotë me “*acquis*”, rekomandimet e ITU-së, rezolutat etj,
2. Angazhim në përmirësimin e legjislacionit sekondar rregullator të miratuar dhe në fuqi për komunikimet elektronike dhe shërbimin postar,

3. Angazhim në forcimin e rolit të autoritetit rregullator në mbrojtjen e konsumatorit (përdoruesit/pajtimtarit) në tregun e komunikimeve elektronike dhe në tregun postar duke e bashkërenduar punën me regjimin normativ në fuqi për mbrojtjen e konsumatorit në Shqipëri, për të garantuar:
 - mbrojtjen e interesave të konsumatorit në aspektin individual,
 - mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në tërësi nga sjelljet diskriminuese dhe antikonkurruese të operatorëve në tregun e komunikimeve elektronike,
 - mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në tërësi nga sjelljet diskriminuese dhe antikonkurruese të ofruesve të shërbimeve postare në tregun postar,
 - trajtim të barabartë dhe jodiskriminues të të gjithë përdoruesve përmes procedurave ligjore e transparente,
 - monitorimin dhe kontrollin e shërbimeve që ofron i autorizuari ndaj përdoruesve të shërbimeve elektronike dhe përdoruesve të shërbimeve postare.
4. Angazhim në forcimin e rolit të rregullatorit në mbrojtjen e interesave ligjore të tregut të komunikimeve elektronike dhe për të garantuar trajtimin e barabartë ligjor dhe jodiskriminues të ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve në procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mes tyre,
5. Angazhim në forcimin e rolit të rregullatorit në mbrojtjen e interesave ligjore të tregut të shërbimit postar për të garantuar trajtimin e barabartë ligjor dhe jodiskriminues të ofruesve të shërbimeve postare në procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mes tyre,
6. Angazhim në mbrojtje të interesave juridike dhe ligjore të institucionit të AKEP sa here që do të veprohet në emër dhe për llogari të tij me përfaqësim të autorizuar para gjykatës,
7. Angazhim në trajtim juridik profesional dhe konsulencë ligjore në trajtimin e të gjitha praktikave administrative të depozituara në AKEP,
8. Angazhim në zbatimin e ligjshmërisë për sigurimin e transparencës dhe publikimit të informacionit për çështje që lidhen me të drejtat e përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare.

12.6 Në drejtim të mbikëqyrjes së tregut të shërbimeve postare

1. Përditësimi i database për rrjetin dhe për të dhënat e tjera të shërbimit postar si dhe realizimi i projektit për publikimin e tyre në Atlasin e AKEP,
2. Analiza e të dhënave statistikore postare dhe informacione të tjera, me qëllim përgatitjen e raporteve, informacioneve, analizave dhe vlerësimeve të tregut postar,
3. Monitorimin e veprimtarisë së ofruesve të shërbimit postar, lidhur me zbatimin efektiv të detyrimeve ligjore, termat dhe kushtet e përgjithshme të shërbimit postar dhe kushteve thelbësore që rrjedhin nga Ligji nr.46/2015, aktet rregullatore të nxjerrë në plotësim të tij, si dhe vlerësimin e analizimin e problematikave që do të përftoheshin nga raportimi i çdo ofruesi mbi veprimtarinë e shërbimit postar.

12.7 Në drejtim të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe administrimit të brendshëm

1. Implementimi i strukturës së re, miratuar me Vendim të Kuvendit të Shqipërisë nr.88/2015 të Kuvendit të Shqipërisë “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)”,
2. Sigurimi i ambjenteve për ushtrimin e veprimtarisë së sektorëve rajonalë të monitorimit dhe inspektimit,
3. Sigurimi i ambjenteve për ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit Drejtues dhe Administratës së AKEP në kushte sa më optimale për menaxhimin edhe të QKMF,
4. Përmirësimi i kushteve të punës për punonjësit e AKEP me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore, rritjen e efikasitetit dhe performacës së punës,
5. Vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil mbi sistemin e vlerësimit të arritjeve vjetore individuale të punonjësve të AKEP,
6. Ndjekja dhe mbikëqyrja e trajnimeve për punonjësit e AKEP,
7. Realizimin e gjithë procedurave dhe detyrimeve ligjore të prokurimeve sipas afateve kohore dhe legjislacionit në fuqi,
8. Zbatimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2014-2020,
9. Zbatimin e Dokumentave të Politikave për sigurinë Kibernetike 2015-2017,
10. Ndjekje dhe Informim nga Organizatat Ndërkombëtare në të cilat AKEP është anëtare,
11. Rritja e bashkëpunimit me organet rregullatore në Rajon dhe më gjerë.

12.8 Në drejtim të menaxhimit financiar dhe pagesave

1. Detajimi i të ardhurave dhe shpenzimeve të AKEP për vitin 2016,
2. Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve të AKEP për vitin 2016,
3. Realizimi i investimeve të AKEP për vitin 2016,
4. Hartimi i programit të shpenzimeve të vitit 2017,
5. Llogaritja dhe arkëtimi i pagesave,
6. Ndjekja dhe vjelja e pagesave të debitorëve.

13. Raporti për realizimin e treguesve financiar vjetor të AKEP

Me Vendimin nr. 924 të Këshillit të Ministrave, datë 29.12.2014 “Për miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2015 për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare” fondi i shpenzimeve u miratua në shumën 306,400,000 lekë.

Tabela e mëposhtëme paraqet treguesit kryesorë financiarë të AKEP për të ardhurat dhe shpenzimet dhe tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit për vitin 2015.

13.1 Të ardhurat dhe shpenzimet

Tabela 26 Të ardhurat dhe shpenzimet

Nr	Emërtimi	Vitet 2015	
		Programi	Realizimi
I	Të ardhurat gjithsej:	306,400,000	321,776,858
II	Shpenzime gjithsej:	306,400,000	286,120,035
1	Shpenzimet për paga dhe shtesa të tjera	72,000,000	59,735,640
2	Shpenzimet për sigurime shoqërore e shëndetësore	9,700,000	8,198,432
3	Shpenzimet për materiale	5,800,000	5,698,201
4	Shpenzimet për shërbime	51,740,000	51,665,462
	Shpenzimet për Investime	167,160,000	160,822,230
III	Tarifa e shërbimit të radikomunikacionit		
1	Arkëtuar dhe transferuar në buxhetin e Shtetit		351,380,700
2	Të ardhurat si agjent tatimor nga arkëtimi dhe derdhja e tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit		17,569,035
	Nga kjo:		
a	Për shpërbime nga të ardhurat si agjent tatimor		8,728,535
b	Për blerje pajisje dhe investime		7,925,880

13.2 Realizimi i arkëtimeve

Për vitin 2015, të ardhurat janë realizuar në shumën **321,776,858** lekë nga 306,400,000 lekë të programuar në fillim të vitit, me realizim në masën 104.8%. Arkëtimet për vitin 2015 janë realizuar nga pagesat e sipërmarrësve që ofrojnë shërbime dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e komunikimeve elektronike, shërbimeve postare dhe regjistrim domain. Pagesat që llogariten dhe kryhen në AKEP nga sipërmarrësit janë sipas VKM Nr.599, datë 23.07.2010 “Për miratimin e pagesave që kryhen në AKEP”, i ndryshuar.

Të ardhurat në AKEP janë përfituar nga pagesat:

- Për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike sipas nenit 24 të Ligjit Nr. 9918,
- Për dhënie dhe përdorimin e frekuencave,
- Për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike,
- Për ofrimin e shërbimeve postare,
- Për regjistrim domain.al
- Të tjera (çertifikata radio operator, certifikata miratim tipi, radioamator, interesa bankare).

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar dhe ndjekjes së debitorëve, me qëllim arkëtimin e detyrimeve që kanë si ndaj AKEP-it, ashtu dhe për tarifën e shërbimit të radiokomunikacionit.

Procesi i mbledhjes së detyrimeve nga sipërmarrësit debitor është ndjekur nëpërmjet:

- Dërgimit të shkresave zyrtare, kontaktimit me telefoni dhe nëpërmjet ëëbsite,
- Inspektimit të kryer nga Drejtoria e Inspektimit dhe Monitorimit të Spektrit.

13.3 Realizimi i shpenzimeve.

Shpenzimet gjithësej janë realizuar në shumën **286,120,035** lekë nga 306,400,000 lekë të planifikuara në fillim ose në përqindje realizimi është në masën 93.4%. Mos realizimi i shpenzimeve vjen si rrjedhojë e mosrealizimit të shpenzimeve në disa zëra të shpenzimeve administrative dhe investimeve.

13.3.1 Shpenzimet administrative

Shpenzimet administrative, ku përfshihen shpenzimet për paga e shtesa, për sigurimet shoqërore shëndetësore, për material dhe për shërbime janë realizuar në shumën **125,297,805** lekë nga 139,240,000 lekë të planifikuar ose 90%.

13.3.2 Shpenzime për paga dhe shtesa

Shpenzime për paga e shtesa nga 72,000,000 lekë të planifikuar u realizuan 59,735,640 lekë ose 83%. Mos realizimi shpenzimeve për paga dhe shtesa në krahasim me programin ka ardhur nga mos plotësimi i numërit të punonjesve sipas strukturës së miratuar nga fillimi i vitit 2015 dhe nga nderperja e punes të katër punonjësve që ishin me raport barlindje të cilet nja paguar nga ISSSH.

13.3.3 Shpenzime për sigurime shoqërore

Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore nga 9,700,000 lekë të planifikuara janë realizuar 8,198,432 lekë ose 84.5%. Në mosrealizimin e shpenzimeve për sigurimet shoqërore ka ndikuar mos plotsimi i organikës së numrit të punonjesve të miratuar nga fillimi i vitit 2014 nga nderperja e punës të katër punonjësve që ishin me raport barlindje të cilët janë paguar ISSHSH

13.3.4 Shpenzime për material

Shpenzimet materiale për vitin 2015 janë realizuar në shumën 5,698,192 lekë nga 5,800,000 lekë të programuara ose 98.2% me kursim në shumën 101,808 lekë. Kusimi i shpenzimeve materiale në krahasim me programin vjen kryesisht nga mos realizimi në shpenzime për kancelari, shpenzimeve për tonera dhe shpenzimeve për materiale pastrimi dhe higjeno - sanitare.

13.3.5 Shpenzimet për shërbime.

Shpenzimet për shërbime janë realizuar në shumën **51,665,462** lekë nga 51,740,000 lekë të programuar ose 99.8% me një mos realizim në shumën **74,538** lekë. Nga analiza e shpenzimeve për shërbime rezulton se mos realizimi më i madh është në zërin e shpenzimeve për mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike, programeve dhe internet në shumën 1,563,910 lekë, shpenzimet për publikime e njoftime në shumën 1,133,157 lekë, shpenzimet e auto-transportit në shumën 1167,144 lekë, ndërsa në disa zëra të shpenzimeve për shërbime rezultojnë me tejkalim shpenzimesh.

Shpenzime për udhëtime e dieta në krahasime programin vjetor janë tekaluar në shumën 1,628,159 lekë, shpenzimet të tjera janë tekaluar në shumën 821,594 lekë, shpenzime qiraje janë tekaluar në shumën 644,192 lekë e tjera.

- Shpenzimet për mirëmbajtje të pajisjeve kompjuterike dhe interneti nuk u realizua sepse shpenzimet e internetit për DNS dhe për administratën nga prokurimi i fondit të shpenzimeve për interne rezultuan me ulje për 55 %. Nuk u realizuan shpenzimet për blerjen e rekomandimeve dhe raportin e DVD- ROM dhe shpenzime për blerjen e Standarteve ETSI- EDS DVD A,B,C, shpenzimet për blerjen e Licencës vjetore anti-virus dhe shpenzimet vjetore për mirëmbajtjen e faqes së AKEP u realizuar në 40%.
- Shpenzimet për publikime dhe njoftime në krahasim me programin e vitit nuk u realizuar sepse shpenzime e programuara për publikime ndërkombëtare u realizuan rreth 30 %.
- Shpenzimet për auto – transportin nuk u realizuan sepse nuk u bë siguracioni kasko i dy mjeteve e qendrave të monitorimit të frekuencave dhe nuk u realizuan shpenzimet e programura për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit.
- Shpenzimet për udhëtim e dieta dhe kualifikim u tekaluan në shumën 1,671,088 në krahasim me programin, sepse u shtua pjesmarja në disa aktivitete jashtë shteti të cilët

nuk ishin programuar në fillim të vitit se pjesmarja e AKEP në këto aktivitete ishte e rëndësishme.

- Shpenzimet e Tjera u tejkaluan në shumën **827,412** lekë e cila vjen nga pagesat për ruatje me roje private të Stacioneve të monitorimit në Krujë dhe Pinet sidhe shpenzimet e transporti për dërgimin e disa pajisjeve në stacionet e monitorimit.
- Në vitin 2015 ishin programuar shpenzime qiraje për ambjente punë për personelin që ishin në godinë e AKEP për rreth 6 muaj, se ishte programuar që rikostruksioni i godinës të përfundonte rreth muaj Gushtë. Zgjatja e afatit të rikostruksioni i godinës AKEP zgjati afatin e ambjeteve për personeli e godinës ekzistuese e cila riti shpenzimet e qeras të programuar. Gjithashtu dhe çmimi i qeras për personelin e godinës ekzistuese rezultoi me i larte se çmimi i qirasë i programuar në fillim të vitit.

13.3.6 Shpenzimet për Investimet

Shpenzime për investime për vitin 2015 nga 167,160,000 lekë të programuara janë realizuar në shumën 160,822,230 lekë ose 96.2%. Mos realizimi i shpenzimeve për investimeve për shumën 6,337,770 lekë ose 3.8 % ka ardhur nga ulja e çmimet të objekteve të programuara me çmimet e prokuruar sipas objekteve.

Realizimi i shpenzimeve sipas objekteve të investimit është si më poshtë vijon:

- Mirëmbajtja vjetore e “Portabilitetit të Numrit” nga shuma 25,380,000 lekë e programuar për vitin 2015 është realizuar në shumën 25,183,500 lekë. Është kontratë në vazhdim nga viti 2011 për shërbimi i mirëmbajtjes.
- Zhvillimi i Sistemit Kombëtar të Monitorimit të spektrit të frekuencave.Pajisje për Stacioni e Monitorimit Fiks në Pinet e programuar në shumën 64,400,000 lekë u realizuar në shumën 63,254,940 lekë.
- Ndërtim Stacioni Fiks Monitorimit (RFMS) në Pinet e programuar në shumën 6,200,000 lekë, është realizuar në shumën 6,238,389 lekë.
- Zhvillim i DNS - BIND dhe suport për FRED dhe regjistrar-et DNS është vazhdim kontrate nga viti 2014 dhe për vitin 2015 zhvillimi dhe mirëmbajtja e kontratës është realizuar në shumën 4,608,000 lekë.
- Sistem sigurie kamera, sistem kondicionimi, UPS dhe akses kontroll, të kontrollueshëm në distancë për Stacionin Fiks të Monitorimit (RFMS) në Krujë e programuar në shumën 900,000 lekë është realizuar në shumën 866,800 lekë.
- Blerje pajisje sigurie për ngjitje në kullë dhe trajnim i certifikuar për ngjitje në kullë e programuar në shumën 800,000 lekë është realizua në shumë n 792,000 lekë.
- Sistemi i menaxhimit të proceseve të AKEP (HR & Payroll, Case Management, CRM Module ERDM, Business Process Management) e programuar në shumën 12,000,000 lekë është realizuar në shumën 11,641,200 lekë.
- Upgrade i Qendrës Kombëtare të Lëvizshme të Monitorimit të Cilësisë e programuar në shumën 13,440,000 lekë është realizuar në shumën 13,348,081 lekë.

- Upgrade i sistemit të menaxhimit të regjistrareve.al e programuar në shumën 3,267,000 lekë është financuar 786,000 lekë dhe vazhdon në vitin 2016.
- Krijim Cluster BizTalk për CRBD e programuar në shumën 3,200,000 lekë është realizuar në shumën 3,040,002 lekë.
- Ngritje e sistemit Rezervë (Backup) në Q.K.M.F. e programuar në shumën 4,680,000 lekë është realizuar në shumën 4,411,200 lekë.
- Blerje Pajisje kompjuterike e programuar në shumën 1,537,538 lekë është realizuar në shumën 1,536,480 lekë.
- Rikonstruksion Godine të AKEP është vazhdim kontrate për vitin 2014 dhe për vitin 2015 e programuar në shumën 21,372,462 lekë është realizuar në shumën 21,372,113 lekë.
- Blerja e shërbimit të informacionit rregullator është shërbim i përvitshëm dhe për vitin 2015 e programuar në shumën 1,440,000 lekë është realizuar në shumën 1,403,700 lekë.
- Blerje pajisje të ndryshme e programuar në shumën 960,000 lekë është realizuar në shumën 1,044,498 lekë.

13.4 Mbi tepricën e të ardhurave

Teprica e të ardhurave në fund të vitit 2015 rezulton në shumën **35,656,823** lekë e cila është përfituar si rezultat i tejkalimit të ardhurave në shumën **15,376,858** lekë dhe mos realizimi i shpenzimeve në shumën **20,279,965** lekë. Teprica e të ardhurave derdhet në Buxhetin e Shtetit brenda 3-mujorit të parë të vitit 2016.

13.5 Mbi taksën e radiokomunikacionit

Në referencë të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” dhe udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave Nr.28, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit” i ndryshuar, AKEP është agjent tatimor për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në Buxhetin e Shtetit të tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit.

Për vitin 2015 janë arkëtuar dhe derdhur në Buxhetin e Shtetit shuma prej 351,380,700 lekë. AKEP ka punuar dhe ndjekur në vazhdimësi mbledhjen e tarifës së radiokomunikacionit, ka bashkëpunuar me organet tatimore, për arkëtimet dhe derdhjen e tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit.

Në realizimin e detyrës si agjent tatimor AKEP ka përfituar komisione në masën 5 % të shumës së derdhur në Buxhetin e Shtetit në shumën 17,569,035 lekë.

Të ardhurat e përfituar nga komisionet si agjent tatimor janë përdorur për shpërbimin e punonjësve në shumën 8,728,535 lekë dhe për blerje pajisje dhe investime 5,616,000 lekë.

13.6 Rritja e përformancës dhe efektiviteti i realizimit të treguesve financiarë të AKEP

AKEP gjatë vitit 2015 ka punuar për rritjen e përformancës dhe efektivitetin e realizimit të treguesve financiarë si dhe në administrimin, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare duke bërë:

- Kontabilizimin në kohë të veprimeve të arkës, bankës, magazinës për të ardhurat dhe shpenzimet që kryen institucioni,
- Mbyllja e bilancit financiar të vitit 2014, dhe dërgimin e tij brenda afateve ligjore në organet tatimore,
- Ndjekja e vazhdueshme e sipërmarrësve debitor për likuidimin e pagesave për AKEP dhe tarifën e radiokomunikacionit dhe bashkëpunim me organet tatimore,
- Informatizimi i llogaritjeve të pagesave dhe mundësimi on-line në faqen e internetit të AKEP, për sipërmarrësit me qëllim rritjen e transparencës dhe uljen e debitorëve,
- Llogaritjen, arkëtimin dhe derdhjen e tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit në buxhetin e shtetit.

14. Programi i treguesve financiarë të AKEP për vitin 2016

Në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Këshillit të Ministrave me Vendimin nr. Nr.1073, datë 23.12.2015 “Për miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2016 për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare” u miratua fondi i shpenzimeve në shumën 318,570,000 lekë.

Fondi i shpenzimeve për vitin 2016 sipas zërave u miratua si më poshtë:

Tabela 27 Fondi i shpenzimeve për vitin 2016

Nr. Ren	Emërtimi	Programi Vjetor
I	Të ardhura nga pagesat gjithsej:	318,570,000
II	Shpenzime gjithsej:	318,570,000
1	Shpenzime për paga dhe shtesa të tjera	81,200,000
2	Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	10,400,000
3	Shpenzime për materiale	6,200,000
4	Shpenzime për shërbime	90,470,000
5	Shpenzime për Investime	130,300,000

Figurat

Figure 1	Organigrama e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare	31
Figure 2	Përbërja strukturore sipas funksioneve në AKEP	32
Figure 3	Përbërja gjinore dhe arsimore për vitin 2015	32
Figure 4	Të ardhurat sipërmarrësve të komunikimeve elektronike (2008-2014)	36
Figure 5	Të ardhurat totale të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike (2014)	36
Figure 6	Ecuria e të ardhurave të operatorëve celularë 2008-2015	37
Figure 7	Ecuria e numrit të përdoruesve aktivë celularë 2010-2015	38
Figure 8	Ecuria e numrit të përdoruesve celularë sipas karatve SIM 2000-2015	39
Figure 9	Numri i përdoruesve aktive të aksesit broadband nga rrjete celulare	40
Figure 10	Ecuria e strukturës së trafikut dalës celular (2003-2015)	41
Figure 11	ARPM në vendet e BE dhe Shqipëri (2011/2014)	45
Figure 12	ARPU në vendet e BE dhe Shqipëri (2013/2014)	46
Figure 13	Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2000-2015	47
Figure 14	Pjesët e tregut të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2010-2015	48
Figure 15	Ecuria e numrit të pajtimtarëve me akses broadband fiks	49
Figure 16	Ecuria e pjesëve të tregut të aksesit Broadband nga rrjete fikse (2010-2015)	49
Figure 17	Numri i pajtimtarëve me akses Broadband nga rrjete fikse sipas qarqeve (2010-2015)	50
Figure 18	Penetrimi i aksesit Broadband nga rrjete fikse sipas qarqeve (2015)	50
Figure 19	Numri i pajtimtarëve broadband sipas teknologjisë	51
Figure 20	Ecuria e objekteve postare 2012-2015	53
Figure 21	Objekte postare për banorë në vendet e BE	54
Figure 22	Ecuria e numrit të të punësuarve 2012-2015	56
Figure 23	Ecuria e strukturës së thirrjeve nga rrjetet celulare (janar 2014 - dhjetor 2015)	62
Figure 24	Ecuria e sasisë së trafikut on-net dhe off-net janar 2014 - dhjetor 2015	63
Figure 25	Posta Shqiptare - Shërbimi universal postar / brenda vendit 2012-2015	115
Figure 26	Posta Shqiptare – Shërbimi universal postar/ Postë ndërkombëtare	115
Figure 27	Posta Shqiptare – Shërbimi universal postar / Postë ndërkombëtare - Krahasimi në vite.	116

Tabelat

Tabela 1	Tregues kryesorë të volumit të shërbimeve celulare 2013-2015	37
Tabela 2	Ecuria e numrit të përdoruesve aktivë të aksesit broadband nga rrjet celular	40
Tabela 3	Pjesët e tregut celularë për disa tregues kryesorë 2010-2015	42
Tabela 4	Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare 2010-2015	43
Tabela 5	Ecuria e ARPM dhe ARPU 2010-2014	44
Tabela 6	Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse 2010-2015	47
Tabela 7	Ecuria e numrit të pajtimtarëve me akses broadband nga rrjete fikse	49
Tabela 8	Numri i pajtimtarëve me shërbime të integruara të Albtelecom	51
Tabela 9	Të dhëna mbi kategorite kryesore të objekteve postare (2015)	53
Tabela 10	Numri i objekteve postare të shërbimit ekspres/jo-universal brenda vendit dhe ndërkombëtare	54
Tabela 11	Numri i Zyrave postare sipas ofruesve (2015)	55
Tabela 12	Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare	59
Tabela 13	Ndryshimet në tarifat standarde të thirrjeve me parapagim (Vodafone Club)	60
Tabela 14	Ndryshime në ofertat e përdoruesve me parapagim Vodafone Albania	60
Tabela 15	Ndryshime në plane tarifore të përdoruesve me kontratë Vodafone Albania	61
Tabela 16	Ndryshimet në përqindje të tarifave të terminimit në rrjetet fikse (1.09.2014-2018)	67
Tabela 17	Regjistri i Sipërmarresve që kanë njoftuar për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike deri më 31.12.2015	71
Tabela 18	Monitorimi	86
Tabela 19	Rregjistrarët	92
Tabela 20	Domainët	92
Tabela 21	Aktivitet	102
Tabela 22	Regjistri i realizimeve të prokurimit publik për Vitin 2015	104
Tabela 23	Renditja e Shqipërisë për shpenzimet indeksin e cmimve të ICT	112
Tabela 24	Përmbledhje e Krahasimit të tarifave për objekte të ndryshme postare	118
Tabela 25	Tarifat mesatare BE- Rajon dhe Posta Shqiptare në LEK	119
Tabela 26	Të ardhurat dhe shpenzimet	127
Tabela 27	Fondi i shpenzimeve për vitin 2016	132